



Komisioneri për Mbrojtjen
nga Diskriminimi

Commissioner for Protection
from Discrimination

RAPORT VJETOR

2014

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi



Empowered lives.
Resilient nations.

Fjala përshëndetëse e Komisionerit	3
HYRJE	4
Konsiderata të Përgjithshme	6
KAPITULLI I	8
NJË VËSHTRIM RRETH SITUATËS SË DISKRIMINIMIT NË SHQIPËRI	8
I.1. Zhvillimi i kuadrit ligjor për garantimin e barazisë dhe mosdiskriminimit në Shqipëri	8
I.2. Situata e diskriminimit në Shqipëri	12
I.2.1. Diskriminimi për shkak të racës	13
I.2.2. Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar	19
I.2.3. Diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor	23
I.2.4. Diskriminimi për shkak të gjinisë.....	25
I.2.5. Diskriminimi i shumëfishtë.....	28
KAPITULLI II	29
VEPRIMTARIA E KMD-SË PËR MBROJTJEN NGA SJELLJET DISKRIMINUESE DHE PROMOVIMIN E BARAZISË	29
II.1. Ofrimi i ndihmës viktimave të diskriminimit për ndjekjen e ankesave të tyre për diskriminim.....	29
II.1.1. Shqyrtimi i çështjeve nga KMD-ja	29
II.1.1.2. Ankimesit.....	32
II.1.1.3. Shpërndarja rajonale e ankesave.....	33
II.1.1.4. Shkaqet e pretenduara në çështjet e shqyrtuara	34
II.1.1.5. Ndarja e çështjeve sipas shkaqeve.....	36
II.1.1.6. Format e diskriminimit	50
II.1.1.7. Fushat në të cilat janë paraqitur ankesat	54
II.1.1.8. Çështje të nisura me iniciativë të KMD-së	59
II.1.1.9. Rezultatet e vendimeve për ankesat e shqyrtuara.....	59
II.1.2. Trajtimi nga gjykata i çështjeve me objekt diskriminimin	60
II.1.2.1. Dhënie mendimi me shkrim nga KMD-ja Për Gjykatën	61
II.1.2.2. KMD-ja si Palë e Paditur	65
II.1.2.3. KMD-ja si Person i Tretë.....	68
II.1.2.4. Proceset gjyqësore për ekzekutimin e gjobave	69
II.2. Rekomandime legjislative dhe rekomandime të tjera për çështje diskriminimi	71
II.2.1. Rekomandime legjislative.....	71
II.2.2. Rekomandime të tjera për çështje diskriminimi	73
II.3. Ndërgjegjësimi	77
II.3.1. Hartimi, publikimi dhe shpërndarja e materialeve ndërgjegjësuëse dhe manualeve trajnuëse	77
II.3.2. Organizimi i trajnimeve dhe konferencave nga KMD-ja	79
II.3.3. Organizimi i Ditëve të Hapura.....	81
II.3.4. Rritja e vizibilitetit në media	82
II.3.5. Leksione të hapura.....	82
II.4. Studime dhe monitorime në lidhje me diskriminimin	83
II.4.1. Studime të KMD-së mbi diskriminimin	83
II.4.2. Monitorime të KMD-së mbi diskriminimin	83
II.4.3. Raportime të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi para organizatave ndërkombëtare dhe rajonale	83
II.4.4. Seancat publike në Kuvend	87
II.5. Bashkëpunime	87
II.5.1. Anëtarësimi në EQUINET - Rrjeti European i Organeve të Barazisë.....	87
II.5.2. Bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtare përmes projekteve të përbashkëta	88
II.5.3. Bashkëpunimi me shoqërinë civile	88
II.5.4. Bashkëpunimi me institucionet shtetërore	89
KAPITULLI III	90
ASPEKTE TË SHËRBIMEVE	90
III.1. Menaxhimi i burimeve njerëzore.....	90
III.2. Menaxhimi i burimeve financiare	92
SHTOJCA 1	94
Kuadri ligjor për garantimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit në Shqipëri	94
SHTOJCA 2	99
Rekomandime legjislative të KMD-së.....	99
SHTOJCA 3	106
Pjesëmarrje e stafit të KMD-së në aktivitete të organizuara nga aktorë të tjerë.....	106

Fjala përshëndetëse e Komisionerit

**I nderuar Z. Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë,
Të nderuar Deputetë,**

Me ndjenjën e përgjegjësive të madhe që mbart Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion që siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe sjelljet që e nxisin atë, po paraqesim pranë Kuvendit të Shqipërisë Raportin Vjetor 2014.

Aktiviteti i Komisionerit është zhvilluar në funksion të realizimit të proceseve intensive demokratizuese dhe integruese ku Shqipëria është përfshirë dhe të ushtrimit të kompetencave të përcaktuara atij me ligj.

Ky raport është konceptuar duke mbajtur parasysh detyrimin ligjor të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të parashikuar në nenin 26 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ku thuhet shprehimisht se “Komisioneri paraqet raport të paktën një herë në vit përpara komisioneve të Kuvendit. Raporti përfshi analizë për zbatimin e këtij ligji në përgjithësi, si dhe për punën e Komisionerit dhe të zyrës”.

Përmbajtja e këtij raporti është ndërtuar bazuar në misionin dhe objektivat e Zyrës së Komisionerit të reflektuara në dokumentin e miratuar nga ky institucion, “Plani strategjik 2012-2015 dhe Plani i veprimit për vitin 2013 i Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe në rekomandimet që Kuvendi i Shqipërisë ka adresuar për vitin 2014.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERE

Irma BARAKU

HYRJE

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi [KMD], si një institucion i pavarur në ushtrimin e detyrës, i cili i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit, e vlerëson mbrojtjen reale të së drejtës së çdo individit për barazi dhe mbrojtje nga diskriminimi si një prioritet të aktivitetit të tij dhe si një çështje me rëndësi të veçantë në përparimin e shtetit shqiptar drejt integritit në Bashkimin Europian.

Puna e institucionit është bërë e mundur në sajë të bashkëpunimit me organizata të ndryshme jofitimprurëse që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut, në mënyrë të veçantë, me grupet në nevojë, me institucione të ndryshme në nivel qendror dhe vendor, me median dhe publikun.

Edhe gjatë vitit 2014, veprimtaria e KMD-së është udhëhequr nga legjislacioni në fuqi, Plani Strategjik 2012-2015, Plani i Veprimit 2014 dhe rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë për veprimtarinë e institucionit të KMD-së për vitin 2014. Plani Strategjik 2012-2015 përbën një instrument të rëndësishëm në punën e KMD-së, në të cilin përcaktohen jo vetëm objektivat e institucionit, por edhe institucionet e tjera që luajnë rol në zbatimin e kësaj strategjie.

Vlerësimet dhe rekomandimet e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, në “Projekt-rezolutën për vlerësimin e punës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2013 dhe rekomandimet për vitin 2014”, kanë përbërë një udhëzues në veprimtarinë e këtij institucioni për garantimin e barazisë dhe mbrojtjen reale nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në përmbushje të objektivave të parashikuara në kuadër të Prioritetit 5, ka ndërmarrë një sërë aktivitete dhe masash për:

Së pari, ofrimin e një ndihme të kualifikuar ndaj viktimave të diskriminimit përmes trajnimit të aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë:

- Trajnimin e vazhdueshëm të stafit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për trajtimin e çështjeve të diskriminimit, duke u mbështetur në jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut dhe në frymën dhe parimet e vendimeve të Gjykatës Europiane të Drejtësisë;
- Trajnimin e gjyqtarëve të Gjykatave të Shkallës së Parë në 5 (pesë) rrethe të Shqipërisë;
- Trajnimin e nëpunësve të administratës vendore për trajtimin e barabartë dhe pa diskriminim të qytetarëve;
- Trajnimin e përfaqësuesve të Dhomave të Tregtisë;
- Trajnimin e OJF-ve për identifikimin e rasteve të diskriminimit dhe për rrugët që mund të ndjekin për të ndihmuar viktimat e sjelljes diskriminuese.

Këto aktivitete trajnimi kanë sjellë si rezultat jo vetëm rritjen e numrit të ankesave pranë KMD-së, dhënien e vendimeve strategjike mbi diskriminimin (diskriminimi përmes përdorimit të gjuhës së urrejtjes ndaj komunitetit LGBT, diskriminimi në formën e viktimizimit, për shkak të shtatzënisë në fushën e punësimit, në arsim dhe në ofrimin e shërbimeve), dhe ushtrimin e të gjitha kompetencave që ligji i ka dhënë institucionit të Komisionerit, por edhe në rritjen e numrit të çështjeve të trajtuara nga gjykatat, të vendimeve gjyqësore të dhëna për diskriminim dhe të kërkesave të gjykatave për marrjen e opinionit të Komisionerit apo pjesëmarrjen e tij si palë e tretë në proceset gjyqësore.

Së dyti, ndërgjegjësimin e shoqërisë, në përgjithësi, dhe të grupeve specifike, në veçanti, përmes:

- Hartimit dhe botimit të materialeve informuese dhe ndërgjegjësuese mbi ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si manuale, broshura dhe fletëpalosje;
- Përgatitjes dhe shpërndarjes së materialeve informuese në gjithë territorin e Shqipërisë (nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Postën Shqiptare ka bërë të mundur informimin edhe në zonat rurale);
- Fushatave ndërgjegjësuese në shkollat 9 - vjeçare dhe qendrat shëndetësore;
- Leksioneve të hapura me studentët.

Së treti, dhënien e rekomandimeve legjislative. Komisioneri ka synuar në përafrimin e legjislacionit ekzistues (Kodi Penal, Kodi i Punës, Kodi i Familjes, Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Zgjedhor, ligji 9355, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”), në përputhje me parashikimet e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, kryesisht në lidhje me:

- shkaqet e diskriminimit për të cilat këto ligje ofrojnë mbrojtje;
- format e diskriminimit;
- shpërndarjen e barrës së provës.

KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

- » KMD-ja i ka kushtuar një vëmendje të veçantë nxitjes së parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, përmes shfrytëzimit të disa instrumenteve, me qëllim ndërgjegjësimin e publikut dhe rritjen e identifikimit të rasteve apo ankesave. Kontributi i punonjësve të KMD-së në mediane dhe elektronike, organizimi i workshopeve, tryezave, seminareve dhe konferencave, organizimi i Ditëve të Hapura, forcimi i bashkëpunimit me organizatat jofitimprurëse, institucionet e pushtetit qendror dhe vendor, universitetet, dhe aktorë të tjerë i ka krijuar më shumë mundësi institucionit të KMD-së për ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me barazinë dhe mosdiskriminimin. Gjithashtu, përmes organizimit të aktiviteteve ndërgjegjësuese me publikun është rritur niveli i informimit të publikut mbi mjetet ligjore, rolin e KMD-së, të gjykatave dhe numri i ankesave të paraqitura pranë institucionit tonë. Këto takime do të vazhdojnë të zhvillohen edhe në të ardhmen në bashkëpunim si me organizatat kombëtare, ashtu dhe me organizatat ndërkombëtare.
- » KMD-ja ka vlerësuar kryerjen e monitorimeve të zbatimit të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi si të një rëndësie të veçantë. Kështu, gjatë vitit 2014, është iniciuar një monitorim i sektorit privat në fushën e punësimit, i cili fokusohet në mënyrë të veçantë tek mundësitë e grupeve të pambrojtura për punësim. Gjithashtu, monitorimi i vendimeve gjyqësore në fushën e mosdiskriminimit është vendosur në qendër të veprimtarisë së KMD-së. Rezultatet e këtyre monitorimeve priten të përdoren si mjete të rëndësishme avokatie nga KMD-ja, në veprimtarinë e vitit në vijim.
- » Një vëmendje e veçantë u është kushtuar botimeve të vendimeve të KMD-së dhe botimeve të tjera, me qëllim rritjen e informimit të komunitetit mbi situatat diskriminuese dhe mjetet që mund të përdoren për adresimin e tyre. Edhe faqja zyrtare e institucionit është pasuruar me informacione të përditësuara, me qëllim rritjen e përdorimit të tij nga qytetarët dhe sigurimin e një komunikimi të vazhdueshëm të institucionit me ta.
- » Gjatë vitit 2014, është rritur numri i ankesave të paraqitura pranë KMD-së në lidhje me mbrojtjen nga diskriminimi. Raca, bindja politike, gjendja ekonomike, gjendja shëndetësore dhe aftësia e kufizuar janë ndër shkaqet kryesore të ankesave të paraqitura pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- » KMD-ja e vlerëson të rëndësishme dhe mirëpret rritjen e rolit të organizatave jofitimprurëse që punojnë për të drejtat e grupeve të dobëta si fëmijët, gratë, përfaqësuesit e komunitetit rom dhe egjiptian, personat me aftësi të kufizuara, pasi këto organizata përbejnë një burim informacioni për KMD-në. Gjithashtu, media duhet të forcojë rolin e saj aktiv, me qëllim identifikimin e situatave diskriminuese me të cilat përballen përfaqësuesit e grupeve të ndryshme në nivel kombëtar. Pavarësisht mundësive që parashikohen në ligjin nr.10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, për paraqitjen e ankesave pranë KMD-së nga organizatat me interesa legjitime, që pretendojnë diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, numri i ankesave të paraqitura prej tyre zë vetëm 6 % të numrit total të ankesave të paraqitura për shqyrtim pranë KMD-së.

- » Vërejmë se është forcuar roli i organizatave jofitimprurëse, që punojnë për garantimin në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim të të drejtave të komunitetit rom dhe egjiptian. Bazuar në ankesat e paraqitura nga përfaqësues të komunitetit rom, vërejmë se pjesëtarë të këtij komuniteti ankohen kryesisht për diskriminim në fushën e punësimit, strehimit, arsimit, të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe në atë të shërbimeve.
- » Ankesat me pretendim diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar lidheshin me mosbërjen e përshtatjeve të arsyeshme, me mosofrimin e të mirave dhe shërbimeve dhe moszbatimin e legjislacionit në lidhje me përfitimin e rimbursimit të tarifës së shkollimit në arsimin e lartë, si dhe integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin e zakonshëm.
- » Objekti i ankesave me pretendim diskriminim për shkak të gjinisë, përgjithësisht ka qenë mosrespektimi i të drejtave në fushën e të mirave dhe shërbimeve nga ana e institucioneve publike. Vërejmë se, numri i ankesave me pretendim diskriminim për shkak të gjinisë është relativisht i vogël, krahasuar me shkaqet e tjera të diskriminimit të pretenduar.
- » Gjatë vitit 2014, institucioni i KMD-së ka bërë përpjekje për respektimin e afateve ligjore në procesin e hetimit administrativ gjatë shqyrtimit të ankesave. I është kushtuar vëmendje e veçantë zgjerimit të mbledhjes së të dhënave dhe informimit nga institucionet publike qendrore dhe vendore, si dhe nga subjektet private.
- » KMD-ja ka zhvilluar konsultime të vazhdueshme për përcaktimin e nevojave për ndryshimin e ligjit nr.10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Këto konsultime janë mbështetur në problematikat e reflektuara në praktikën e zbatimit të këtij ligji.
- » Me qëllim përmirësimit e mëtejshëm të mekanizmave ligjorë, harmonizimin e legjislacionit të brendshëm me ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe përafrimin me të drejtën ndërkombëtare në fushën e mosdiskriminimit, janë përgatitur dhe dërguar rekomandime legjislative. Këto rekomandime legjislative synojnë përmirësime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurës Civile të RSH-së, Kodin e Procedurave Administrative, Kodin e Punës, Kodin Zgjedhor, Kodin e Familjes, etj.
- » Përmes organizimit të aktiviteteve informuese, trajnuese, etj, me aktorë të ndryshëm janë promovuar praktikat më të mira të KMD-së në adresimin e diskriminimit për shkaqe të ndryshme.
- » Gjatë vitit 2014, punonjësit e KMD-së kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre për trajtimin e ankesave në lidhje me diskriminimin për shkaqe të ndryshme, zbatimin e legjislacionit kundër diskriminimit dhe monitorimin e zbatimit të legjislacionit.
- » Me qëllim forcimin e bashkëpunimit të KMD-së me institucione të tjera janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione shtetërore, shoqërore civile dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe janë zhvilluar shumë aktivitete të përbashkëta.
- » KMD-ja ka hartuar studime për grupe të veçanta si LGBT, Romët, etj.
- » KMD-ja ka luajtur një rol të rëndësishëm përmes kontributit të tij në përgatitjen e raporteve, si raporti mbi zbatimin e Konventës CEDAW në Shqipëri, Progres Raporti 2014, etj.

KAPITULLI 1

NJË VËSHTRIM RRETH SITUATËS SË DISKRIMINIMIT NË SHQIPËRI

I.1. Zhvillimi i kuadrit ligjor për garantimin e barazisë dhe mosdiskriminimit në Shqipëri

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë sanksionon parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. Në nenin 18 parashikohet se, “*Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit, dhe se askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore*”.

Shqipëria është palë në instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminimit. Normat ndërkombëtare kanë ndikim shumë të rëndësishëm në sistemin ligjor dhe politikat kombëtare të shtetit tonë. Raporti i tyre me legjislacionin kombëtar në fuqi, përcaktuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, jep mundësinë që t’u referohemi dokumenteve të rëndësishme ndërkombëtare në veprimtarinë e institucionit tonë. Në rekomandime legjislative dhe rekomandime të tjera, në vendimet në lidhje me shqyrtimin e ankesave, në raportet vjetore dhe raportet e veçanta, KMD-ja u është referuar akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar.

Kuadri ligjor në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit ka pësuar zhvillime gjatë vitit 2014, të cilat po i bëjmë me dije në këtë çështje të raportit:

Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”¹ është ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2012. Me ligjin nr. 104/2012, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës ‘Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje’”, shteti shqiptar ka treguar gatishmërinë e tij për të plotësuar kuadrin ligjor që adreson dhunën në familje dhe përmbushur detyrimet që burojnë nga kjo Konventë. Konventa ka hyrë në fuqi në 1 gusht të vitit 2014.

Kjo konventë konsideron dhunën në familje si një ndër format më serioze të shkeljes së të drejtave të njeriut. Konventa njeh dhunën ndaj grave si një shprehje të marrëdhënieve të pushtetit, historikisht të pabarabartë ndërmjet grave dhe burrave. Konventa zbatohet për të gjitha format e dhunës ndaj grave, duke përfshirë dhunën në familje, e cila prek gratë në mënyrë shpërpjestimore. Parandalimi, mbrojtja e grave ndaj të gjitha formave të dhunës, ndjekja penale e dhunuesve, eliminimi i dhunës ndaj grave dhe i dhunës në familje, eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit kundër grave, si edhe promovimi i barazisë reale midis burrave dhe grave janë disa nga shtyllat kryesore të këtij akti ndërkombëtar.

¹ Ligj Nr. 104 datë 11.08.2012 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”. Kjo Konventë nuk ka hyrë akoma në fuqi, pasi duhen edhe dy ratifikime.

Kjo konventë parashikon disa detyrime të rëndësishme që konsistojnë në: të drejtën e viktimave për informim, ofrimin e shërbimeve mbështetëse, të përgjithshme dhe të specializuara për çdo viktimë, garantimin se sigurimi i shërbimeve nuk varet nga gatishmëria e viktimës për të ngritur akuza, ose për të dëshmuar kundër autorit të një vepre penale, ngritjen e strehëve të përshtatshme, lehtësisht të përdorshme e në numër të mjaftueshëm, të drejtën për kompensimin e viktimave të dhunës, garantimin e të drejtës për ndihmë ligjore falas, etj. Kjo konventë përcakton një numër ndërhyrjesh, si në lidhje me përmirësimin e kuadrit ligjor që adreson dhunën ndaj grave/dhunën në familje, ashtu edhe në lidhje me zbatimin e legjislationit.

» **Ligji kuadër nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e PAK"**

Ligji kuadër nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e PAK", synon të garantojë mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara [PAK] me qëllim pjesëmarrjen e plotë dhe të efektshme të tyre në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët. Gjithashtu, ligji përcakton përgjegjësitë e strukturave përgjegjëse publike dhe jo publike për të bërë të mundur pjesëmarrjen e barabartë në shoqëri të Personave me Aftësi të Kufizuara.

Ky ligj përcakton termat, "Persona me aftësi të kufizuara", "Mohim i përshtatjes së arsyeshme", e njohur si formë diskriminimi edhe në ligjin 10221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", "Organizatë e personave me aftësi të kufizuara", "Organizatë për personat me aftësi të kufizuara", "Aksesueshmëri", "Përfshirje" etj. Edhe përkufizimi i diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara është në përputhje me kuptimin e diskriminimit në nenin 3, "Përkufizimet", në ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Ligji fut disa koncepte të reja në legjislationin e brendshëm për personat me aftësi të kufizuara si, "jetesë e pavarur", "vendimmarrja e mbështetur", etj. Në ligj përcaktohen institucionet përgjegjëse dhe detyrat me të cilat i ngarkon ata ligji si, Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, ministri që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor. Nën punësit që merren me çështjet e aftësisë së kufizuar në nivel qendror dhe vendor dhe organizatat jofitimprurëse janë institucionet përgjegjëse në zbatim të tij.

Ligji parashikon ngritjen e komisioneve multidisiplinare për vlerësimin e aftësisë së kufizuar e të nevojave për ndihmë e mbështetje.

Mosdiskriminimi dhe barazia, duke përfshirë barazinë gjinore, janë ndër parimet bazë të këtij ligji. Ky ligj kuadër pritet të udhëheqë përmirësimet e legjislationit të brendshëm në përputhje me standardet e Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara [KD-PAK]. Ky ligj ka parashikuar KMD-në dhe Avokatin e Popullit si instrumentet përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kësaj Konvente.

» **Ligj nr. 40/2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998, 'Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve'"**

Ligj nr. 40/2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998, 'Për

të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve'", i ndryshuar, parashikon trajtimin me dinjitet, pa njëanshmëri dhe pa diskriminim dhe duke respektuar të drejtat njerëzore të paraburgosurve dhe të dënuarve, grave të paraburgosura dhe të dënuara, të paraburgosurve dhe të dënuarve me çrregullime të shëndetit mendor, si dhe të paraburgosurve dhe të dënuarve me aftësi të kufizuara.

Këto ndryshime kërkojnë parandalimin e çdo akti dhune me bazë gjinore, i cili sjell dëmtim fizik, seksual ose psikologjik, vuajtje ose çdo formë tjetër abuzimi e keqtrajtimi ndaj grave të paraburgosura dhe të dënuara.

Në përputhje me legjislationin për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin, ky ligj parashikon se, masat e veçanta, që janë të nevojshme të zbatohen për grupe të veçanta të të paraburgosurve dhe të dënuarve, nuk konsiderohen diskriminim.

Të paraburgosurve dhe të dënuarve që kanë pasur përvoja përballjeje me forma të ndryshme dhune para ose gjatë qëndrimit në institucion u ofrohen masa mbrojtëse, mbështetëse dhe këshillime ligjore me qëllim rehabilitimin e tyre.

Me këto ndryshime ligjore, trajtimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve orientohet nga rehabilitimi dhe riintegrimi i individualizuar sipas nevojave. Programe kulturore të veçanta parashikohen të ofrohen për të paraburgosurit dhe të dënuarit që u përkasin minoriteteve etnike dhe gjuhësore, të huajve dhe personave pa shtetësi.

Edhe shërbimi shëndetësor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale organizohet pa diskriminim, për shkak të statusit ligjor të personit në institucion, ose për çdo shkak tjetër.

» **Ligji nr. 77/2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008, 'Për ndihmën juridike', i ndryshuar"**

Me këto ndryshime, ligjvënësit shtuan numri e subjekteve që përfitojnë ndihmë juridike, duke përfshirë a) shtetasit shqiptarë me vendbanim në territorin e Republikës së Shqipërisë; b) shtetasit e huaj, që e përfitojnë atë mbi bazën e parimit të reciprocitetit; c) personat pa shtetësi, të pajisur me leje qëndrimi, sipas legjislationit në fuqi; ç) personat me shtetësi të huaj ose personat pa shtetësi, që kërkojnë të pajisjen me leje qëndrimi, që aplikojnë për azil, ose që janë në proces ankimi të vendimeve administrative dhe/ose gjyqësore për refuzimin e lejes së qëndrimit ose kërkesës për azil."

Të ardhurat financiare të pamjaftueshme të personit dhe të personave që janë në ngarkim të tij/saj, përbërja familjare, statusi shoqëror, përfshirja në programet e mbrojtjes sociale, ose plotësimi i kushteve për t'u përfshirë në to, dhe çdo rrethanë tjetër që e vendos personin në kushte pamundësie për të siguruar privatisht ndihmë juridike, janë kritere që vlerësohen nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike [KShNJ].

Një parashikim shumë i rëndësishëm është ai i nenit 16 "Paraqitja e kërkesës dhe dokumentacionit për përfitimin e ndihmës juridike", sipas të cilit, personat që deklarojnë se përfshihen në programet e mbrojtjes shoqërore dhe të miturit përjashtohen nga detyrimi për paraqitjen e dokumentacionit shoqërore. Në këto raste, Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm.

Përrjashtimi nga detyrimi i paraqitjes së dokumentacionit shoqëruar lehtëson mundësitë e grupeve të pambrojtura për të përdorur sistemin e drejtësisë. Në këtë nen parashikohet se, kur ofrimi i ndihmës juridike paraqet urgjencë, vërtetimi i plotësimit të kriterëve mund të bëhet në një moment të mëvonshëm dhe ndihma juridike ofrohet menjëherë.

Këto ndryshime përbëjnë një zhvillim të rëndësishëm në lidhje me garantimin e të drejtës për ndihmë ligjore falas.

» **Ligj nr. 47/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, 'Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore'", i ndryshuar.**

Me këtë ligj përcaktohet se, kërkesa për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet me shkrim nga: a) kryetari i familjes ose njëri nga anëtarët madhorë të familjes; b) secili prej bashkëshortëve, në rastet kur ata janë në proces zgjidhjeje martesë dhe nuk ka ende vendim gjykatë të formës së prerë.

Në nenin 41/1 të këtij ligji parashikohet e drejta e ankimit për përfitimin e ndihmës ekonomike pranë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore dhe, kur kërkuesi gjykon se vendimi i marrë nuk është i drejtë, ankesa paraqitet me shkrim pranë drejtorit të zyrës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

» **Ligj nr. 104/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, 'Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë'", i ndryshuar.**

Ky ligj parashikon përfitimin e pensionit social nga çdo shtetas, i cili ka mbushur moshën 70 vjeç, që është me qëndrim të përhershëm në Shqipëri të paktën për pesë vitet e fundit, që nuk plotëson kushtet për asnjë lloj pensioni nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe që nuk ka të ardhura, ose kur të ardhurat që përfiton nga çdo burim tjetër janë më të ulëta se të ardhurat që jep pensioni social.

Në ligj parashikohet se, "Punonjësit e papaguar të familjes, që punojnë e bashkëjetojnë me të vetë-punësuarin, paguajnë kontribut për barrë-lindje dhe për pensione mbi bazën e pagës minimale në shkallë vendi".

Gjithashtu ligji parashikon se të drejtën e lejes për kujdes ndaj fëmijës e ka edhe babai ose birësuesi i siguruar, nëse nëna nuk e ushtron apo nuk ka kushte për ta përfituar këtë të drejtë.

» **Ligj nr. 120/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, 'Për mbrojtjen e të dhënave personale'", i ndryshuar"**

Me këtë ligj, ka ndryshuar emërtimi nga "Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale" në "Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale".

Ky ligj përcakton kompetencat në fushën e mbrojtjes së të drejtës për informim të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të cilat lidhen me shqyrtimin e kërkesave mbi të cilat ngrihet pretendimi për shkelje të të drejtave të parashikuara në ligjin "Për të drejtën e informimit", ankesave në lidhje me funksionimin e programeve të transparencës të autoriteteve publike, vendosjen e sanksioneve administrative,

kryerjen e monitorimeve, kryerjen e sondazheve, parashkrimin e mendimeve me shkrim për çështje që lidhen me të drejtën e informimit kur këtë e kërkon gjykata, etj.

» **Ligj nr. 161/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 237, datë 18.2.2010, 'Për sigurinë dhe shëndetin në punë'"**

Ky ligj përcakton Inspektoratin Shtetëror që mbulon fushën e punës dhe Inspektoratin Shtetëror që mbulon fushën e shëndetësisë si autoritete shtetërore përgjegjëse për kontrollin e zbatimit të ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë, si dhe përgjegjësitë konkrete me të cilat ata ngarkohen.

Me ligjin Nr. 163/2014 "Për urdhrin e punonjësve socialë në Republikën e Shqipërisë" janë përcaktuar kriteret për ushtrimin e profesionit të punonjësit social, garantimin e standardeve etiko-profesionale në ushtrimin e këtij profesioni, në mbrojtje të interesit publik, duke respektuar parimin e autonomisë së profesionit të punonjësit social. Ligji përcakton organet kryesore të Urdhrit të Punonjësve Social si, Asambleja e Urdhrit, Këshilli Kombëtar i Urdhrit, Kryetari i Urdhrit dhe Komisioni i Gjykimit Disiplinor Profesional.

Ligj nr. 178/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013 'Për nëpunësin civil'", trajton çështje të plotësimit të vendeve të lira të krijuara në mënyrë të përkohshme, plotësimit të vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese, të vlerësimit të rezultateve në punë, etj. Ky ligj parashikon se, vendimet gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë zbatohen menjëherë nga njësia përgjegjëse. Ligji parashikon regjistrimin e nëpunësve civilë në një listë pritjeje deri në sistemimin e tyre në një pozicion të rregullt në shërbimin civil, nëse rikthimi në detyrë është i pamundur. Njësia përgjegjëse është e detyruar që, në momentin e krijimit të një vendi të lirë në shërbimin civil, të emërojë, fillimisht me pëlqimin e tyre, nëpunësit civilë të regjistruar në listë. Ligji parashikon se këta nëpunës, me pëlqimin e tyre, mund të sistemohen edhe për plotësimin e vendeve të lira, të krijuara në mënyrë të përkohshme. Ky ligj ka pësuar ndryshime dhe po plotësohet me akte nënligjore.

I.2. Situata e diskriminimit në Shqipëri

Kjo pjesë paraqet situatën në lidhje me disa nga llojet më të përhapura të diskriminimit, referuar burimeve ekzistuese dhe konstatimeve nga veprimtaria e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Nga praktika e zbatimit të ligjit nr.10221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", vit pas viti po vihet re një ndërgjegjësim më i madh i publikut të gjerë dhe grupeve të veçanta mbi mjetet ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi. Kjo gjë reflektohet edhe në rritjen e numrit të ankesave të regjistruara dhe zbatimin e ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi" edhe në gjykata. Por, edhe pse numri i ankesave ka shënuar rritje, ndërgjegjësimi i popullsisë, mbetet ende një prioritet i KMD-së.

Vlen të theksojmë se rritja e numrit të ankesave të paraqitura pranë zyrës së KMD-së theksohet edhe në Raport Progresin për Shqipërinë për vitin 2014, i cili shprehet se: "Në fushën e **anti-diskriminimit**, numri i ankesave të trajtuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) u rrit nga 107 në 2012, në 256 ankesa në 2013, ndërsa numri i hetimeve

të nisura ex-officio nga KMD-ja është rritur nga 16 në 2012, në 31 në vitin 2013²". Por, duke iu referuar këtij raporti, "Niveli i ndërgjegjësimit publik për ligjin dhe mekanizmin e ankesës mbetet i ulët".³

Në lidhje me situatën e diskriminimit në Shqipëri rezultojnë se përfaqësuesit të grupeve të ndryshme si përfaqësuesit e komunitetit rom dhe egjiptian, personat me aftësi të kufizuara, gratë, përfaqësuesit e komunitetit LGBT, etj, përballen me forma të ndryshme të diskriminimit.

1.2.1. Diskriminimi për shkak të racës

Mbrojtja e minoriteteve dhe gëzimi i të drejtave të tyre në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Neni 18 i Kushtetutës së RSH-së⁴ sanksionon se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Kreu i IV i Kushtetutës vë theksin tek liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, të cilat duhet të gëzohen *de facto*, në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim.

Shteti shqiptar i ka kushtuar një vëmendje përmirësimit të legjisllacionit dhe politikave për minoritetet. Kështu, zhvillimet e legjisllacionit në vitin 2014 krijojnë më shumë mundësi për fuqizimin e komunitetit rom dhe egjiptian në Shqipëri. Gjithashtu, vlerësojmë vëmendjen e qeverisë në integrimin e çështjeve të komunitetit rom dhe egjiptian në disa politika zhvillimi si Strategjia mbi përfshirjen sociale, Strategjia për zhvillim dhe integrim, si edhe përpjekjet për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2015-2020.

Çështjet e komunitetit rom janë çështje prioritare edhe në kuadrin e përbushjes së rekomandimeve të Komisionit Evropian për Shqipërinë dhe të pesë prioriteteve kyçe për hapjen e negociatave për anëtarësim. Një nga këto pesë prioritete është mbrojtja e të drejtave të njeriut (përfshi politikën e mos-diskriminimit, komunitetin rom, si dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë)⁵.

Por, pavarësisht hapave të ndërmarrë nga qeveria shqiptare në nivel të kuadrit ligjor dhe të politikave, si dhe përpjekjeve të vazhdueshme për përbushjen e rekomandimeve të Komisionit Evropian për Shqipërinë, situata e garantimit të të drejtave të këtij komuniteti në praktikë lë për të dëshiruar. Legjisllacioni parashikon mundësi për gëzimin e të drejtave të romëve dhe egjiptianëve, por barrierat më të shumta konsistojnë në efektet e tërthorta që sjell zbatimi i legjisllacionit. Ndonëse kriteret për përfitime të caktuara janë neutrale, ato shpesh nuk mund të përbushen nga pjesëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian, të cilët përjashtohen kështu nga gëzimi real i të drejtave.

Varfëria e komunitetit rom rezultojnë nga studime dhe raporte të ndryshme. Një nga treg-

2 Progres raporti 2014 për Shqipërinë që shoqëron komunikatën e komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian si dhe Komitetin e Rajoneve. Gjetet në uebsajtin e Ministrisë së Integritimit www.integrimi.gov.al

3 Progres raporti 2014 për Shqipërinë që shoqëron komunikatën e komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian si dhe Komitetin e Rajoneve. Gjetet në uebsajtin e Ministrisë së Integritimit www.integrimi.gov.al

4 Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, i ndryshuar.

5 Ministria e Integritimit, Plani Kombëtar për Integrimin Evropian, Qershor 2014.

uesit e varfërisë janë të ardhurat mujore familjare. Kështu, referuar censusit të Popullsisë, "Banesat dhe popullata romë në Shqipëri", rezultojnë se: "Sipas vetë-deklarimeve të ardhurat mujore familjare paraqiten mjaft të ulëta krahasuar dhe me pagën minimale, e cila në vitin 2014 rezultojnë 19,000 lekë në muaj. Kështu rreth 48% e familjeve romë deklarojnë se kanë më pak se 10,000 lekë të ardhura mujore e ndjekur me rreth 35% të familjeve që deklarojnë më pak se 20,000 lekë të ardhura në muaj. Rezultatet tregojnë se më pak se 1% e familjeve romë deklarojnë të ardhura deri në 50,000 lekë në muaj".⁶

Studimet ekzistuese tregojnë se në Shqipëri, **gjendja shëndetësore** e romëve dhe egjiptianëve është më e keqe se ajo e popullsisë së shumicës, çka pasqyrohet edhe në jetëgjatësinë e tyre relativisht më të ulët. Shkaqet e kësaj gjendjeje jo të mirë shëndetësore lidhen me varfërinë, kushtet e vështira të jetesës dhe mungesën e infrastrukturës bazë, qasjen e kufizuar në shërbimet shëndetësore, nivelin e ulët arsimor dhe me disa forma të diskriminimit⁷. Ndërkaq, këto studime tregojnë se, vetëm 58% e romëve dhe 76% e egjiptianëve shprehin se kanë librezë shëndetësore dhe marrin shërbime në qendrën shëndetësore.

Ndihma ekonomike, pagesat e papunësisë, pensionet për fëmijët jetimë janë të pamjaftueshme për të plotësuar nevojat familjare të përfaqësuesve të minoritetit rom. Sistemi i ri i pikëzimit është shoqëruar me ankesa nga përfaqësuesit të këtij komuniteti për përjashtimin e tyre nga përfitimi i ndihmës ekonomike. Një konstatim i tillë është realizuar edhe nga institucioni i Avokatit të Popullit⁸. Vonesat e krijuara në pagesat e ndihmës ekonomike prekën edhe përfaqësuesit e komunitetit rom dhe egjiptian, për të cilët këto pagesa janë e vetmja mundësi për të përballuar jetesën e tyre dhe familjeve të tyre.

Një numër anëtarësh të komunitetit rom nuk përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike ose e humbasin atë për shkak të mospasjes së një vendbanimi të përhershëm. Ashtu si në fushën e arsimit, në të cilën janë marrë masa të veçanta të përkohshme për arsimimin e komunitetit rom, edhe në lidhje me ndihmën ekonomike nevojitet trajtimi i komunitetit rom si një grup i veçantë, i cili të mos përballlet me përjashtime nga ndihma ekonomike për shkak të lëvizjes nga një vendbanim në tjetrin.

Romët dhe egjiptianët punojnë në tregun informal të punës. Të punësuar në tregun informal të punës, përfaqësuesit e këtij komuniteti nuk mund të përfitojnë nga skemat e sigurimeve shoqërore. Me ndryshimet e legjisllacionit të sigurimeve shoqërore, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në RSH", ligji nr. 104, datë 31.7.2014, është parashikuar pensioni social, por përfitimi i tij fillon në moshën 70 vjeç, për të gjithë të moshuarit, që kanë banuar në Shqipëri gjatë 5 viteve të fundit, të cilët nuk përbushin kushtet që nevojiten për të përfituar pension. Nëse konsiderojmë se, bazuar në studime të ndryshme, jetëgjatësia e përfaqësuesve të këtij komuniteti është më e shkurtër, kjo e bën më të vështirë përfitimin në praktikë të pensionit social nga përfaqësuesit e këtij minoriteti.

Ndonëse janë krijuar mundësi për formimin profesional të anëtarëve të komunitetit rom, ndërgjegjësimi i këtij komuniteti për ndjekjen e këtyre programeve nevojitet të rritet. Nevojat dhe kërkesat e këtij komuniteti janë të njohura, por ende nuk shihen nisma serioze për zgjidhjen e tyre nga ana e autoriteteve publike, veçanërisht në drejtim të strehimit dhe

6 Për më shumë në lidhje me censusin dhe metodologjinë shih: Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë,

Census 2014, Banesat dhe Popullata Romë në Shqipëri. Gjetet në www.osfa.al

7 Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Census 2014, Banesat dhe Popullata Romë në Shqipëri. Gjetet në www.osfa.al

8 Rekomandim i Avokatit të Popullit Nr. Dok. 201401869/4, datë 04 /12 /2014.

punësimit të tyre. Kërkohej më tepër vëmendje, investime dhe aksione pozitive për këtë shtresë të marginalizuar të shoqërisë.⁹

Komuniteti rom përballet me problematika të shumta në lidhje me **çështjen e strehimit**. Kështu, të gjendur në pamundësi reale për të zgjidhur çështjen e strehimit, ata zgjedhin rrugë alternative duke u "vetë-sistemuar", gjë e cila pasohet nga informaliteti, shpesh i inkurajuar edhe nga mungesa e reagimit të autoriteteve që i lënë në këtë situatë informaliteti për një kohë të gjatë. Kjo situatë, e kombinuar me një kuadër ligjor të papërshtatshëm për akomodimin e kësaj pjese të shoqërisë, ka sjellë diskriminim të saj. Edhe më problematike është situata kur, për shkak të ndërtimit të veprave publike, apo zhvillimit të pronës nga pronari që është i ndryshëm nga poseduesi i banesës, kërkohej largimi (dëbimi) i kësaj kategorie nga vendbanimet e tyre¹⁰. Largimi nga vendbanimet, pa u ofruar një mundësi të përshtatshme strehimi, dhe mungesa e rregullimeve ligjore në lidhje me ofrimin e akomodimit të përshtatshëm para dëbimit të tyre ngrenë çështje të diskriminimit të anëtarëve të këtij komuniteti dhe të mospërmbushjes së standardeve ndërkombëtare. Këto standarde parashikojnë se: "Lirimet e banesave nuk duhet ta kthejnë personin në të pastrehë dhe nuk duhet ta bëjnë atë të pambrojtur ndaj shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut"¹¹.

Gjatë muajit korrik 2014, KMD-ja ka trajtuar rastin e familjeve romë në qytetin e Elbasanit që do prekeshin nga ndërtimi i Stadiumit "Ruzhdi Bizhuta". Këto familje, me urdhër të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Bashkisë Elbasan, duhet të lironin banesat me qëllim fillimin e investimeve me interes publik, për ndërtimin e Stadiumit "Ruzhdi Bizhuta", ndërkohë që nuk ishte marrë asnjë masë tjetër alternative për strehimin e tyre. Në parim, është plotësisht e ligjshme që, për qëllime publike dhe të zhvillimit urban, të kërkohej lirimi i tokës, por që të jetë i ligjshëm, ai duhet që të jetë proporcional dhe të mos përbëjë diskriminim. Standardet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) i përfshijnë çështjet e shpërnguljeve me forcë në kuadrin e nenit 8 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, respekti për banesën, jetën private dhe familjare. GJEDNJ-ja gjithashtu ka theksuar se mbrojtja nga dëbimet me forcë duhet të garantohet për të gjitha format e strehimit, pavarësisht faktit nëse këto vendstrehime konsiderohen apo jo banesa/shtëpi, sipas përcaktimeve ligjore kombëtare. Komisioneri vlerëson se nëse autoritetet shtetërore, përpara se të ndërmarin veprime për largimin e familjeve romë nga banesat e tyre, nuk bëjnë paraprakisht një analizë dhe vlerësim të gjendjes sociale, nevojave ekonomike të këtyre familjeve, dhe nuk marrin të gjitha masave të nevojshme në maksimumin e burimeve që janë në dispozicion, për të evituar që këta individë të mbeten të pastrehë apo të bëhen të pambrojtur ndaj shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut, kjo gjë do të përbente diskriminim. Për vet specifikat e vendbanimeve të komunitetit rom, si vendbanime në shumicën e rasteve informale, ose vendbanime të cilat nuk përmbushin as kushtet e përcaktuara me ligj për t'u konsideruar si shtëpi/banesë, "shtëpitë" e komunitetit rom janë më shumë subjekt i prishjeve dhe romët janë më shumë subjekte që nuk përfitojnë nga shpronësimet.

Ligji nr. 9232, dt. 13.05.2004 "Për programet sociale të strehimit", i ndryshuar me ligjin nr. 9719/2007, ligjin nr. 54/2012, në nenin 24 të tij parashikon mundësinë e subvencionimit të qerasë. Ky nen, në pikën 2 të tij, parashikon se, familjet e komunitetit rom trajtohen me përparësi në lidhje me subvencionimin e qirasë ose përfitimin e shtesës së strehimit. Sipas këtij

9 KShH, "Raport mbi situatën e respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri për vitin 2014", Tiranë 2014.

10 Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë SOROS, Analizë e legjislacionit për problemet e strehimit, 9 shkurt 2015, f. 5. Ky studim gjendet në www.osfa.al

11 CESCR (1997) Komenti i Përgjithshëm 7, E drejta për një strehim të përshtatshëm: lirimi i detyrueshëm i banesës, shih në: <http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CESCR/Pages/CESCRIndex.aspx>

ligji, familjet romë pa të ardhura mund të përfshihen vetëm në programin social të strehimit për subvencionimin e shtesës të strehimit dhe atë të granteve të vogla, ku ky i fundit arrin të financojë vetëm përmirësim të kushteve të banimit dhe jo strehimin e kësaj kategorie. Gjithashtu programet e tjera sociale, të parashikuara nga ky ligj, kërkojnë që përfituesi të ketë një kufi të caktuar të ardhurash por, duke qenë se këto familje jetojnë në informaliteti, është e vështirë matja e të ardhurave të tyre¹². Shumë nga familjet romë nuk plotësojnë kufirin e caktuar në ligj të të ardhurave. Shumë nga romët dhe egjiptianët nuk arrijnë të përfitojnë nga programet e strehimit social. Jetesa në kushte jo të mira banimi dhe infrastruktura e keqe e shton izolimin e tyre nga pjesa tjetër e shoqërisë dhe luan rol pengues në arsimimin e fëmijëve të tyre¹³.

Edhe Progres Raporti 2014 për Shqipërinë vë theksin tek fakti se: "Ende nuk është identifikuar një zgjidhje afatgjatë dhe e qëndrueshme për strehimin e këtyre personave të dëbuar. Ligji i ri për legalizimin e pronave u miratua në maj, pa konsultim paraprak me grupet e interesit, dhe ka rritur rrezikun e dëbimeve të mëtejshme të familjeve romë nga vendbanimet e tyre informale, gjë që përbën shqetësim të veçantë".

Romët dhe egjiptianët përballen me barriera të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në qasjen e tyre në shërbime publike, të cilat lindin nga kriteret e pranueshmërisë që ata nuk mund t'i plotësojnë, nga mungesa e informacionit, ose nga moskuptimi i procedurave administrative, si dhe nga stigmatizimi dhe diskriminimi i vazhdueshëm nga pjesa tjetër e popullatës.

Komuniteti rom dhe egjiptian përballet me probleme të ndryshme ligjore, të cilat kërkojnë ndihmën e një avokati falas. Ndonëse ligji nr. 10039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën juridike", i ndryshuar, dhe aktet e tij nënligjore kanë parashikuar mundësinë e përfitimit të individëve që vërtetojnë se përfshihen ose plotësojnë kushtet për t'u përfshirë në programet e mbrojtjes sociale, janë viktimat dhune, ose viktimat të fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore, për çështjet gjyqësore që lidhen me to, nuk ka të dhëna në lidhje me numrin e anëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian që kanë përfituar ndihmë juridike falas nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike. Mungesa e informacionit në lidhje me mundësitë që ofron legjislacioni për përfitimin e ndihmës juridike falas dhe pengesa të tjera që lidhen me plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për aplikim kanë penguar gëzimin e kësaj të drejte nga anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian.

Me ndryshimet e ligjit nr.10039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën juridike", i ndryshuar, gjatë vitit 2014, personat që deklarojnë se përfshihen në programet e mbrojtjes shoqërore dhe të miturit përjashtohen nga detyrimi për t'i bashkëngjitur kërkesës për ndihmë juridike falas, dokumentacionin e nevojshëm. Në kushtet e ndryshimeve të fundit që ligji "Për ndihmën juridike", ka pësuar, (ligj nr. 77/2014 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën juridike", i ndryshuar), si përjashtimi i individit nga pagesa e taksës mbi aktet, si dhe përjashtimi nga shpenzimet gjyqësore si në proceset civile ashtu edhe në ato administrative, nevojitet rritja e nivelit të informacionit të këtij komuniteti mbi këto të drejta dhe mbështetja e komunitetit për t'i kërkuar këto të drejta. Në raste urgjente, një përfaqësues i komunitetit rom që përmbush kushtet e përfitimit të ndihmës juridike falas

12 Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë Soros, Analizë e legjislacionit për problemet e strehimit, 9 shkurt 2015, f. 17. Ky studim gjendet në www.osfa.al

13 Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve romë dhe egjiptiane në Shqipëri. Tiranë 2012, Ky studim është përgatitur me mbështetjen financiare të programit Një OKB.

përfiton ndihmë të menjëhershme. Ngritja e zyrave vendore për ofrimin e shërbimit ligjor falas do të mundësonte rritjen e numrit të përfitueseve të komunitetit rom dhe egjiptian nga këto shërbime, jo vetëm në Tiranë por edhe në rrethe.

Problemi i rritjes së qasjes në sistemin e drejtësisë është një problem edhe për grupet e tjera në nevojë, i cili është ngritur si shqetësim edhe në Progres Raportin për Shqipërinë 2014. Kështu, në këtë raport citohet se: *“Për sa i përket qasjes në drejtësi, duhet të përmirësohet funksionimi i Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike dhe duhet të zbatohen dispozitat e miratuara rishtas për ndihmën juridike që parashikojnë ngritjen e zyrave vendore për ndihmën juridike. Tarifat gjyqësore frenojnë shumë qytetarë dhe procedurat e aplikimit janë shumë të ngadalta. Vazhdon të jepet ndihmë juridike falas, kryesisht nga organizatat joqeveritare me financim të donatorëve”*¹⁴.

Një nga të drejtat themelore që garanton Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është e drejta për arsim. Ligji nr. 69, datë 29.6.2012, *“Për sistemin arsimor para-universitar”* synon të vendosë standarde gjithëpërfshirëse në arsimin para-universitar, por përmbushja e këtyre standardeve lë për të dëshiruar.

Masa të veçanta të përkohshme janë ndërmarrë nga shteti shqiptar, si përjashtimi i fëmijëve romë nga pagesa e depozitës së garancisë¹⁵ në Tiranë, nga pagesa e bordeve të prindërve romë në të gjithë vendin, në lidhje me kriteret e përzgjedhjes dhe regjistrimit të kandidatëve romë në programet e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë, në programet e studimeve jo-universitare profesionale, në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet publike të arsimit të lartë (2014 – 2015)¹⁶. Edhe udhëzimi nr. 21/2014 i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MAS) për rritjen e ndjekjes së arsimit parashkollor nga fëmijët romë, ka parashikuar përparësi dhe lehtësi në lidhje me regjistrimin e tyre në kopshet pranë vendbanimeve të këtyre fëmijëve.

Ndonëse, kuadri ligjor në fuqi garanton të drejtën për arsimim të shtetasve shqiptarë pa diskriminim për shkak të racës, ky komunitet përballet me probleme dhe barrierë të ndryshme në gëzimin *de facto* të kësaj të drejte. Arsimimi i fëmijëve romë dhe egjiptianë përballet me sfida dhe vështirësi të ndryshme. Jetesa në kushte jo të mira banimi dhe infrastruktura e keqe e shton izolimin e tyre nga pjesa tjetër e shoqërisë dhe luan rol pengues në arsimimin e fëmijëve të tyre.¹⁷ Largësia e shkollave nga vendbanimet, mungesa e mbulimit në praktikë të transportit falas për nxënësit romë, kur shkollat janë më shumë se 2 km larg vendbanimeve të tyre, stereotipat se vajzat rome duhet të martohen në moshë të hershme, dhe varfëria në familje janë disa nga problematikat me të cilat përballen fëmijët romë dhe egjiptianë. Pengesat institucionale gjithashtu kanë pasoja në arsimimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë. Pengesat institucionale përfshijnë mungesën e kapaciteteve, cilësinë e arsimit, largësinë e shkollës nga vendbanimi dhe elemente të diskriminimit¹⁸.

Ndonëse, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 709 datë 5.10.2011 *“Për përdorimin e fondeve*

14 Komisioni Europian, Progres Raporti 2014 për Shqipërinë, gjendet në www.integrimit.gov.al

15 Udhëzimi nr. 21/8.8.2014 *“Për rritjen e ndjekjes së arsimit parashkollor nga fëmijët romë”*

16 Udhëzimi nr. 34, datë 30.09.2014 *“Për kriteret, procedurat e përzgjedhjes, regjistrimit të kandidatëve me statusin e të verbrit, të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të jetimit, të romëve dhe egjiptianëve, në programet e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë, në programet e studimeve jo-universitare profesionale, në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet publike të arsimit të lartë (2014 – 2015)”*.

17 Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri. Tiranë 2012, Ky studim është përgatitur me mbështetjen financiare të Programit Një OKB.

18 Sinani Gj., Taho B., Country Assessment Albania, Roma Education Fund, 2011. <http://www.romaeducationfund.hu/>

publike për transportimin e mësuesve dhe të nxënësve që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit”, parashikon detyrimin e mbulimit të shpenzimeve për transportin e nxënësve për distanca mbi 2 km, në praktikë rezultoi se, largësia e shkollës nga vendbanimi është një arsye tjetër që pengon arsimimin e fëmijëve, gjë që theksohet nga 18% e prindërve romë dhe 8% e atyre egjiptianë.¹⁹

Fëmijët romë kanë qenë në vëmendjen e veprimtarisë së KMD-së gjatë vitit 2014. Duke i konsideruar problematikat me regjistrimin e fëmijëve romë si shqetësuese, dhe që ndikojnë në pakësimin e mundësive të fëmijëve romë për të gëzuar të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore, KMD-ja ka mbajtur një qëndrim aktiv në lidhje me zgjidhjen e tyre. Në shkresën me nr. prot. 757, datë 11.09.2014, *“Dërgohen rekomandime për marrjen e masave për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim, në fillimin e vitit shkollor 2014-2015 në sistemin arsimor para-universitar”*, dërguar Ministres së Arsimit dhe Sportit, KMD-ja ka ngritur çështje të regjistrimit, shpërndarjes dhe frekuentimit të shkollave nga ana e fëmijëve romë dhe egjiptianë.

Në lidhje me punën e fëmijëve, mbetet shumë i lartë numri i fëmijëve (kryesisht romë) që punojnë ose lypin në rrugë dhe që janë objekt i formave më të këqija të shfrytëzimit dhe marginalizimit ekstrem²⁰.

Përfaqësimi i romëve dhe egjiptianëve në jetën politike dhe në vendimmarrje është ende i ulët. Pavarësisht parashikimeve të masave të veçanta të përkohshme në Konventën CEDAW, në ligjin *“Për barazinë gjinore në shoqëri”*, ligjin *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”* dhe Kodin Zgjedhor, gratë dhe vajzat rome dhe egjiptiane nuk janë pjesë aktive e politikave dhe vendimmarrjes në jetën politike. Në përfundim, referuar edhe Progres Raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë 2014, *“Kushtet e jetesës, qasja në arsim, punësim dhe kujdesin shëndetësor e social për popullsinë rome duhet të përmirësohen”*.

Nisur nga fakti që, njësitë e pushtetit vendor nuk kanë buxhet të mjaftueshëm dhe kapacitete administrative për politika të përfshirjes së romëve dhe egjiptianëve, duhet të përmirësohet bashkëpunimi ndërmjet pushtetit vendor dhe qendror.

Duke ndjekur situatën e komunitetit rom dhe egjiptian në Shqipëri, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka pasur dhe vazhdon të ketë në vëmendje përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve, lidhur me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të romëve dhe egjiptianëve. Komisioneri edhe gjatë vitit 2014 ka shqyrtuar ankesa të anëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian, si edhe ka realizuar ditë të hapura, të cilat kanë bërë të mundur takime me anëtarë të komunitetit dhe ngritjen e problematikave nga ana e tyre. Problematikat me të cilat përballet komuniteti rom dhe ai egjiptian kanë konsistuar kryesisht në mospërfitimin e ndihmës ekonomike, trajtim jo të barabartë në lidhje me të drejtën e tyre për punë, gjuhë fyese e përdorur nga forcat e rendit ndaj tyre, si dhe të drejtën e tyre për strehim, etj.²¹

19 Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve romë dhe egjiptiane në Shqipëri, Tiranë 2012. Ky studim është përgatitur me mbështetjen financiare të Programit Një OKB.

20 Komisioni Europian, Progres Raporti 2014 për Shqipërinë. Gjendet në uebsajtin e Ministrisë së Integritimit www.integrimit.gov.al

21 Për më shumë në lidhje me rolin e KMD për garantimin e të drejtave të minoritetit rom dhe egjiptian dhe zgjidhjen e problematikave me të cilat përballen, shih Kapitullin e II – Veprimtaria e KMD-së në mbrojtjen nga sjelljet diskriminuese dhe promovimin e barazisë.

1.2.2. Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar

Të drejtat dhe liritë themelore të personave me aftësi të kufizuara dhe garantimi i tyre në praktikë sanksionohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Është ratifikuar Konventa e OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, me ligjin nr. 108/2012. Konventa “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara” ka si qëllim të nxisë, mbrojtje dhe të sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre. Disa nga parimet e kësaj Konvente janë parimi i mosdiskriminimit, mundësi të barabarta, pjesëmarrje dhe përfshirje e plotë dhe efektive në shoqëri, etj. Në kuadrin e barazisë dhe mosdiskriminimit, Konventa kërkon nga shtetet palë marrjen e masave specifike të nevojshme për të përshpejtuar apo realizuar *de facto* barazinë e personave me aftësi të kufizuara.

Ligji kuadër nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, ka qëllim nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, sigurimin e kushteve të barabarta dhe mosdiskriminim e tyre. Një nga parimet që përshkon ligjin është realizimi progresiv i tyre, sipas të cilit Qeveria duhet të ndërmarrë masa për të garantuar përfshirjen dhe qasjen e të gjithë personave me aftësi të kufizuara në nivelin më të lartë që lejohet burimet e disponueshme, pa cenuar të drejtat e fituara të tyre, të cilat janë në përputhje me Konventën e OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Ligji parashikon ngritjen e komisioneve multidisiplinare, me qëllim vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe identifikimin e nevojave për shërbime. Gjithashtu, ky ligj parashikon ngritjen e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar (KKAK), organ këshillimor i kryesuar nga ministri, i cili mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe që ka në përbërje të tij 17 anëtarë, nga të cilët 7 anëtarë janë individë me aftësi të kufizuara, ndër të cilët pesë përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara dhe dy të organizatave për persona me aftësi të kufizuara. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, në zbatim të detyrimeve të parashtruara në ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”²². Pavarësisht se ekziston një kuadër ligjor që garanton të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, zbatimi i këtij kuadri ligjor përbën një domosdoshmëri për të gjithë aktorët përgjegjës. Zbatimi i ligjit të ri kornizë kërkon përmirësime të konsiderueshme në infrastrukturë dhe qasje të barabartë në shërbime²³. FSHDPAK-u ka ngritur shqetësimin e mbështetjes financiare në zbatim të këtij ligji dhe akteve të tij nënligjore²⁴. Reformimi i komisioneve aktuale të KMCAP-ve dhe ngritja e komisioneve multidisiplinare dhe në përputhje me modelin bio-psiko-social të Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, duhet të jetë një nga prioritetet e zbatimit të këtij ligji, pasi në këtë mënyrë do të garantohet që personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë.

Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” rregullon zbatimin e parimit të barazisë, përveç të tjerave, edhe në lidhje me aftësinë e kufizuar. Përveç përcaktimeve të diskriminimit të drejtpërdrejtë, diskriminimit të tërthortë, diskriminimit për shkak të sho-

22 Ligji kuadër nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e PAK”, neni 16, “Monitorimi”.

23 Komisioni Europian, Progres Raporti për Shqipërinë 2014. Gjetet në www.integrimi.gov.al

24 FSHDPAK, Objektivat e programit qeverisës dhe planet për aftësinë e kufizuar. Raport vëzhgimi. Tiranë 2014, f. 23. Ky raport u përgatit me mbështetjen e “Civil Rights Defenders”.

qërimit, etj, ky ligj përcakton “Mohimin e një përshtatjeje të arsyeshme”²⁵ si një formë diskriminimi. Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në raportin mbi situatën e respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri, evidenton probleme në lidhje me garantimin në praktikë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Në raport theksohet se: “Me gjithë përmirësimet, ka ende vonesa në kryerjen e pagesave që ky komunitet përfiton, veçanërisht në zonat periferike të vendit, ka probleme me arsimimin e këtyre shtetasve, me ofrimin e shërbimeve mjekësore dhe rehabilituese për ta, me punësimin etj. Po punohet me ritme të ulëta për zbatimin e standardeve që përcakton Konventa ‘Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara’”.²⁶

Ndonëse ligji nr. 7995, dt. 22.09.1995 “Për nxitjen e punësimit” (i ndryshuar), në nenin 15 Ndonëse ligji nr. 7995, dt. 22.09.1995 “Për nxitjen e punësimit” (i ndryshuar), në nenin 15 parashikon se: “Çdo punëdhënës që punëson më tepër se 24 punonjës është i detyruar të punësojë një person me aftësi të kufizuara për çdo 25 punonjës të personelit të tij. Inspektorati Shtetëror i Punës kontrollon zbatimin e këtij neni”, por punëdhënësit shpesh nuk e përm-bushin këtë detyrim. Nevojitet që Inspektorati Shtetëror i Punës të kontrollojë zbatimin e këtij neni, jo vetëm nga subjektet private, por edhe nga institucionet publike në nivel qendror dhe vendor. Kjo situatë rezultoi edhe nga Raporti i posaçëm i veprimtarisë së Avokatit të Popullit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara (PAK) në institucionet e pushtetit qendror e lokal²⁷. Nga ky raport ka rezultuar se nga 2334 persona të punësuar, 0.17% e të punësuarve në nivel qendror janë persona me aftësi të kufizuara, dhe nga 1096 persona të punësuar, 3.1% e të punësuarve në nivel lokal janë persona me aftësi të kufizuara.

Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 248/30.4.2014, “Programi i nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara”, krijohen lehtësi për punëdhënësit që punësojnë punëmarrës me aftësi të kufizuara dhe për vetë punëmarrësit me aftësi të kufizuara. Zyra e Punës financon punëdhënësit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara jo vetëm me një financim mujor në masën deri në 100 % të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, nga pjesa e kontributit të punëdhënësit, me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se një vit, por edhe me një financim për të pajisur siç duhet vendin e punës/transportin (përshtatja e arsyeshme) e personit me aftësi të kufizuar dhe për t’i siguruar atij/asaj një përgatitje thelbësore për punën. Në kuadrin e këtij programi, Zyra e Punës financon punëmarrësin, punëkërkuesin e papunë, personin me aftësi të kufizuar, me një financim mujor në masën deri në 100 % të nivelit të pagës minimale në shkallë vendi, deri në 6 (gjashtë) muajt e parë të punësimit dhe me një financim mujor në masën deri në 50 për qind të nivelit të pagës minimale në shkallë vendi deri në 6 (gjashtë) mujorin e dytë të punësimit. Por, numri i kompanive që kanë përfituar nga ky program është shumë i kufizuar, ashtu si edhe vetë numri i punëkërkuesve të papunë që kanë përfituar nga ky program.²⁸

Realizimi i përshtatjes së arsyeshme të ambienteve të punës për personat me aftësi të kufizuara si nga institucionet e pushtetit qendror e lokal ashtu edhe subjektet private është

25 Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 3, pika 7.

26 Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Raport mbi situatën e respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri për vitin 2014.

27 Avokati i Popullit, Raport i Veçantë, “Raporti i posaçëm i veprimtarisë së Avokatit të Popullit për punësimin e personave me Aftësi të Kufizuar (PAK) në institucionet e pushtetit qendror e lokal”, Tiranë 2013.

28 Risi Albania, Partner for Growth, MMSR, “Programet për Nxitjen e Punësimit në Shqipëri: vlerësimi i cilësisë së tyre në proceset e formulimit dhe zbatimit (2008-2014)”, Tiranë 2014. <http://www.kerkojpine.gov.al/publikime-shkp/>

immediate. Përshtatja e arsyeshme e ambienteve të punës për personat me aftësi të kufizuara do të krijonte mundësi të barabarta në marrëdhëniet e punës. Sigurimi në përqindje të ulëta i transportit të përshtatur nga punëdhënësit ndikon në punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Sipas Raportit të Progresit për Shqipërinë 2014, të Komisionit Europian, rezultojnë se në lidhje me të gëzimin e të drejtës për arsim, janë trajnuar mësuesit e shkollave dhe edukatorët e kopshteve që të promovojnë përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Por, pavarësisht masave të ndërmarra, rezultojnë se personat me aftësi të kufizuara përballen me vështirësi për të pasur qasje në arsim.²⁹

Në lidhje me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, i ndërgjegjshëm për rëndësinë e garantimit të kësaj të drejte në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim, KMD-ja ka rekomanduar marrjen e masave të nevojshme. Kështu, KMD-ja ka dërguar rekomandime për marrjen e masave për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën e arsimimit në fillimin e vitit shkollor 2014-2015 në sistemin arsimor para-universitar, duke rekomanduar në mënyrë urgjente krijimin dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinare për vlerësimin e nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.³⁰

Mungesa e aksesit në hapësirat publike mbetet ende një çështje që kërkon vëmendje. Mungesa e aksesit fizik në disa prej ndërtesave publike shkakton gjithashtu diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara në fushën e të mirave dhe shërbimeve, veçanërisht mund të cenojë qasjen në institucionet shëndetësore, shërbime të cilat janë jetike për personat me aftësi të kufizuara. Sigurimi i të drejtës së votës është i lidhur ngushtësisht me përshtatjen e arsyeshme të ambienteve të qendrave të votimit. Nevojiten ndryshime në Kodin Zgjedhor me qëllim që të mundësohet votimi i personave me aftësi të kufizuara që nuk dalin nga shtëpia. KMD-ja ka dërguar rekomandim për marrjen e masave ligjore për të siguruar votimin e personave me aftësi të kufizuara që nuk dalin dot nga shtëpia.

Pozitive vlerësohet urdhri nr. 239, datë 11.12.2013 i Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndërministror për zbatimin e rregullave të përshtatshëm ndërtimore në institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore”.

Vendimi nr. 404, datë 20.6.2012 “Për përcaktimin e masës së kriterëve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse”, parashikon kompensimin financiar për faturat e energjisë elektrike dhe telefonisë fikse për personat me statusin e të verbrit dhe invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik. Nevojitet rimbursimi në kohë dhe në mënyrë sistematike i personave me aftësi të kufizuara.

Numri i ankesave nga personat me aftësi të kufizuara ka ardhur duke u rritur në vite, por në raport me situatat diskriminuese me të cilat ata përballen është i ulët.

Sipas një raporti të Fondacionit Shqiptar për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, “Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e aftësisë së kufizuar”, rezultojnë se: “Nga ana tjetër konstatohet se numri i ankesave kundër sektorit privat, në krahasim me atë publik

²⁹ Komisioni Europian, Progresi Raporti për Shqipërinë 2014. Gjetet në uebsajtin e Ministrisë së Integritimit www.integrimi.gov.al

³⁰ Për më shumë shih në këtë Raport çështjen: “II.2.2. Rekomandime të tjera për çështje diskriminimi”.

mbetet i vogël, pavarësisht se ka tendence rritje krahasuar me vitet e kaluara. Duke qenë se administrata publike ofron një sërë shërbimesh për qytetarin dhe se përgjithësisht ai është sektori me të cilin qytetari përballlet më shpesh, kështu që ai është dhe sektori kundër të cilit edhe numri i ankesave është dhe më i madh³¹.

Fondacioni Shqiptar për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara ka konstatuar se: “Nga vëzhgimi i situatës vihet re se, personat me aftësi të kufizuara e kanë shumë të vështirë të fillojnë vetë procedura për raste diskriminimi, për një mori shkaqesh: jo vetëm sepse në shumë raste bërja e një ankese pranë Komisionerit apo në gjykatë ka një kosto financiare, pasi personave me aftësi të kufizuara u duhet të bëjnë më shumë shpenzime që nga moment i daljes nga shtëpia për shkak të papërshtatshmërisë, apo p.sh. për kthimin e ankesës në versionin braille, apo për marrjen e një përkthyesi shenjash në rastin e personave që nuk dëgjojnë, por nga ana tjetër, jo në çdo rast janë të informuar për natyrën dhe mekanizmat ligjorë që mund të përdorin në kuadër të ligjit për “Mbrojtjen nga diskriminimi”.³²

Problematikat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri janë identifikuar edhe nga shqyrtimi i ankesave dhe çështjeve të nisura me iniciativë të KMD-së. Objekti i ankesave që ngrenë pretendime për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, lidhet me mohimin e përshtatjes së arsyeshme, mosofrimin e të mirave dhe shërbimeve dhe moszbatimin e legjislacionit në lidhje me përfitimin e rimbursimit të tarifës së shkollimit në arsimin e lartë, dhe integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin e zakonshëm.

Mbledhja e të dhënave të përshtatshme statistikore dhe kërkimore për aftësinë e kufizuar nga INSTAT dhe strukturat e tjera përgjegjëse, do të ndihmonte në hartimin e politikave përfshirëse dhe efikase.

I.2.3. Diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor

Neni klasik i barazisë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë garanton barazinë e shtetasve para ligjit. Komuniteti i lezbikeve, gejve, biseksualëve e transgjitorëve [LGBT] në Shqipëri, duhet të gëzojë të drejtat kushtetuese si të gjithë individët e tjerë dhe të mos diskriminohen.

Mbrojtja e të drejtave të personave LGBT është aktualisht pjesë e Udhërrëfyesit për 5 Prioritetet e rekomanduara nga Komisioni Europian, dhe konkretisht për zbatimin prioritetit 5 “Të drejtat e njeriut”.

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 12 të tij ndalon diskriminimin e personit në lidhje me të drejtën e punësimit, neni 17 ndalon çdo dallim, kufizim ose përjashtim në fushën e arsimit dhe neni 20 ndalon diskriminimin e një personi fizik ose juridik, në formën e refuzimit për t’i dhënë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime, ndër të tjera edhe për shkak të orientimit seksual.

Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi ka evidentuar se duhet ndërhyrë në kuadrin ligjor ekzistues për të realizuar një përafrim të legjislacionit ekzistues me ligjin nr. 10221,

³¹ Fondacioni Shqiptar për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, “Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e aftësisë së kufizuar”, Tiranë 2014, f. 64. Ky raport u realizua me mbështetjen e Civil Rights Defenders.

³² Fondacioni Shqiptar për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, “Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e aftësisë së kufizuar”, Tiranë 2014, f. 38. Ky raport u realizua me mbështetjen e Civil Rights Defenders.

datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, gjë që do të rrisë garancitë ligjore edhe për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT³³. Kështu janë propozuar ndryshime ligjore³⁴ në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, Kodin e Punës së RSH-së dhe ligje të tjera, me qëllim përafrimin e legjislacionit me ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Edhe në Raport Progresin e BE-së për Shqipërinë 2013 në lidhje me të drejtat e këtij komuniteti, theksohet se “Autoritetet shqiptare duhet të zbatojnë edhe legjislacionin ekzistues edhe të hartojnë legjislacion të ri në fushën e anti-diskriminimit”. Por, pavarësisht standardeve ndërkombëtare të pranuar, përmes ratifikimit të konventave për të drejtat e njeriut dhe legjislacionit të brendshëm, KMD-ja vlerëson se situata e komunitetit LGBTI ka nevojë për përmirësime.

Raport Progresi 2014 për Shqipërinë ka theksuar si arritje në lidhje me të drejtat e personave lesbike, homoseksualë, biseksualë, transeksualë dhe ndërgjinorë (LGBTI), përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile për këtë çështje. Gjithashtu, në këtë raport është theksuar festimi i Ditës Ndërkombëtare Kundër Homofobisë dhe mungesa e rasteve të shprehjes së homofobisë nga politikanët apo zyrtarët e shtetit. Raporti tërheq vëmendjen në lidhje me miratimin e ndryshimeve në Kodin e Familjes, në lidhje me njohjen ligjore të bashkëjetesës së çifteve të të njëjtit seks. Por, pavarësisht aktiviteteve ndërgjegjësuere të organizuara nga aktorë të ndryshëm, sensibilizimi për të drejtat LGBTI mbetet ende shumë i ulët³⁵.

Organizatat jofitimprurëse që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut kanë ngritur çështje shqetësuese me të cilat përballen ky komunitet. Kështu, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) ka tërhequr vëmendjen në lidhje me një peticion të firmosur nga disa intelektualë, i bërë publik në ditën e diversitetit. Sipas KSHH-së, ky peticion kishte në thelb kërkesën e firmëtarëve që komuniteti LGBT të mos gëzojë të drejtën për jetë familjare dhe se përmbante në vetvete shprehje fyese, që nuk janë në linjë me parimet e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut³⁶. Shqetësimi në lidhje me peticionin e këtyre intelektualëve është ngritur edhe nga Ambasada Pink. Raporti i KSHH-së nënvizon si të nevojshme që personat e komunitetit LGBT, që janë viktimat të diskriminimit, të kontribuojnë për informimin e publikut të gjerë rreth veçorive që e karakterizojnë këtë komunitet.

Ligji “Për arsimin para-universitar në Republikën e Shqipërisë” i miratuar në vitin 2012 ka parashikuar si shkaqe të diskriminimit edhe “orientimin seksual”. Neni 5/ 1 i ligjit nr. 69/2012 “Për arsimin para-universitar në Republikën e Shqipërisë”, ndonëse nuk i përfshin të gjitha shkaqet e parashikuara në nenin 1 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ka lënë hapësira të mjaftueshme për zbatimin e këtij të fundit nga sistemi arsimor para-universitar³⁷. Në lidhje me garantimin e të drejtës së personave LGBTI për t’u arsimuar, është e rëndësishme që informacionet për këtë komunitet të bëhen pjesë e programit mësimor dhe stafet akademike të trajnohen sistematikisht.

Zyra e Komisionerit ka qenë pjesë e grupit të punës për hartimin e “Planit të masave për mosdiskriminimin për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor 2012- 2014”, duke

33 KMD, Raport i veçantë “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit LGBTI në Shqipëri”, f.7.

34 Për më shumë shih rekomandimet legjislative në këtë raport.

35 Komisioni Europian, Progresi Raporti 2014 për Shqipërinë. Gjetet në uebsajtin e Ministrisë së Integritimit www.integrimi.gov.al

36 Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Raport mbi situatën e respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri për vitin 2014.

37 KMD, Raport i veçantë “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit LGBTI në Shqipëri”, f.13.

dhënë kontributin e tij në propozimet për ndryshimet në kuadrin ligjor dhe për politikën anti-diskriminim në punësim, arsim dhe në fushën e të mira dhe shërbimeve.

Edhe gjatë vitit 2014 është konstatuar se ka homofobi jo vetëm në ambientet shkollor apo të punës, por edhe në ofrimin e shërbimeve. Diskriminimi ndaj personave LGBT lidhet me paraqitjen e jashtme ose sjelljen e tyre. Ndryshimet që iu bënë Kodit Penal me ligjin nr. 144, miratuar në datë 2.5.2013, dhe konkretisht në nenin 50, ku u përfshi si rrethanë rënduese kryerja e një veprë penale e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me identitetin gjinor dhe orientimin seksual, apo ndryshimi në nenin 265 të Kodit Penal ku është parashikuar si vepër penale nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve, për shkak të orientimit seksual, nuk kanë shënuar asnjë ndryshim në statistikat e Ministrisë së Drejtësisë për periudhën pas miratimit të këtyre ndryshimeve. Sipas Vjetarit Statistikor të Ministrisë së Drejtësisë 2013, nuk rezultoi të jetë gjykuar asnjë person për veprën penale të parashikuar nga neni 265 i Kodit Penal. Këtu nuk përfshihen të dhënat për vitin 2014, pasi këto të dhëna nuk rezultojnë të publikuara në momentin e hartimit të këtij raporti.

Personat LGBT vuajnë nga shërbime të pakta mjekësore dhe psikologjike, duke qenë se sistemi mjekësor shqiptar është shumë i papërgatitur për adresimin e nevojave dhe problemeve të këtij komuniteti³⁸. Edhe qasja e tyre në shërbimet sociale është e kufizuar.

Ankesat e paraqitura për shqyrtim pranë KMD-së dhe çështjet e nisura kryesisht nga institucioni kanë pasur si pretendime diskriminimin në lidhje me të drejtat për punësim, arsim dhe ofrimin e të mirave dhe shërbimeve apo probleme të garantimit të së drejtës për strehim, komentet homofobike si edhe shprehjet kundër martesave gei dhe paradave të LGBT-ve.

Analiza e çështjes së garantimit *de facto* të të drejtave të komunitetit LGBTI kërkon të dhëna në lidhje me qasjen e personave LGBTI në punësim, arsim, për shërbimet shëndetësore të përfituara, shërbimet sociale, etj, të cilat aktualisht nuk janë të mjaftueshme.

I.2.4. Diskriminimi për shkak të gjinisë

Barazia dhe mbrojtja nga diskriminimi janë parime që përshkojnë të drejtën ndërkombëtare dhe legjislacionin tonë të brendshëm për të drejtat e njeriut. Por, ndërsa barazia është një komponent thelbësor i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, pabarazitë gjinore vazhdojnë të jenë të pranishme në shoqërinë tonë.

Në aktet ndërkombëtare në nivelin e OKB-së, nivelin e Këshillit të Evropës dhe të drejtës së BE-së përfshihen akte që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin. Konventa CEDAW është një nga aktet ndërkombëtare më të rëndësishme në fushën e barazisë gjinore, e ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 7767, datë 9.11.1993.³⁹

KMD-ja ka kontribuar në përbërje të Grupit Ndërmintor të Punës, ngritur me urdhrin e Kryeministrit nr.112/2014, në përgatitjen e Raportit të Katërt Periodik Kombëtar mbi zbatimin e Konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, miratuar

38 Ambasada Pink, Raporti i aktiviteteve, qershor 2013-Dhjetor 2014, gjendet në <http://www.pinkembassy.al/sites/default/files/uploade/Raporti%20Vjetor%20i%20Pink%202014.pdf>

39 Ligji nr. 7767, datë 9.11.1993, “Për aderimin në Konventën ‘Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave’”.

me VKM nr. 806, datë 26.11.2014.

Përmes materialit të dërguar për përgatitjen e këtij raporti, KMD-ja ngriti disa shqetësime me të cilat përballen gratë në Shqipëri.

Së pari, gratë përballen me diskriminim në marrëdhëniet e punës. Në 2013, shkalla e papunësisë sipas gjinisë është 9.3% për meshkujt dhe 13.7% për femrat⁴⁰. KMD-ja ka konstatuar diskriminim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë për shkak të gjinisë, qoftë nga organet e administratës shtetërore ashtu edhe nga subjektet private.

Së dyti, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, gratë përballen me pabarazi dhe forma të drejtpërdrejta dhe të tërthorta diskriminimi. Diskriminimi në ofrimin e shërbimeve, si furnizimi me ujë të pijshëm dhe energji elektrike, ka sjellë në vëmendjen e KMD-së nevojën për një rishikim të kontratave tip të hartuara nga entet rregullatore, sidomos të dispozitave mbi "*Klientin familjar*", duke përcaktuar në mënyrë të qartë kush përfshihet në këtë koncept. Për këtë qëllim KMD-ja i ka dërguar rekomandim CEZ shpërndarje Sh.a, për rishikimin e kontratës tip, me qëllim shmangien e trajtimit të pabarabartë mes burrave dhe grave në ofrimin e shërbimit të furnizimit me energji elektrike.⁴¹ Përmes këtij rekomandimi, KMD-ja synon që vendimet e marra në lidhje me çështjen konkrete të marrin rëndësi strategjike dhe të ndryshojnë jo vetëm situatën në të cilën ndodhet një grua, por edhe situatën e grave dhe vajzave si grup gjinor.

Nga shqyrtimi i ankesave nga KMD-ja rezulton se objekti i ankesave me pretendim diskriminimi për shkak të gjinisë, përgjithësisht ka qenë mosrespektimi i të drejtave në fushën e të mirave dhe shërbimeve si nga institucionet publike, ashtu dhe subjektet private.

Së treti, qasja e grave në përfitimet sociale dhe ekonomike lë për të dëshiruar. Vitet e fundit janë ndërmarrë masa pozitive për **fuqizimin e grave**, kryesisht në sektorin ekonomik. Megjithatë qasja e grave në kredi, hua bankare, ndihma hipotekare dhe forma të tjera të kreditit financiar është ende i ulët. Kryesisht kërkesa për kredi dhe huamarrje bëhen kryesisht nga meshkujt.⁴² Ata janë individët që veprojnë me cilësinë e kryefamiljarëve, duke vështirësuar pozitën e femrave në marrjen e kredive. Mundësitë e kufizuara të grave për të përfituar nga format e kreditit financiar janë të lidhura ngushtë edhe me një praktikë të përhapur në shoqërinë tonë, ku prona regjistrohet më së shumti në emër të mashkullit, i cili vepron edhe në cilësinë e kryefamiljarit.

KMD-ja ka ngritur shqetësimin se pavarësisht arritjeve në shfuqizimin e ligjeve diskriminuese, ende mbetet shumë për të bërë në këtë drejtim. Ligji Nr. 9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", në nenin 4 pika 10, vendos një kriter diskriminues bazuar në gjininë e personit përmes përkufizimit që bën për termin "*Kryetari i familjes*", duke vendosur babanë në krye të hierarkisë për t'u cilësuar kryetar familjeje e për pasojë edhe si personi që përfiton ndihmën ekonomike. Sipas renditjes që bën ky ligj, automatikisht krye-

40 Fletore Zyrtare nr.187/2014, Raportit të Katërt Periodik Kombëtar mbi zbatimin e Konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave", miratuar me VKM nr.806, datë 26.11.2014, f.10195.

41 Rekomandimi i Komisionerit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi drejtuar Entit Rregullator të Energjisë, për rishikimin e kontratës tip mbi "*Kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë*".

42 Shih studimet e kryera nga Qendra Shqiptare për Studime Ekonomike (ACER) dhe nga Shoqata e Grave Afariste dhe Profesioniste në vitin 2006. Sipas studimit të ShGAP konkludohet se gratë që kanë marrë kredi nga bankat kanë hasur pengesa. Pengesat kanë qenë të lidhura me biznesin të cilin ato zhvillojnë [81,3%]; me përgatitjen e plan biznesit [76,7 %], me përgatitjen e dokumenteve bankarë [72,7%] dhe me termat e kolateralit [70%].

familjar është burri dhe vetëm në mungesë të tij, radha kalon tek gruaja-nëna. Komisioneri, në zbatim të kompetencave të tij, ka përgatitur rekomandimet përkatëse për ta sjellë këtë ligj në përputhje me ligjin "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*". Kjo çështje është konstatuar edhe në Vërejtjet Përmblyëse të Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, i cili ka bërë thirrje për fuqizimin e përdorimit të masave të përkohshme dhe të veçanta, në pajtim me nenin 4, paragrafi 1, të Konventës CEDAW. Ky Komitetet ka rekomanduar që: "*Të zbatohen masat e përkohshme dhe të veçanta, me qëllim që të sigurojnë barazinë e grave dhe burrave në mundësimin e pasurisë, kapitalit dhe kredive, shërbimeve të kujdesit shëndetësor, strehimit dhe në përgjithësi të gjithë përbërësit e një standardi të përshtatshëm të jetesës, veçanërisht në lidhje me gratë që u përkasin grupeve të privuara, duke përfshirë gratë dhe vajzat që u përkasin minoriteteve gjuhësore dhe etnike, gratë e moshuara, gratë me aftësi të kufizuara, dhe gratë që banojnë në zonat rurale dhe të largëta...*"⁴³

Gjithashtu, lidhur në lidhje me qasjen e grave në prona, hua dhe kredi, në vitin 2012, UN Women, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, ka realizuar një studim mbi të drejtat pronësore të grave në Shqipëri, në të cilin është konstatuar e njëjta problematikë.

Së katërti, KMD-ja ka ndjekur me vëmendje hapat e ndërmarrja në lidhje me rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje dhe ka vlerësuar si të domosdoshme nevojën për ndryshime në kuadrin ligjor. Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri", sanksionoi kuotën gjinore, me qëllim përfaqësimin e barabartë gjinor në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike. Me gjithë angazhimin për vendosjen e kuotës gjinore, sipas parashikimeve në nenin 67/6 të Kodit Zgjedhor, në vitin 2013, në Legjislaturën e VIII-të të Kuvendit, gratë janë të përfaqësuara në nivelin 18%⁴⁴. Në vitin 2014, numri i grave është rritur në 21% për shkak të vendeve bosh (neni 64/6, Kodi Zgjedhor).⁴⁵

Pavarësisht kriterëve të vendosura nga neni 67 i Kodit Zgjedhor, në praktikë, një parashikim i tillë tregon se ka një boshllëk ligjor. Formula e vendosur për listat shumë emërore të kandidatëve sipas të cilës, "*Të paktën tridhjetë për qind e listës shumë emërore dhe një në tre emrat e parë të listës shumë emërore duhet t'i përkasë secilës gjini*" nuk garanton respektimin e kuotës gjinore prej 30%. Lidhur me këtë problematikë dhe më gjerë, Komisioneri ka përgatitur një rekomandim legjislativ, i cili i është dërguar Kuvendit të Shqipërisë gjatë muajit qershor të vitit 2014.

Lidhur me *pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje*, nga të dhënat e paraqitura në botimin e INSTAT, "Femra dhe meshkuj në Shqipëri 2013", vihet re tendenca që me rritjen e pozicionit apo nivelit drejtues, kemi një ulje të pjesëmarrjes së grave në pozicione drejtuese. Kështu nga 55 ambasadorë, vetëm 6 janë femra, ndërsa meshkujt 49; nga 13 rektorë, vetëm 1 është femër, kurse 12 janë meshkuj; gjyqtarët dhe prokurorët meshkuj janë më të shumtë në numër se sa gjyqtarët apo prokurorët femra, dhe kjo diferencë rritet me rritjen e niveleve drejtuese; të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë janë meshkuj (15); ndërsa raporti gjinor i anëtarëve të Gjykatës së Lartë është 12 meshkuj dhe 4 femra.

43 Vërejtje Përmblyëse të Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, par.23, Sesioni i dyzetëgjashtë 12-30 korrik 2010.

44 Femra dhe Meshkuj në Shqipëri 2013, botim i INSTAT.

45 Fletore Zyrtare nr.187/2014, Raportit të Katërt Periodik Kombëtar mbi zbatimin e Konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave", miratuar me VKM nr.806, datë 26.11.2014, f.10189.

KAPITULLI 2

VEPRIMTARIA E KMD-SË PËR MBROJTJEN NGA SJELLJET DISKRIMINUESE DHE PROMOVIMIN E BARAZISË

II.1. Ofrimi i ndihmës për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre për diskriminim

Bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", ndihma ndaj viktimave të diskriminimit realizohet përmes:

1. Shqyrtimit të çështjeve nga KMD-ja;
2. Asistencës së viktimave në gjykatë.

II.1.1. Shqyrtimi i çështjeve nga KMD-ja

Bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kompetencë: të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se kanë pësuar diskriminim; të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji; të bëjë rekomandime duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues; dhe të vendosë sanksione administrative sipas përcaktimit të këtij ligji.

Në periudhën 1 janar 2014 - 31 dhjetor 2014, KMD-ja ka trajtuar gjithsej 308 çështje, (290 ankesa dhe 18 çështje *ex-officio*). Nga 180 çështjet (172 ankesa dhe 8 çështje *ex-officio*) e regjistruara në vitin 2014, si dhe 128 çështjet (118 ankesa dhe 10 çështje *ex-officio*) e mbaritura nga viti 2013, KMD-ja ka marrë vendime për 209 çështje të trajtuara gjatë vitit 2014, duke përfshirë të gjitha çështjet e mbaritura nga viti 2013.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet rritja e numrit të ankesave dhe çështjeve të nisura kryesisht nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nga viti 2010 deri në vitin 2014.

Së pesti, dhuna në familje, si një nga format e dhunës me bazë gjinore, vazhdon të mbetet një nga fenomenet më shqetësuese me të cilën përballen gratë. Nga vërtimi kombëtar me bazë popullatën, "Dhuna në familje në Shqipëri", rezulton se 59.4 % e grave (më shumë se 1 në 2 gra) thanë se kishin pësuar dhunë në familje në martesë/marrëdhënie intime "gjatë jetës", dhe 53.0 % e grave (1 në 2 gra) deklaruan se po përjetonin dhunë në familje "aktualisht" (Brenda 12 muajve para intervistës)⁴⁶. Gjatë vitit 2012, janë gjykuar 36 çështje me objekt "dhuna në familje", neni 130/a i Kodit Penal dhe janë dënuar 37 persona. Gjatë vitit 2013, janë gjykuar 280 çështje me objekt "dhuna në familje", neni 130/a i Kodit Penal dhe janë dënuar 278 persona. Gjatë vitit 2012, janë gjykuar 10 çështje me objekt "Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës", neni 321 i Kodit Penal dhe janë dënuar 9 persona. Gjatë vitit 2013, janë gjykuar 31 çështje me objekt "Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës", neni 321 i Kodit Penal dhe janë dënuar 33 persona⁴⁷. Pavarësisht zhvillimeve të Kodit Penal të RSH-së dhe legjislacionit administrativ-civil, efektiviteti i zbatimit të legjislacionit kundër dhunës në familje ka nevojë të forcohet.

I.2.5. Diskriminimi i shumëfishtë

Të pranishme janë edhe rastet e individëve që përjetojnë diskriminim për më shumë se një shkak.

Raporti i katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës CEDAW në Shqipëri ngre disa shqetësime në lidhje me parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi të grave me aftësi të kufizuara, grave të moshuara, grave LGBT, grave rome dhe egjiptiane, etj. Përballja e tyre me diskriminimin mund të ngrejë në të njëjtën kohë çështje të diskriminimit për shkak të moshës dhe gjinisë, ose racës dhe gjinisë, ose racës dhe gjendjes ekonomike, etj.

Mbi bazën e informacioneve të paraqitura pranë KMD-së nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare në lidhje me shkeljen e ligjit nr.10221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", si dhe të ligjit nr.9970, datë 24.07.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri" nga Ndërmarrja CEZ Shpërndarje sh.a., Drejtoria Rajonale, Tiranë, dhe Ndërmarrja Ujësjellës-Kanalizime, Tiranë, janë trajtuar problematika lidhur me praktikën e ndjekura nga ndërmarrjet e sipërcituara, të cilat përbëjnë diskriminim për shkak të gjinisë, shtatzënisë, gjendjes martesore, apo gjendjes civile. Situata të tjera kanë pasur të bëjnë me pretendime për diskriminim për shkak të përkatësisë në minoritetin rom, të vendbanimit dhe gjendjes së tij ekonomike, të marra së bashku⁴⁸.

46 INSTAT, Vërtim kombëtar me bazë popullatën, "Dhuna në familje në Shqipëri", 2013, f.33.

47 Ministria e Drejtësisë, Vjetari Statistikor 2012, 2013, <http://www.drejtesia.gov.al/al/dokumente/statistika>.

48 QNL, Informacion i paraqitur me shkresën me nr.323.Prot, datë 3.7.2014.




Tabela nr.1: Ankesat e regjistruara gjatë viteve 2010-2014

Ankesat individuale të paraqitura para Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, janë shprehje e rritjes së ndërgjegjësimit të komunitetit në lidhje me ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi" dhe mjetet ligjore të ofruara prej tij.

Tabela më poshtë paraqet të dhëna në lidhje me ankesat individuale të paraqitura para institucionit të KMD-së në vitet 2011, 2012, 2013 dhe 2014.

Viti	Numri i ankesave të paraqitura
2011	15
2012	90
2013	166
2014	172

Tabela nr.2: Numri i ankesave të paraqitura pranë KMD-së

II.1.1.1. Procedura e shqyrtimit të ankesave

Procedura e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi fillon me plotësimin e një ankese. Një person ose grup personash që pretendon se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme pranë Komisionerit me

shkrim ose, në raste përjashtimore, me gojë, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal (neni 33 i ligjit). Ankesa duhet të përmbajë informacion për viktimën e diskriminimit, identifikimin e subjektit, i cili pretendohet të ketë kryer diskriminim, shpjegime dhe fakte që disponon lidhur me diskriminimin e pretenduar, si dhe masat që kërkohen të merren nga Komisioneri. Ankesa duhet të nënshkruhet nga personi apo përfaqësuesi i tij. Komisioneri nuk vepron në lidhje me ankesa anonime. Ka disa forma për paraqitjen e ankesës pranë KMD-së:

- Nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë me Zyrën e KMD-së (sektori i Marrëdhënieve me Publikun ka detyrë ta ndihmojë ankuesin për plotësimin e formularit të ankesës);
- Nëpërmjet plotësimit të formularit të ankesës online (formulari është i disponueshëm në gjuhët shqip, anglisht, romisht dhe greqisht në website zyrtar: www.kmd.al);
- Nëpërmjet prezantimit të rastit të pretenduar të diskriminimit në adresën zyrtare elektronike: info@kmd.al;
- Nëpërmjet postës.

Sqarojmë se për fillimin e një ankese në KMD, formulari nuk është i detyrueshëm për t'u plotësuar. Ankesa mund të paraqitet edhe në formë të thjeshtë, të shkruar në një letër, e cila duhet të përmbajë të dhënat kryesore të kontaktit të ankuesit, si dhe shpjegimin e situatës diskriminuese të pretenduar.

Në qoftë se ankesa plotëson kushtet e ligjit për t'u pranuar, ajo i nënshtrohet një shqyrtimi të mëtejshëm bazuar në nenin 33 të ligjit. Procedura e hetimit përfshin grumbullimin e informacionit lidhur me çështjen, zhvillimin edhe të inspektimeve të mundshme apo mbajtjen e seancave dëgjimore mes palëve. Pas analizës së fakteve të grumbulluara bazuar në procedurën e hetimit, Komisioneri del me vendim pas 90 ditëve nga data e ardhjes së ankesës, apo e seancës dëgjimore, nëse është mbajtur një e tillë. Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për zbatimin e tyre. Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa raporton, brenda 30 ditëve, para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit.

Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa, nuk e informon Komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë të personit kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet, nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.

Si mjet të fundit, kur subjekti fizik ose juridik nuk i përmbahet vendimit të Komisionerit, ose nuk e paguan gjobën brenda tre muajve pas afatit të caktuar nga Komisioneri dhe kur sanksioni nuk është kundërshtuar në gjykatë, Komisioneri mund t'u kërkojë autoriteteve kompetente heqjen apo pezullimin e lejes ose autorizimit të subjektit fizik ose juridik për ta ushtruar veprimtarinë e tij. Subjekti fizik ose juridik, ndaj të cilit merret masa ndëshkimore me gjobë, ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente.

II.1.1.2. Ankuesit

Bazuar në nenin 32, pika 1/a/b, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", ankuesit mund të jenë: individë, grupe individësh dhe organizata me interesa legjitime në emër të një personi apo grupi personash.

Gjatë vitit 2014, ka filluar shqyrtimi i 172 ankesave, nga të cilat 166 janë paraqitur nga individë të ndryshëm dhe 6 janë paraqitur nga organizata me interesa legjitime.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet ndarja e ankuesve në individë dhe organizata (në përqindje dhe numër). Natyrisht çështjet ex-officio nuk janë të përfshira, sepse ato nuk kanë ankues por iniciohen nga KMD-ja pas marrjes së informacionit të besueshëm.




Tabela nr. 3: Ankuesit

Gjatë vitit 2014, pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përveç ankesave individuale, janë paraqitur edhe 6 ankesa nga organizata me interesa legjitime. Këto ankesa përgjithësisht janë paraqitur nga organizata që mbrojnë të drejtat e komunitetit rom, egjiptian, LGBT, grave, personave me aftësi të kufizuara, etj. Falë bashkëpunimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe këtyre organizatave, për disa prej ankesave të ngritura prej tyre, nga Komisioneri janë dhënë rekomandime për rivendosjen e të drejtës së shkelur, ndërkohë që disa prej tyre janë zgjidhur me ndërmjetësim. Vlen të theksohet fakti se, këto bashkëpunime kanë qenë mjaft të efektshme për evidentimin e rasteve të pretenduara për diskriminim, ndërgjegjësimin e përmirësimin e situatave. Në disa raste informacioni i sjellë nga organizatat e shoqërisë civile ka shërbyer si shtysë apo informacion për Komisionerin për iniciimin kryesisht të çështjeve.

II.1.1.3. Shpërndarja rajonale e ankesave

Edhe gjatë vitit 2014 ka pasur një shtrirje të gjerë gjeografike të ankesave me pretendim diskriminim, të paraqitura pranë KMD-së. Qytetet nga të cilat është paraqitur numri më i madh i ankesave me pretendim diskriminim pranë KMD-së janë Tirana, Lezha, Shkodra, Kukësi, Vlora, Fieri, Elbasani, Korça, Dibra dhe zonat përreth tyre.

Shumica e ankesave janë paraqitur nga persona që banojnë kryesisht në qytetet ku KMD-ja ka zhvilluar takime informuese, në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare (OSCE/ODHIR, UNDP), apo OJF (Komiteti Shqiptar i Helsinkit, ADRF, Të Ndryshëm dhe Të Barabartë), gjatë të cilave komuniteti është njohur me ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi", kompetencat e KMD-së dhe rrugët që duhet të ndiqen për të bërë një ankesë pranë KMD-së.

II.1.1.4. Shkaqet e pretenduara në çështjet e shqyrtuara

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose çdo shkak tjetër. (neni 1)

Në vitin 2014, në zyrën e KMD-së janë paraqitur ankesa për shkaqe të parashikuara në ligj, por ka pasur edhe ankesa në të cilat subjektet nuk kanë qenë në gjendje të identifikonin shkaqet. Duhet theksuar se ligji ka parashikuar një listë të hapur të shkaqeve kur parashikon edhe çështje për "çdo shkak tjetër", duke pasur parasysh me këtë shkaqet që mund të lidhen me cilësi individuale të personave. Në disa prej ankesave të ardhura pranë zyrës së Komisionerit, subjektet kanë pretenduar më shumë se një shkak diskriminimi.

Nga tabela e mëposhtme mund të konstatohet se shkak për të cilën pretendohet se konsumohen më shumë sjellje diskriminuese është raca. Kështu, raca ka numrin më të madh të ankesave, të cilit i referohet kryesisht komuniteti rom/egjiptian, bashkë me ngjyrën, që është një shkak tjetër diskriminimi, të cilat konsiderohen diskriminim racial sipas kuptimit që i jep ECRI⁴⁹. Ka pasur një rritje të dukshme të ankesave për bindje politike. Gjithashtu, ka një rritje të konsiderueshme të pretendimeve për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore dhe aftësisë së kufizuar. Në të njëjtin nivel janë edhe çështjet ku pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike. Vërehet një numër i madh pretendimesh për diskriminim në kategorinë "për çdo shkak tjetër". Këto janë raste kur nuk arrihet të evidentohet njëri prej shkaqeve të mësipërme, pavarësisht se ndryshimi në trajtim është i dukshëm ose kur ka të bëjë me një cilësi personale të parashikuar shprehimisht nga ligji.

⁴⁹ Sipas Komisionit Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës përkufizimi i "diskriminimit racial" është: "Trajtim i ndryshëm me bazë etninë, origjinën, ngjyrën, shtetësinë, besimin fetar dhe gjuhën". http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/ecri/activities/gpr/en/recommendation_n7/Recommendation_7_en.asp#P_80_4931

Ankesa	Shkaku i ankesës
Gjinia	8
Raca	164
Ngjyra	3
Etnia	8
Gjuha	1
Identiteti gjinor	1
Orientimi seksual	3
Bindja politike	43
Bindja fetare	5
Gjendja ekonomike	20
Gjendja arsimore	9
Gjendja shoqërore	9
Shtatzënia	1
Mosha	5
Gjendja familjare	6
Gjendja martesore	2
Gjendja civile	1
Vendbanimi	5
Gjendja shëndetësore	17
Predispozicionet gjenetike	1
Aftësia e kufizuar	19
Përkatësia në grup të veçantë	4
Çdo shkak tjetër	31

Tabela 4: Shpërndarja e ankesave të paraqitura gjatë vitit 2014 e ndarë sipas shkaqeve

Ndërsa paraqitja në përqindje e shpërndarjes së ankesave sipas shkaqeve jepet në grafikun e mëposhtëm:



Tabela nr.5: Shkaqet e pretenduara të ankesave

II.1.1.5. Ndarja e çështjeve sipas shkaqeve

1. Çështje diskriminimi për shkak të racës

Për vitin 2014 janë trajtuar 160 ankesa dhe 4 çështje të nisura kryesisht me iniciativë të Komisionerit me pretendim diskriminimi për shkak të racës. Duhet të theksohet fakti se ankesat individuale janë marrë kryesisht gjatë zhvillimit të aktiviteteve të ditëve të hapura që Komisioneri ka organizuar me grupe të komunitetit rom dhe egjiptian në rrethe të ndryshme të vendit. Organizimi i ditëve të hapura, ka qenë një komponent i projekteve ndërgjegjësuese të KMD-së, ku komuniteti rom dhe egjiptian ka qenë në fokus dhe është informuar lidhur me institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kompetencat dhe mënyrën se si mund të ankohen pranë institucionit të Komisionerit. Mbështetur në informacionin e grumbulluar në këto takime, KMD-ja ka dërguar rekomandime në institucionet përkatëse për problematikat e ngritura nga ky komunitet.

Problematikat e parashtruara në këto ankesa kanë të bëjnë me pretendime për:

- mospërfitim në mënyrë të padrejtë të trajtimit me ndihmë ekonomike, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të këtij ligji;

- caktimin jo korrekt të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike apo ndërprerjen e ndihmës ekonomike;
- probleme të trajtimit jo të barabartë në fushën e punësimit si në sektorin shtetëror, ashtu dhe në atë privat;
- ankesa në drejtim të forcave të ruajtjes së rendit për përdorim të gjuhës fyese dhe të nënvlerësimit të ankesave të bëra nga ky komunitet;
- ankesa ndaj autoriteteve vendore në drejtim të respektimit të së drejtës së tyre për strehim dhe për mos prishjen e banesave të tyre që janë në proces legalizimi.

Bazuar në ankesat, vërejmë se pjesëtarë të këtij komuniteti ankohen për diskriminim në fushën e punësimit, strehimit, arsimit dhe në atë të shërbimeve.

Gjatë vitit 2014 ka përfunduar shqyrtimi i 108 çështjeve (nga të cilat 104 ankesa individuale dhe 4 *ex-officio*). Në përfundim të shqyrtimit të këtyre ankesave, janë dhënë vendimet sipas tabelës së mëposhtme:

- në 6 raste është konstatuar diskriminim (nga të cilat 3 vendime me konstatim diskriminimi dhe 3 çështje të zgjidhura me ndërmjetësim gjatë zhvillimit të procedurave hetimore);
- në 83 raste është konstatuar mosdiskriminim;
- në 4 raste subjekti ankues ka tërhequr ankesën;
- në 12 raste çështjet nuk janë pranuar për mospërmbushje të kërkesave ligjore;
- në 1 rast është dhënë vendim me gjobë;
- në 2 raste është pushuar shqyrtimi i ankesës për shkak të pamundësisë.⁵⁰

Për ankesat me shkak racën, të cilat nuk janë pranuar për shqyrtim⁵¹ pasi nuk plotësonin kriteret që parashikon ligji 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri, në rreth 30 ankesa, ka sugjeruar dhe rekomanduar rrugën që duhet të ndjekin subjektet për zgjidhjen e problematikes së paraqitur pranë KMD-së. Në disa raste, KMD-ja ka ofruar ndihmë për komunitetin rom dhe egjiptian në plotësimin e dokumentacionit për përfitimin e ndihmës ekonomike, për regjistrimin e fëmijëve të tyre në shkolla, regjistrimin në gjendjen civile, përfitimin nga banesat sociale dhe nga tarifatat studentore, etj.

50 Gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës subjekti ankues ka ndërruar jetë.

51 Gjatë shqyrtimit paraprak, këto ankesa kanë rezultuar se nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara në ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi” për arsye se nuk përmbajnë informacion të mjaftueshëm, kanë tejkaluar afatet dhe institucioni nuk ka kompetencë për të shqyrtuar ankesën.

ÇËSHTJA 1:

Trajtimi *ex-officio* i çështjes së punonjësve të Policisë së Shtetit, të cilët kanë përdorur fjalë fyese ndaj komunitetit rom në Tiranë.

Më datë 09.09.2014, pasi informacionit të marrë nga media, Institucioni i Komisionerit ka nisur procedurat e hetimit administrativ mbi dy raste të trajtuara në emisionin televiziv “Fiks Fare”, ku: “Punonjësit e Policisë së Shtetit nuk kanë reaguar për marrjen e masave dhe parandalimin e shfrytëzimit të fëmijëve romë edhe pasi këto raste janë denoncuar nëpërmjet telefonit (në numrin 129), nga ana e gazetares së emisionit televiziv. Një njërin prej rasteve, punonjësit e Policisë së Shtetit, kanë përdorur veprime dhe fjalë fyese ndaj komunitetit rom”.

Nisur nga situata e konstatuar, mbështetur në kompetencat që ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i jep institucionit të Komisionerit, por edhe në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit që ekziston midis dy institucioneve, Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë iu rekomandua të merrte masa:

- Për të hetuar dhe ndëshkuar rastin e abuzimit verbal të bërë nga punonjësit e Policisë së Shtetit ndaj individëve të paraqitur në emisionin televiziv “Fiks Fare”, të datës 09.09.2014.
- Për të trajtuar me efikasitet thirrjet apo denoncimet e bëra nga çdo individ, pavarësisht nga përkatësia e tij etnike.
- Për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të trajnuar punonjësit e policisë për trajtimin me respekt dhe dinjitet të çdo individi, pavarësisht nga përkatësia etnike.

Në përgjigje të rekomandimit të KMD-së, Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, nëpërmjet shkresës nr. 7778/1 Prot., datë 10.10.2014, informoi Komisionerin mbi masat e marra në zbatim të rekomandimit.

ÇËSHTJA 2:

Shtetasi E.B, në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, pretendon diskriminim për shkak të racës nga ana e Drejtores së Filialit të Postës Elbasan, pasi ai është transferuar nga pozicioni “shpërndarës” pranë Filialit të Postës Elbasan, në pozicionin “agjent” pranë Zyrës Postare Stravaj Librazhd. Ankuesi nuk ka qenë dakord me këtë transferim dhe ishte i bindur se ky është një veprim diskriminues i ndërmarrë ndaj tij për shkak se ai i përket komunitetit rom. Në vijim të ankesës së parë, E.B. ka depozituar pranë KMD-së një ankesë të dytë, ku ai e bën me dije Komisionerin se është liruar nga detyra dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare me Filialin e Postës Elbasan.

Në bazë të rezultateve të hetimeve, Komisioneri vendosi konstatimin e diskriminimit për shkak të racës të z. E. B., nga Filiali i Postës Elbasan, përmes largimit të pajustificuar dhe për shkaqe abuzive nga puna. Filialit të Postës Elbasan iu rekomandua marrja e masave të menjëhershme për sistemimin në punë të ankuesit.

Ky institucion e zbatoi menjëherë rekomandimin e Komisionerit, por ankuesi kishte refuzuar pozicionin e punës së ofruar.

2. Çështje diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar

Gjatë vitit 2014, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka trajtuar 11 çështje (8 ankesa dhe 3 çështje të nisura kryesisht), për shkak të aftësisë së kufizuar. Nga këto:

- në 5 çështje është konstatuar diskriminim (nga të cilat 3 vendime me konstatim diskriminimi dhe në 2 çështje është shmangur situata diskriminuese gjatë zhvillimit të procedurave hetimore dhe arritur qëllimi për të cilin është iniciuar çështja);
- në 4 çështje është konstatuar mosdiskriminim;
- në 2 raste çështjet nuk janë pranuar për shkak të mospërmbushjes së kriterëve ligjore.

Ankesat me pretendim diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar kryesisht kishin të bënin me mohimin e përshtatjes së arsyeshme, diskriminim në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve dhe moszbatimin e legjislacionit në lidhje me përfitimin e rimbursimit të tarifës së shkollimit në arsimin e lartë, dhe integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet e zakonshme arsimore.

ÇËSHTJA 1

Shoqata e Invalidëve të Punës të Shqipërisë, ka paraqitur pranë KMD-së ankesën kundër Shoqatës Kombëtare të Transportit Qytetas, me pretendimin e diskriminimit për shkak të "aftësisë së kufizuar". Me datë 01.07.2014, një numri të madh invalidësh u ishte mohuar e drejta për të udhëtuar falas në urbanët e linjave qytetase të Tiranës duke ushtruar ndaj tyre dhunë psikologjike dhe fizike nga ana e faturinove. Nga administrimi i fakteve dhe provave, Komisioneri konstatoi se pretendimi i Shoqatës së Invalidëve të Punës të Shqipërisë, ishte i vërtetë. Pavarësisht kësaj situatë, çështja për të cilën filloi ankesa e ardhur pranë KMD-së, u zgjidh në favor të kësaj kategorie personash, pasi gjatë periudhës së shqyrtimit, kjo kategori ka udhëtuar falas.

Në përfundim të procedurës hetimore, Komisioneri vendosi konstatimin e diskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, ndaj kategorisë së personave më dëshmi invaliditeti-pune, nga ana e operatorëve privatë të shërbimit të transportit qytetas të Tiranës, si dhe pushimin e çështjes për shkak se situata është zgjidhur në favor të kësaj kategorie. Shoqatës Kombëtare të Transportit Urban iu rekomandua të kishte në vëmendje zbatimin me korrektësi të gjithë kuadrit ligjor të cituar në vendim, që në të ardhmen të mos ketë sërish përsëritje të situatave të ngjashme në dëm të kësaj kategorie personash.

ÇËSHTJA 2

Mbështetur në publikimet e bëra në median e shkruar⁵², që kishin të bënin me denoncimin e bërë nga z. T. J., lidhur me dhunën e ushtruar mbi vajzën e tij me aftësi të kufizuara, 17 vjeçare, Xh. J., ndërkohë që është përcjellë nga Qendra e Zhvillimit Rezidencial Durrës, në drejtim të Shkollës Speciale të Fëmijëve, Durrës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi kryesisht hetimin e kësaj çështjeje.

Gjatë hetimit të çështjes së XH.J., Komisioneri konstatoi se QZHR-ja e Durrësit funksiononte në bazë të Rregullores së organizimit dhe funksionimit të qendrave të zhvillimit, e cila

52 Gazeta Shqip e datës 13 tetor 2013, si dhe nga gazeta të tjera.

ishte hartuar për t'u zbatuar nga shume institucione dhe nuk kishte të specifikuar dhe të parashikuara me hollësi disa praktika rutinë të QZHR-së së Durrësit, të cilat luanin një rol shumë të rëndësishëm në jetën, shëndetin dhe mbarëvajtjen e fëmijëve që strehohen në Qendër. E tillë u konsiderua edhe praktika e shpërndarjes apo përcjelljes së fëmijëve në shkollë, e cila duhet të ishte saktësisht e parashikuar në një akt të brendshëm të kësaj qendre. Njëkohësisht, Komisioneri konstatoi se mosparashikimi i një pozicioni "mjek" në strukturën e Qendrës së Zhvillimit Rezidencial të Durrësit shkaktonte vonesa në ofrimin e shërbimit mjekësor ndaj fëmijëve të strehuar në të. Mangësi tjetër e konstatuar ishte edhe mungesa e korrespondencës dhe bashkëpunimit zyrtar ndërmjet Qendrës së Zhvillimit Rezidencial dhe Shkollës Speciale të Fëmijëve, Durrës.

Mbështetur në rezultatet e hetimit, KMD-ja vendosi konstatimin e diskriminimit të tërthortë, për shkak të aftësive të kufizuara, nga Qendra e Zhvillimit Rezidencial, Durrës, të fëmijëve të strehuar pranë saj. KMD-ja dha rekomandimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes aktuale të këtyre fëmijëve.

Shërbimi Social Shtetëror dhe Qendra e Zhvillimit Rezidencial, Durrës, kanë zbatuar rekomandimet e KMD-së.

3. Çështje diskriminimi për shkak të gjendjes ekonomike

Numri i çështjeve të trajtuara nga KMD-ja gjatë vitit 2014, me pretendim diskriminim për shkak të gjendje ekonomike, është 15 (pesëmbëdhjetë). Për 9 (nëntë) prej tyre është dalë me vendim:

- Për 4 (katër) prej ankesave është konstatuar diskriminim,
- Për 3 (tri) prej ankesave është konstatuar mosdiskriminim,
- 2 (dy) ankesa nuk janë pranuar pasi nuk plotësojnë kërkesat e ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi".
- Janë dhënë 4 (katër) rekomandime nga Komisioneri⁵³.

ÇËSHTJA 1

Shtetasi T. K, ka paraqitur ankesën kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me pretendimin e diskriminimit për shkak të "gjendjes ekonomike".

Ankuesi shprehet se ai dhe bashkëshortja e tij janë të papunë dhe trajtohen me ndihmë ekonomike. Ata nuk kanë mundësi financiare për të blerë tekstet shkollore për dy fëmijët e tyre, të cilët ndjekin arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar, në një shkollë publike të qytetit të Elbasanit.

Komisioneri ka konstatuar se, bazuar në VKM nr.212, datë 16.03.2011 "Për disa shtesa dhe një ndryshim në vendimin nr. 107, datë 10.02.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit para-universitar", pika 6.7, fëmijëve të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie nga Zyrat e Punësimit, do t'u rimbursohet çmimi i blerjes së teksteve shkollore në masën 100%.

53 Ministria e Arsimit dhe Sportit ka informuar Komisionerin se në periudhën në vazhdim nga ana e saj do të merren në konsideratë Rekomandimet e KMD-së gjatë ndryshimeve dhe përmirësimeve që do të bëhen në aktet ligjore.

Kjo kategori përfituesish të teksteve shkollore falas diskriminohet në mënyrë të tërthortë nga Udhëzimi i përbashkët nr. 51, datë 20.09.2013, i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për "Procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parashkollor", lidhur me procedurën se si do të rimbursohen. Duke qenë një kategori pa të ardhura të mjaftueshme ata, nuk kanë mundësi reale që të bëjnë blerjen fillestare të teksteve shkollore, e më pas të presin rimbursimin.

Në përfundim të procedurës hetimore, Komisioneri ka vendosur **konstatimin e diskriminimit të tërthortë**, për kategorinë që përfiton ndihmë ekonomike, (e cila rimbursohet në masën 100%), sipas klasave përkatëse, nga Udhëzimi i përbashkët nr. 51, datë 20.09.2013, i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për "Procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parashkollor", lidhur me procedurën e rimbursimit. KMD-ja ka rekomanduar që për vitin e ardhshëm shkollor 2015-2016, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave të parashikojnë që, kategoria e nxënësve që vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie nga Zyrat e Punësimit, të pajiset me tekste shkollore falas, sipas klasave përkatëse, pa pasur nevojë që fillimisht t'i blejë tekstet e më pas të presë rimbursimin 100% nga shteti.

Me shkresën 9836/1, datë 16.01.2015, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka informuar Komisionerin se në periudhën në vazhdim nga ana e saj do të merrin në konsideratë Rekomandimet e KMD-s gjatë ndryshimeve dhe përmirësimeve që do të bëhen në aktet ligjore.

4. Çështje diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor

Gjatë vitit 2014, pranë KMD-së janë paraqitur 3 ankesa, ku pretendohet diskriminim për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Këto ankesa janë shqyrtuar nga struktura përgjegjëse pranë Komisionerit, duke dalë me:

- 1 vendim ku është konstatuar diskriminim;
- 1 vendim ku është konstatuar mos-diskriminim;
- 1 vendim ku Komisioneri ka vënë gjobë për shkak të mosdhënies së informacionit nga subjekti kundrejt të cilit drejtohej ankesa.

ÇËSHTJA 1

KMD-ja ka shqyrtuar ankesën e paraqitur nga organizata "Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT" kundër subjektit privat, Piceri "Kledi", me pretendim diskriminimi për shkak të orientimit seksual në fushën e të mirave dhe shërbimeve.

Organizata "Aleanca kundër diskriminimit të LGBT-ve", përfaqësuar nga dy aktivistë të saj, paraqiti ankesën përpara Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në të cilën shpjegon se: "Me datë 18.10.2013, rreth orës 21.40, në mjediset e Restorant Piceri 'Kledi', i cili frekuentohet nga dy aktiviste femra të organizatës sonë, kamerieri, kur u kishte shërbyer porosinë, i kishte parë duke u puthur me njëra tjetrën dhe u kish kërkua që të dilnin nga lokali, duke i ofenduar, dhe duke i kërcënuar me hapësen e shisheve të verës dhe telekomandën e televizorit".

Në zbatim të parashikimeve ligjore, KMD-ja mori të gjitha masat që subjekti kundër të cilit ishte bërë ankesa të vihej në dijeni për ankesën e bërë, nëpërmjet inspektimit të mjediseve të lokalit si dhe nëpërmjet shërbimit postar, duke i ofruar mundësitë që të jepte shpjegime dhe informacion mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, KMD-ja konstatoi se subjekti ankues, me dijeninë e plotë të tij, ka refuzuar që të japë shpjegime mbi pretendimet e ngritura, duke refuzuar tre herë shkresat e dërguara me postë, si dhe duke refuzuar realizimin e inspektimit.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se K.N., në cilësinë e pronarit të lokalit Restorant-Piceri "Kledi", ka shkelur nenin 32/2 të ligjit nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka vendosur që K.N. të gjobitet me gjobë në vlerën 10.000 (dhjetë mijë) lekë.

ÇËSHTJA 2

Pranë Komisionerit është paraqitur ankesa e Shoqatës "Aleanca kundër Diskriminimit LGBT" dhe Shoqata "Të bashkuar pro kauzës LGBT", ku pretendohet për diskriminim të komunitetit LGBT, për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, nëpërmjet postimeve të bëra në faqen zyrtare të Aleancës Kuq e Zi, në rrjetin social Facebook. Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë dhe fakteve të paraqitura pranë Komisionerit, pretendohet se, nëpërmjet përmbajtjes së postimeve të bëra në datat 29-30 prill 2014, në faqen e FB të Aleancës Kuq e Zi, synohet kërcënim dhe përhapja e gjuhës së urrejtjes ndaj komunitetit LGBT. Një gjë e tillë vihet re qartë edhe në komentet përkatëse, në vijim të posterave të publikuara.

Pas përfundimit të procedurave hetimore, KMD-a vendosi konstatimin e diskriminimit të Komunitetit LGBT, për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, nga Aleanca Kuq e Zi, nëpërmjet postimeve dhe publikimeve të bëra në rrjetin social Facebook gjatë muajit Prill 2014. Njëkohësisht, u rekomandua që përfaqësues të Aleancës Kuq e Zi të kërkojnë publikisht ndjesë brenda 15 ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, si dhe në të ardhmen të evitohet përdorimi i gjuhës që shkakton përhapjen, nxitjen e urrejtjes apo të formave të tjera të diskriminimit, për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të tyre. Komisioneri vendosi sanksion me gjobë ndaj Subjektit Aleanca Kuq e Zi, për mosdhënie të informacionit të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në zbatim të nenit 32/2 të ligjit Nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Subjekti politik Aleanca Kuq e Zi e ka ankimuar vendimin e Komisionerit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe çështja është në proces gjykim.

5. Çështje diskriminimi për shkak të gjinisë

Gjatë vitit 2014, KMD-ja shqyrtoi 5 (pesë) ankesa me pretendim diskriminimi për shkak të gjinisë, nga të cilat, në përfundim të procedurës hetimore:

- për 1 (një) rast është marrë vendim për diskriminim;
- 2 (dy) ankesa nuk janë pranuar pasi nuk plotësojnë kërkesat e ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi";
- 2 (dy) ankesa janë mbyllur me konstatimin e mosdiskriminimit.

Referuar individëve që janë ankuar pranë KMD-së, numri i ankesave me pretendim diskriminim për shkak të gjinisë është relativisht i vogël, krahasuar me shkaqet e tjera të diskriminimit të pretenduar, megjithëse raporti i ankuesve është pothuajse i njëjtë.




Tabela Nr. 6: Ndarja gjinore e ankuesve

Objekti i ankesave me pretendim diskriminim për shkak të gjinisë, përgjithësisht ka qenë mosrespektimi i të drejtave në fushën e të mirave dhe shërbimeve nga ana e institucioneve publike.

ÇËSHTJA 1

Shtetasja E. H., në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, pretendon diskriminim për shkak të gjinisë, shtatzënisë dhe gjendjes shëndetësore, nga ana e Shoqërisë "Protec Shoes" sh.p.k. E. H. ka punuar në pozicionin e financieres pranë Shoqërisë "Protec Shoes" sh.p.k., që prej datës 18.04.2012. Ndërmjet E.H., në pozicionin e punëmarrëses dhe Shoqërisë "Protec Shoes" sh.p.k. në pozicionin e punëdhënësit ka qenë lidhur një kontratë pune me afat të caktuar, deri në datën 02.07.2013. Ankuesja pretendon se përfaqësuesi shqiptar i firmës së sipërpërmendur fillimisht i ka komunikuar se kontrata e saj e punës përfundonte në datën 02.07.2013 dhe se ajo nuk do të ripërtërihej më. Pra, E.H nuk do të ishte më në punë vetëm 2 ditë pas lindjes së fëmijës dhe kur ishte ende në maternitet, fakt që e ka rënduar së tepërmi gjendjen shëndetësore të lehonës. Më pas, në muajin maj 2013, ankueses i është komunikuar zyrtarisht fakti se kontrata e saj nuk do të rinovohej më, pas përfundimit të afatit të caktuar në të, d.m.th., pas datës 02.07.2013. Ndërkohë, E.H. ishte me raport barrë-lindjeje, pas një lindjeje tepër të vështirë dhe të shoqëruar me një gjendje shëndetësore jo të mirë të lehonës dhe fëmijës së sapolindur.

Në bazë të rezultateve të hetimeve, Komisioneri vendosi **konstatimin e diskriminimit**, përmes shkeljes së nenit 147 të Kodit të Punës⁵⁴, për shkak të gjinisë të E. H., nga ana e Shoqërisë "Protec Shoes" sh.p.k., si dhe bëri rekomandimet përkatëse, të cilat u zbatuan nga subjekti në fjalë.

6. Çështje diskriminimi për shkak të moshës

Gjatë vitit 2014, pranë KMD-së janë paraqitur 4 ankesa, ku pretendohet diskriminim për shkak të moshës. Komisioneri është shprehur me:

- 1 vendim ku është konstatuar diskriminim,
- 1 vendim ku është konstatuar mosdiskriminim
- 2 vendime mospranimi për mosplotësim të kriterëve të përcaktuara nga ligji nr.10/2010, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Rastet e trajtuara nga KMD-ja për këtë shkak janë kryesisht në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Për t'u njohur me një çështje të tillë, referojuni pikës: "Ankesa në fushën e të mirave dhe shërbimeve".

7. Çështje diskriminimi për shkak të bindjeve politike

Gjatë vitit 2014, janë paraqitur 34 ankesa ku pretendohet diskriminim për shkak të bindjeve politike. Komisioneri ka vendosur:

- 5 vendime ku është konstatuar diskriminimi;
- 6 vendime ku është konstatuar mosdiskriminim;
- 4 vendime për pushimin e çështjes, pasi ankuesit e kanë tërhequr ankesën e tyre dhe
- 4 vendime ku ankesat nuk janë pranuar për mosplotësim të kriterëve të përcaktuara nga ligji nr.10/2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

ÇËSHTJA 1

Pranë Komisionerit është paraqitur ankesa e shtetasit M. Z, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të bindjeve të tij politike nga ana e DAR, Fier. Ankuesi kishte punuar që më 06.11.2002 si mësues matematike në shkollën 9-vjecare të Ruzhdies. Pas zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të 28 qershorit 2009, ai ishte transferuar nga kjo shkollë. Ankuesi pretendonte se kjo lëvizje ka ardhur për shkak të një përplasjeje gjatë fushatës elektorale me kundërshtarët politikë, duke qenë se ai ishte edhe kryetar i PS-së për Komunën Ruzhdie. Nga verifikimet e bëra, Komisioneri konstatoi se brenda 3 (tre) viteve shkollore,

⁵⁴ Neni 147 Kodi i Punës parashikon se "1. Punëdhënësi nuk mund të zgjidhë kontratën në kohën kur, sipas legjislacionit në fuqi, punëmarrësi kryen shërbimin ushtarak, përfiton pagesë paaftësie të përkohshme në punë nga punëdhënësi ose sigurimet shoqërore, për një periudhë deri në një vit, si dhe kur punëmarrësi është me pushime të dhëna nga punëdhënësi. 2. Kur zgjidhja e kontratës behet para se punëmarrësi të thirret në shërbimin ushtarak, te jete me paftësi të përkohshme në punë ose te jete me pushime të dhëna nga punëdhënësi dhe afati i njoftimit nuk ka përfunduar, ky afat pezullohet për periudhën e kryerjes së shërbimit ushtarak, te paftësisë se përkohshme në punë ose te pushimeve të dhëna nga punëdhënësi dhe rifillon pas përfundimit të kësaj periudhe".

z. M. Z. ishte transferuar 5 (pesë) herë, pa shkaqe të përligjura, në shkolla të ndryshme të rrethit Fier, larg vendbanimit të tij.

Në përfundim të procedurës hetimore, Komisioneri ka gjykuar se shkak për të gjitha këto transferime të pamotivuara dhe në dëm të ankuesit janë bërë bindjet politike të M. Z, pasi çdo pasojë e ardhur i referohet ngjarjeve pas datës 28 qershor 2009, kohë që përkon me zgjedhjet e përgjithshme parlamentare. Nga ana tjetër, çdo transferim është bërë në kundërshtim me legjislacionin arsimor në fuqi. *Komisioneri ka vendosur konstatimin e diskriminimit të z. M. Z, nga ana e Drejtorisë Arsimore Rajonale, Fier, për shkak të bindjeve të tij politike dhe i ka rekomanduar DAR, Fier, si subjekti që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të marrë masa për rregullimin e pasojave të shkaktuara në dëm të z. M. Z, duke e emëruar si mësues në komunën Ruzhdie.*

Rekomandimi i Komisionerit është zbatuar nga DAR, Fier, duke e rikthyer z. M. Z. në punë

ÇËSHTJA 2

Shtetasja V.M. ka paraqitur ankesë kundër Drejtorisë së Shëndetit Publik, Mat, në të cilën pretendon diskriminim për shkak të bindjeve politike. Në mbështetje të pretendimeve të saj, V.M ka vënë në dispozicion të KMD-së, shkresën nr. 167, datë 20.05.2014, të Drejtorisë së Shëndetit Publik, Mat, nëpërmjet së cilës Drejtoria ka urdhëruar: “- *Largimin e menjëhershëm të V. M. për shkaqe politike nga Drejtoria e Shëndetit Publik, Mat. - Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë*”. Ankuesja shpjegon se Drejtori i institucionit ka urdhëruar largimin e saj të menjëhershëm nga puna, pa asnjë referencë ligjore, por për motive të pastra politike.

Drejtorja e Shëndetit Publik, Mat, me gjithë afatin kohor që kishte në dispozicion nuk ka sjellë asnjë fakt që të hedhë poshtë pretendimet e ankueses dhe të vërtetojë se ky trajtim i V.M-së ka ardhur për shkaqe të arsyeshme dhe jo për shkak të bindjeve të saj politike.

Komisioneri ka vlerësuar se urdhri për largimin nga puna të V.M-së për shkak të bindjeve politike ishte një rast flagrant i shkeljes së dinjitetit, të drejtave dhe lirive themelore të individit të sanksionuara dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe se mosndëshkimi i një sjelljeje kaq të hapur diskriminuese do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Në përfundim Komisioneri ka vendosur **konstatimin e diskriminimit të V.M**, nga ana e Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat, për shkak të bindjes politike dhe ka rekomanduar kthimin e V.M në vendin e punës.

Me vendimin nr. 460, datë 04.11.2014, Drejtoria e Shëndetit Publik, Mat, ka informuar Komisionerin për zbatimin e rekomandimit të tij, duke rikthyer në detyrë shtetasen V.M.

8. Çështje diskriminimi për shkak të gjendjes arsimore

Gjatë vitit 2014, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë paraqitur 9 ankesa, ku pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes arsimore. Komisioneri ka vendosur:

- 1 (një) vendim për konstatim mosdiskriminimi;
- 6 (gjashtë) ankesa janë në proces shqyrtimi;
- 1 (një) vendim për pushimin e çështjes sepse ankuesi është tërhequr dhe
- për 1 (një) ankesë është dhënë vendim, mbështetur në një shkak tjetër të pretenduar nga ankuesi.

ÇËSHTJA 1

Shtetasi S.Rr. ka paraqitur ankesë kundër Drejtorisë së IEVP-së, Kavajë, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore”.

Ankuesi ka profesionin e “elektromekanikut” dhe ka punuar pranë IEVP, Kavajë, që nga 10.11.2009, deri më datë 24.01.2014, periudhë kur i janë shkëputur marrëdhëniet e punës, me shkresën e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, datë 23.01.2014. Ai e quan të padrejtë dhe diskriminues lirinë e tij nga puna.

Në vijim të procedurës së ndjekur nga Komisioneri, gjatë inspektimit të kryer pranë IEVP-së Kavajë, u konstatua se: Lirimi i tij nga detyra si dhe ndërprerja e marrëdhënieve administrative dhe financiare me IEVP-në Kavajë⁵⁵ është bërë në zbatim të Urdhrit të DPB-së,⁵⁶ si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Vendimi është mbështetur në rekomandimet e lëna nga Audit i Brendshëm i Burgjeve i DPB-së Tiranë ku, ndër të tjera, gjatë inspektimit të kryer në këtë Institucion, datë 17.12.2013, është konstatuar se në dosjen personale të punonjësit S. Rr, nuk ka dokumentacion të rregullt shkollor, si dhe nuk ka dëshmi kualifikimi për vendin e punës.⁵⁷

Ankuesi nuk ka sjellë pranë KMD-së asnjë dokument që të vërtetojë se niveli arsimor dhe kualifikimet e tij janë në përputhje me kërkesat për pozicionin e punës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri ka vendosur konstatimin e mosdiskriminimit të S.Rr., nga ana e Drejtorisë së IEVP-së, Kavajë, për shkak të gjendjes së tij arsimore, pasi ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon se nuk mund të quhet diskriminuese kërkesa për të plotësuar kriteret e përcaktuara në përputhje me pozicionin e punës.

9. Çështje diskriminimi për shkak të gjendjes shëndetësore

Gjatë vitit 2014, pranë KMD-së, janë paraqitur 17 (shtatëmbëdhjetë) ankesa në të cilat pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore. Nga këto ankesa kanë përfunduar procedurat e shqyrtimit për 11 (njëmbëdhjetë) prej tyre, nga të cilat:

- për 4 (katër) çështje është konstatuar diskriminim dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse,
- 3 (tre) çështje nuk janë pranuar pasi nuk i plotësonin kriteret e parashikuara në ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,
- për 3 (tre) çështje është dhënë vendim mosdiskriminimi.
- Në 1 (një) çështje është tërhequr subjekti ankues.

⁵⁵ Urdhër i Brendshëm i IEVP-së Kavajë, me nr. 305 Prot., datë 27.01.2014.

⁵⁶ Urdhër me nr. 358/1, datë 23.01.2014, i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

⁵⁷ I referohemi shkresës me nr. 9240 Prot., datë 30.12.2013 të DPB-së me objekt: “Dërgohet Raport i Auditit, Drejtorisë së IEVP-së Kavajë, mbi inspektimin e kryer me datë 17.12.2013”

ÇËSHËTJA 1

Shtetasja. L. R, në ankesën e bërë pranë KMD-së, pretendon se është diskriminuar “për shkak të gjendjes shëndetësore” nga ana e DAR Fier. Ankuesja punonte mësuese në shkollën e mesme “Jakov Xoxa” Fier. Gjatë pushimeve verore ishte diagnostikuar me kancer në tiroide, gjë për të cilën do t’i nënshtrohej ndërhyrjes kirurgjikale. Përpara nisjes për kurim jashtë shteti, ankuesja ka respektuar procedurën për njoftimin paraprak dhe vënien në dijeni të drejtorit të institucionit arsimor ku punonte, si dhe të DAR Fier, për arsyet e shkëputjes së saj të përkohshme, nga procesi i mësimdhënies, e detyruar për shkak të gjendjes shëndetësore. Gjatë periudhës, kur zonja L.R. ishte me raport-mjekësor dhe po kurohej për sëmundjen e saj jashtë shtetit, DAR, Fier, ia ka shkëputur marrëdhëniet e punës.

Në shkelje të dispozitave të Kodit të Punës dhe legjislacionit në fushën e arsimit, DAR, Fier, përmes mosrespektimit të procedurave dhe shkeljeve ligjore, e ka vendosur ankuesen në pozita të pafavorshme dhe diskriminuese. KMD-ja ka vendosur konstatimin e diskriminimit të L.R, nga ana e Drejtorisë Arsimore Rajonale, Fier, për shkak të gjendjes së saj shëndetësore dhe i ka rekomanduar DAR, Fier, si subjekti që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të marrë masa për rregullimin e pasojave të shkaktuara në dëm të L.R.

Rekomandimi i Komisionerit është zbatuar nga DAR, Fier, i cili ka rikthyer në punë zonja L.R.

ÇËSHËTJA 2

Shtetasja K.N, në cilësinë e prindit të nxënëses N.N, ka paraqitur ankesë kundër drejtuesve të shkollës 9-vjecare jopublike “Alen” në Fier, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore.

Ankuesja shpjegon se fëmija e saj ishte nxënëse e klasës së tretë të ciklit të ulët shkollor, se kishte vështirësi në të nxënë dhe se shfaqte shenja të sjelljes agresive. Në janar 2014, drejtoria e shkollës ka dhënë urdhër që fëmija të largohej nga shkolla pa asnjë arsye.

Komisioneri ka vlerësuar se në bazë të nenit 7 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, sjellja diskriminuese mund të konsumohet si me veprim ashtu dhe me mosveprim. Mosveprimi i subjektit, shkolla “Alen”, në përputhje me parashikimet ligjore që garantojnë arsimimin e fëmijëve me probleme të të nxënësve ose sjelljes, ka bërë që nxënësjë N.N., për shkak të gjendjes së saj shëndetësore, të mos gëzojë në baza të barabarta me fëmijët e tjerë të drejtën për t’u arsimuar. Mosmarrja nga ana e institucionit mësimor dhe e prindit e masave efikase për të siguruar integritetin e fëmijës në shkollë përbën diskriminim të drejtpërdrejt, sipas parashikimit të bërë në nenin 3/2 të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Në përfundim Komisioneri ka vendosur konstatimin e diskriminimit të nxënëses N.N., për shkak të gjendjes shëndetësore nga ana e shkollës “Alen”, Fier, dhe ka rekomanduar që shkolla 9-vjecare jopublike “Alen” të marrë masat për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social në shkollë, për hartimin e një plani ndërhyrjesh për mbështetjen e nxënëseve me vështirësi të ndryshme në procesin e të nxënësve apo me aftësi të kufizuara.

Me shkresën datë 03.07.2014, shkolla “A” ka informuar Komisionerin për zbatimin e rekomandimit, duke ngritur grupin e punës në ndihmë të nxënësve me probleme të ndryshme.

10. Çështje diskriminimi për shkak të bindjeve fetare

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjatë vitit 2014 ka trajtuar pesë çështje (3 ankesa dhe 2 çështje të nisur kryesisht) për shkak të bindjes fetare. Nga këto:

- në një (1) ankesë është konstatuar diskriminim,
- në një (1) rast është konstatuar mos diskriminim,
- në një (1) rast ankesa nuk është pranuar,
- për 2 ankesa vazhdon procesi i shqyrtimit

ÇËSHËTJA 1

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në intervistën me titull “Ja pse jam anti-verior e anti-musliman”, që gazetari A.L. i ka marrë z. M. V, publikuar në gazetën Mapo-Weekend e datës 6-7 shtator 2014, filloi procedimin administrativ kundër zotit M. V.

Në trajtimin e kësaj çështjeje, Komisioneri ka mbajtur parasysh se bëhet fjalë për dy të drejta themelore të njeriut, siç janë liria e besimit fetar dhe liria e shprehjes. Çdo individ ka të drejtën absolute për të pasur mendimet e veta, por në kushtet kur këto mendime bëhen publike, liria e shprehjes, si një e drejtë themelore, nuk është absolute. Shoqëria karakterizohet nga shumëllojshmëri kulturash, besimesh fetare, stile jetese, zakonesh dhe për këtë, është e nevojshme që të pajtohen liria e shprehjes me të drejtat e tjera si liria e mendimit, ndërgjegjes dhe e fesë dhe me të drejtën për të mos u diskriminuar. Përshkrimet që z. M.V. u bënë veriorëve në intervistë, duke i etiketuar si hajdutë e kriminelë dhe etiketimi i fesë muslimane si fe e dhunës, krijojnë ndjenja urrejtjeje, përbuzje duke sjellë ndarje, përçarje krahinore dhe fetare. Mjafton t’u referohemi debateve, komenteve dhe shkrimeve në rrjetet sociale apo shkrimeve në shtypin e shkruar apo online, të cilat intensifikojnë qëndrimet fyese dhe denigruese mbështetur në prejardhje krahinore apo besimin fetar.

Në çështjen në fjalë, Komisioneri mbajti parasysh edhe dy fakte të tjera të rëndësishme që janë: cilësinë e zotit M. V. si person publik dhe mjetin nëpërmjet të cilit janë përhapur deklaratat. **Rëndësia që merr liria e fjalës për një person publik mbart me vete edhe një përgjegjësi më të madhe për të treguar më tepër kujdes dhe për të evituar gjuhën që nxit intolerancën dhe diskriminimin në publik.** Lufta kundër mungesës së tolerancës dhe diskriminimit janë thelbësore në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të drejta dhe liri që përbëjnë një nga bazat e shtetit. Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se, përhapja e ligjëratave të tilla nëpërmjet shtypit të shkruar përbën një mjet të fuqishëm të përhapjes së informacionit. E drejta e individëve për të shprehur lirisht mendimet nuk duhet të “fyejë, tronditë apo shqetësojë” të tjerët.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi se: Përmbajtja e intervistës me titull “Ja pse jam anti-verior e anti-musliman”, që gazetari A. L. i ka marrë z. M. V, publikuar në gazetën Mapo-Weekend e datës 6-7 shtator 2014, është diskriminuese. KMD-ja vendosi: Detyrimin e z. M.V, si personi që ka konsumuar sjelljen e mësipërme diskriminuese, të tërheqë publikisht deklaratat e bëra në intervistën e mësipërme brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e gjuhës që ka efektin e nxitjes, shpërndarjes ose promovimit të urrejtjes ose formave të tjera të diskriminimit.

Subjekti M.V. i është përgjigjur vendimit të KMD-së me një përgjigje me shkrim dt.18 tetor 2014, ku njofton Komisionerin se ka botuar në gazetën Mapo Weekend një "Falje dhe tërheqje" nga një pjesë e intervistës të dhënë po asaj gazete në datën 6-7 shtator 2014.

11. Çështje diskriminimi për shkaqe të tjera

Përkatësia në një grup të veçantë

Gjatë vitit 2014, KMD-ja ka dalë me vendim për 2 çështje. Në njërin nga çështjet, ankuesi pretendon se është diskriminuar për shkak të denoncimeve të bëra prej tij, kundrejt subjektit ndaj të cilit ka paraqitur ankesën. Në një rast tjetër, Komisioneri i ka nisur procedurat e shqyrtimit të ankesës për një nga shkaqet që parashikon ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi", dhe në përfundim të procedurave hetimore është konstatuar se ankuesi është diskriminuar për shkak të denoncimeve të bëra ndaj subjektit të cilit i ka paraqitur ankesën dhe përkatësisë në një grup të veçantë.

ÇËSHTJA 1:

Gjatë vitit 2014, KMD ka shqyrtuar ankesën e shtetasit M. G., në të cilën pretendon se është diskriminuar për shkak të gjendjes shëndetësore dhe të përkatësisë në një grupim sindikal nga ana e Albpetrol sh.a, Patos, Fier. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri është shprehur edhe për diskriminim në formën e viktimizimit, për shkak të ankimimit të paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Duke iu referuar faktit se z. M. G., ka paraqitur ankesën pranë Komisionerit më datë 05.06.2014, dhe se masat shtrënguese ndaj tij nga ana e Albpetrol sh.a., Patos, janë marrë kryesisht pas kësaj date si rezultat i këtij ankimimi, Komisioneri gjykon se, paligjshmëria e veprimeve apo mosveprimeve nga ana e Albpetrol sh.a., Patos, në dëm të ankuesit, ka sjellë për pasojë edhe vendosjen e tij në kushte të pafavorshme, duke filluar që nga transferimi i tij nga një pozicion pune në një tjetër më pak të favorshëm, deri në largimin e tij nga puna në mënyrë përfundimtare, si pasojë e zgjidhjes së kontratës së punës nga ana e punëdhënësit.

II.1.1.6. Format e diskriminimit

Ligji 10221/2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", në nenin 3 të tij ka parashikuar format e diskriminimit. Ndër format kryesore të diskriminimit, ky ligj ka parashikuar diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe diskriminimin e tërthortë. Ndërkaq, forma të tjera nëpërmjet të cilave manifestohen sjelljet diskriminuese, të parashikuara gjithashtu në këtë ligj, janë diskriminimi për shkak të shoqërimit, shqetësimet, udhëzimet për diskriminim, mohimi i një përshtatjeje të arsyeshme dhe viktimizimi. Ligji jep përkufizime për secilën nga këto forma, si dhe për konceptin e diskriminimit.

Më poshtë po paraqesim disa çështje të shqyrtuara nga KMD-ja, për të cilat është konstatuar diskriminim në forma të ndryshme:

ÇËSHTJA 1

Pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa e Znj. E. G., pedagoge e jashtme pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike & Inxhinierisë Fizike, të Uni-

versitetit Politeknik të Tiranës, ku pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes arsimore. Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, Universiteti Politeknik i Tiranës ka shpallur konkurs për dy pozicione të lira për personel akademik pranë Departamentit të Inxhinierisë Fizike, të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike & Inxhinierisë Fizike. Pas dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar dhe kërkesës për informacion mbi fazat e mëtejshme të konkurrimit, Znj. E. G. i është bërë me dije se faza e dytë e vlerësimit është kryer. Ajo nuk është njoftuar që është skualifikuar, pasi nuk i plotësonte të gjitha kriteret. Ankuesja i ka përfunduar studimet e larta në vitet 1994-1998, në degën e Fizikës, pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore në Universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër. Në njoftimin e Rektoratit të UPT-së konsiderohen si kualifikues vetëm ata kandidatë që kanë diplomë në Inxhinieri Fizike, FIMIF nga Universiteti Politeknik i Tiranës dhe në Fizikë, nga Fakulteti e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës. Ankuesja pretendon se ky kriter është diskriminues, sepse ajo i plotëson dhe i tejkalon të gjitha kriteret e tjera, përveç faktit që studimet e larta i ka përfunduar në degën e Fizikës, pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore në Universitetin "Luigj Gurakuqi" në Shkodër. Kështu, përmes këtij njoftimi, Universiteti ka bërë të pavlerë nivelet e tjera të studimeve të realizuara nga ankuesja. Znj. E. G. ka studiuar dhe është diplomuar "Doktor Shkencash" pranë Universitetit të Bolonjës në Itali, si dhe prej muajit maj 2014 gëzon titullin "Profesor i Asociuar".

Mbështetur në rezultatet e hetimit, KMD-ja vendosi,⁵⁸ **konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë** ndaj Znj. E. G., për shkak të gjendjes arsimore, si dhe konstatimin e diskriminimit të tërthortë ndaj kandidatëve që janë diplomuar pranë Universiteteve të Rretheve, në Fakultetin e Fizikës, dhe që zotërojnë një diplomë të nivelit të dytë të integruar (të njohur në bazë të legjislacionit në fuqi), për shkak të gjendjes arsimore, nga ana e Rektoratit të Universitetit Politeknik të Tiranës. Komisioneri rekomandon marrjen e masave të nevojshme nga Rektorati dhe Dekanati i Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Fizike, për ndryshimin e kriterëve përjashtues në të gjithë njoftimet për punësim për personel akademik nga data e daljes së këtij vendimi.

ÇËSHTJA 2

Gjatë vitit 2014, KMD-ja ka shqyrtuar ankesën e zonja H.H., paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kundër Drejtorit të Konvikteve të Shkollave të Mesme, Tiranë, për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi, për shkak të shoqërimit të të birit, kujdesi i të cilit është siguruar kryesisht nga punëmarrësi.

Zonja H.H. ka shpjeguar se ka qenë punonjëse e konviktit të shkollave të mesme në Tiranë që prej vitit 1998. Gjithashtu, zonja H.H. ka shpjeguar se largimi nga orari zyrtar i punës, për të shoqëruar djalin në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", për shkak të gjendjes së tij shëndetësore është bërë shkak për pushimin e saj nga puna. Në opinionin e tij, KMD-ja, ka vlerësuar se praktika e ndjekur nga Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme, duke i trajtuar njëloj të gjithë punonjëset e pastrimit të konviktit të Mjeshtërisë Sportive në Kamëz, pa marrë parasysh kushtet e ndryshme që mund të kishin, përbën diskriminim substantiv (trajtim i barabartë i çështjeve të pabarabarta), duke cenuar të drejtën e zonja H. H. për punësim, për shkak të pasjes së një djali me aftësi të kufizuara.

58 Me vendimin nr. 6, datë 20.01.2015 e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Komisioneri vendosi **konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejt, për shkak të shoqërimin**, ndaj H. H., nga Drejtori i Konvikteve të Shkollave të Mesme, z. I. D., duke e vënë atë në kushte jo të favorshme në raport me punonjësit e tjerë të Konvikteve të Shkollave të Mesme. KMD-ja i rekomandoi Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme, që të rikthejë në pozicionin e mëparshëm të punës H. H.-në, duke e informuar për detyrimin e saj për të informuar dhe njoftuar Komisionerin brenda 30 (tridhjetë) ditëve lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi, bazuar në nenin 33, pika 11, të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Në referim të nenit 33, pika 11, e ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2011, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13 të po këtij neni.

ÇËSHTJA 3

F.D., kundër Drejtores së Kopshtit 25, Tiranë

F.D., në cilësinë e prindit të fëmijës Gj.D. (i diagnostikuar me autizëm infantil), pretendon se për shkak të aftësisë së kufizuar të fëmijës së saj, drejtoresha e kopshtit ka refuzuar t'ia regjistrojë fëmijën.

Në udhëzimin nr. 23, datë 08.08.2014 "Për vitin shkollor 2014-2015 në sistemin arsimor para-universitar", Kreu III, pika 2/b përcaktohet se: "DAR/ZA-të, drejtuesit dhe mësuesit e kopshteve publike të ndjekin me përparësi: b) regjistrimin në kopshte të fëmijëve nga familjet në nevojë, rome, egjiptiane dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara". Referuar sa më sipër, vlerësohet se regjistrimi me përparësi i fëmijëve me aftësi të kufizuara është detyrim për drejtuesit e institucioneve arsimore, pavarësisht kushteve të kopshteve apo ngarkesës së personelit mësues.

Referuar dispozitave normative për arsimin para-universitar 2013, kreu XV "Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara", neni 93 përcakton edhe procedurat e funksionimit të komisionit multidisiplinar pranë institucionit arsimor dhe DAR/ZA-së. Në pikën 4 të nenit 93 përcaktohet se: "Drejtori i institucionit arsimor këshillohet me komisionin e institucionit arsimor para se t'i drejtohet komisionit pranë DAR/ZA-së dhe bashkëpunon me prindërit e fëmijës për të paraqitur kërkesën e tij". Në nenin 95/1 përcaktohet se: "Drejtori i institucionit arsimor të zakonshëm ngre komisionin për nxënësit me aftësi të kufizuara, në përbërje të të cilit janë tre mësues të lëndëve të fushave të ndryshme të të nxënës dhe psikologu/punonjësi social. Në komision merr pjesë të paktën një nga mësuesit e nxënësit me aftësi të kufizuara dhe mësuesi ndihmës (kur ka). Kryetar i komisionit është punonjësi i shërbimit psiko-social".

Nga dokumentacioni i shqyrtuar, Komisioneri vlerëson se nuk vërtetohet të jenë kryer veprime diskriminuese për regjistrimin e fëmijës Gj.D., nga ana e personelit të kopshtit 25, për shkak të aftësisë së kufizuar. Ndërkohë, gjatë shqyrtimit të dokumenteve të vëna në dispozicion nga palët, vërehet se në Kopshtin 25, gjatë procesit të regjistrimit dhe fillimit të kopshtit nuk ka funksionuar komisioni multidisiplinar për vlerësimin e gjendjes së fëmijës Gj.D., në mënyrë që pastaj në bashkëpunim me prindin e fëmijës t'i drejtoheshin komisionit të DAR/ZA-së për të bërë vlerësimin e nevojave arsimore e shoqërore të fëmijës.

Komisioneri ka vlerësuar se në bazë të nenit 7 të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi", sjellja diskriminuese mund të konsumohet si me veprim ashtu dhe me mosveprim. Mosveprimi i subjektit, Kopshtit 25, në përputhje me parashikimet ligjore që garantojnë arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, ka bërë që fëmija për shkak të aftësisë së kufizuar të mos gëzojë në baza të barabarta me fëmijët e tjerë të drejtën për t'u arsimuar. Mosmarrja nga ana e institucionit mësues dhe e prindit e masave efektive për të siguruar integritetin e fëmijës në Kopshtin 25 përbën **diskriminim të drejtpërdrejt**, sipas parashikimit të bërë në nenin 3/2 të ligjit nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", duke rekomanduar që drejtorja e kopshtit 25 të marrë masa për ngritjen e komisionit të institucionit arsimor.

Me shkresën 5/1 datë 23.01.2015, drejtorja e kopshtit 25 ka informuar Komisionerin për zbatimin e rekomandimit dhe ngritjen e komisionit për fëmijët me aftësi të kufizuara.

ÇËSHTJA 4

Ankuesja L. G. sqaron se është e punësuar pranë Kompanisë Albpetrol sh.a., me arsim profesional mjekësor-infermieri dhe kurs 1-vjeçar për laborant klinik-biokimik, të përfunduar para viteve '90. Për shkak të lidhjes familjare që ka me M. G. (bashkëshorti i saj, përfaqësues i Sindikatës së Punonjësve të Naftës), e kanë transferuar nga pozicioni i laborantes kliniko-biokimike, në pozicionin e punëtores së mjedisit. Sipas saj, janë punësuar dy punonjës të rinj, si ndihmës mjekë-infermierë, të cilët nuk kanë eksperiencë pune dhe arsimit i tyre nuk përshatet me pozicionin e punës që mbajnë. Gjithashtu, në ankesë ajo ka sqaruar se për shkak të denoncimeve të bëra nga bashkëshorti i saj ndaj Kompanisë Albpetrol sh.a., asaj i është ushtruar presion i vazhdueshëm për ta larguar nga puna. Pas ankesës së bërë pranë KMD-së, ndaj saj është marrë një masë disiplinore e pajustificuar.

Referuar fakteve të paraqitura nga palët, Komisioneri e gjen të pabazuar faktin e dhënies së masës disiplinore ndaj L. G. dhe ka bindjen se kjo masë është dhënë në mënyrë të qëllimshme dhe tendencioze, bazuar në mungesën e një arsytimi nga ana e shoqërisë Albpetrol sh.a. Gjithashtu, u konstatua se mungesa e procedurës me anë të së cilës të evidentohet prania e punonjësve në punë, ishte bërë shkak për dhënien e masës disiplinore ndaj ankuses.

Në përfundim, nisur nga shqyrtimi i fakteve, Komisioneri gjykoj se, paligjshmëria e veprimeve apo mosveprimeve nga ana e Albpetrol sh.a., Patos, në dëm të ankuses, ka sjellë për pasojë edhe vendosjen e saj në kushte të pafavorshme, duke filluar që nga transferimi i saj nga një pozicion pune në një tjetër më pak të favorshëm për të, deri në marrjen e masës disiplinore të pabazuar në prova dhe fakte.

*KMD-ja konstatoi **diskriminimin e ankuses, në formën e shoqërimin**, për shkak të pjesëmarrjes në sindikatë të bashkëshortit të saj, nga punëdhënësi Albpetrol sh.a, Patos, dhe - **konstatimin e diskriminimit, në formën e viktimizimit** të ankuses, për shkak të ankesës së bërë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nga punëdhënësi Albpetrol sh.a, Patos.*

II.1.1.7. Fushat në të cilat janë paraqitur ankesat

Për vitin 2014, janë paraqitur pranë zyrës së Komisionerit 180 ankesa të ndara sipas fushave kryesore në arsim, punësim dhe në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Më poshtë evidentohej paraqitja grafike e shpërndarjes së ankesave.




Tabela nr.7, Ankesat sipas fushave të diskriminimit

• Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve

Ankesat në fushën e të mirave dhe shërbimeve përbëjnë numrin më të madh, në krahasim me dy fushat e tjera. Përgjithësisht ankesat kanë të bëjnë me përshtatjen e arsyeshme, vonesat në pagesat e pensioneve të invaliditetit, vonesat në marrjen e masës mujore të ndihmës ekonomike etj.

ÇËSHTJA 1

Sipas informacionit të marrë nga Gazeta Shqiptare e datës 19.04.2013, të moshuarit e Shtëpisë së të Moshuarve, Shkodër, kishin rreth 7 muaj pa marrë ndihmën ekonomike nga ana e Shërbimit Social Shtetëror.

Pas përfundimit të hetimeve të kryera dhe bazuar në dokumentacionin e administruar nga zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, u konstatua se të moshuarit e Shtëpisë së të Moshuarve, Shkodër, përballen vazhdimisht me vonesa në kalimin e pagesave të tyre, të cilat Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, si dhe Shërbimi Social Shtetëror ua dërgojnë me vonesë.

Mbështetur në provat dhe faktet e grumbulluara, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatoi diskriminimin e të moshuarve, të Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër, për shkak se i përkasin një grupi të veçantë personash, të cilët janë vendosur në shtëpitë rezidenciale publike dhe nuk kanë të ardhura. KMD-ja rekomandoi që, në ushtrimin e funksioneve të veta

të ligjshme, strukturat e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, të mbajnë parasysh gjendjen ekonomike dhe shoqërore të të moshuarve të Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër, dhe të marrin masa të menjëhershme për kalimin e pagesës prej 6000 lekë në muaj, që përfitojnë të moshuarit e kësaj qendre sociale.

Në përgjigje të Rekomandimit të Komisionerit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, informoi Komisionerin lidhur me marrjen e masave të menjëhershme për kalimin e pagesës prej 6000 lekë në muaj për të gjithë shtetasit që përfitojnë këtë pagesë.

• Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit

Ankesat me pretendim diskriminim në fushën e punësimit drejtohen ndaj institucioneve shtetërore dhe subjekteve private. Ato kanë të bëjnë kryesisht me sjellje diskriminuese të shfaqura gjatë transferimit apo zgjidhjes së marrëdhënieve të punës për shkaqe abuzive.

Në vitin 2014, numri i përgjithshëm i tyre është 69. Në krahasim me vitin e shkuar, ankesat e paraqitura në fushën e punësimit kanë të bëjnë me largimet nga puna. Ankesat që janë trajtuar në fushën e punësimit kanë pasur si pretendim diskriminim për bindjet politike, gjendjen shëndetësore, përkatësinë në një grupim të veçantë, gjendjen arsimore, racën, moshën.

Në fushën e punësimit, për disa nga çështjet e përfunduara KMD-ja ka dhënë vendime për diskriminim si dhe rekomandimet përkatëse për rregullimet dhe masat që duhen marrë nga subjekti që ka kryer diskriminim. Në 7 raste, subjektet që kanë kryer diskriminim kanë zbatuar rekomandimet e Komisionerit, duke rikthyer ankuesit në punë.

ÇËSHTJA 1

Shtetasi A.T. ka paraqitur ankesë kundër KESH sh.a, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të "bindjeve politike". Ankuesi ka shpjeguar se Administratori i KESH sh.a, ka zgjidhur kontratën e punës me të, me motivacionin "Për arsye të ristrukturimit të Institucionit", kurse në argumentimin shkresor të tij, KESH thotë se largimi nga puna ka ardhur për mospërputhshmëri arsimore të ankuesit me pozicionin e punës. Ankuesi ka sjellë dokumentacion për të mundësuar verifikimin e pretendimit të tij.

Ndërkohë që ankuesi ka vërtetuar bindjet e tij politike dhe faktin e njohjes së tyre, nga ana e KESH sh.a nuk është sjellë asnjë provë, apo dokument shkresor me përshkrimet e pozicionit të punës, ku të përcaktoheshin kriteret e kërkuara për pozicionin e specialistit në të cilin ishte emëruar z. A. T. (ku të ishte i specifikuar edhe arsimimi i kërkuar). Po kështu, vetë ristrukturimi i këtij institucioni, nuk ka cenuar as strukturën ku punonte ankuesi, as pozicionin e tij të punës.⁵⁹

⁵⁹ Nga shqyrtimi i Strukturës organike të KESH sh.a, miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 12.01.2013 në Divizionin e Gjenerimit, në Departamentin e Mirëmbajtjes, rezultojnë të jenë 10 (dhjetë) punonjës. Ndërkaq në strukturën organike të KESH sh.a, miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 4, datë 23.10.2013, në Divizionin e Gjenerimit, në Departamentin e Mirëmbajtjes, rezultojnë të jenë 15 (pesëmbëdhjetë) persona, pra 5 (pesë) më shumë se në strukturën e mëparshme, çka do të thotë se nuk ka reduktim të numrit të punonjësve, përkundrazi. Është e vërtetë që në strukturën e re ka 57 punonjës më pak sesa në strukturën e mëparshme, por kjo vlen për Shoqërinë KESH sh.a në rang kombëtar, ndërsa verifikohet se për rastin specifik të Departamentit të Mirëmbajtjes ku ishte i punësuar A.T, kemi rritje të numrit të punonjësve.

- **Me Vendimin nr. 148, datë 26.09.2014, Komisioneri ka gjobitur KESH sh.a, për moszbatimin e rekomandimit për të rikthyer në detyrë shtetasin A.T.**
- **Vendimi me gjobë i Komisionerit është kundërshtuar në Gjykatën Administrative të Rrethit Tiranë, e cila ka rrëzuar kërkesën e KESH sh.a, dhe ka lënë në fuqi Vendimin me gjobë të KMD-së.**

• Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e arsimit

Gjatë vitit 2014, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë paraqitur 7 ankesa, në fushën e arsimit. Rastet në fushën e arsimit kanë pasur përgjithësisht si shkaqe diskriminimi racën, gjendjen shëndetësore dhe aftësinë e kufizuar. Pjesa më e madhe e këtyre rasteve ka të bëjë me mospranimin e integritit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme dhe mospranimin e regjistrimit të fëmijëve të komunitetit rom në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme.

ÇËSHTJA 1

Shtetasja E.C. ka paraqitur ankesë kundër AQ, E.B., dhe K.G., drejtues të Universitetit "Ismail Qemali" në Vlorë, në të cilën pretendon se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë, krahasuar me kolegët e tjerë të departamentit, dhe se të gjitha këto veprime kanë ardhur pasi E.C me kërkesat dhe shkresat drejtuar, sipas shkallës së hierarkisë, autoriteteve drejtuese të universitetit, gjithashtu dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ka denoncuar shkeljet që ka vërejtur gjatë zhvillimit të veprimtarisë mësimore dhe administrative në Universitetin "Ismail Qemali" në Vlorë dhe për shkak të qëndrimit të saj kundrejt procesit zgjedhor për organet drejtuese të universitetit të vitit 2012.

Në përgjigje të këtij pretendimi, drejtuesit e Universitetit të Vlorës kanë sqaruar se pretendimet e subjektit ankues nuk janë të vërteta, pasi gjykojnë se pretendimi për diskriminim i përket periudhës 2011 - tetor 2013, pra pasoja ka qenë përpara shkakut. Për sa i përket pretendimit për diskriminim për shkak të qëndrimit kundrejt procesit zgjedhor të vitit 2012 për organet drejtuese të universitetit, ata informojnë se nuk janë në dijeni të ndonjë deklaratë publike apo personale, formale apo informale të ankueses, nëpërmjet të cilës t'u jetë drejtuar organeve drejtuese të zgjedhjeve për pretendime të ndryshme.

Komisioneri ka vlerësuar se të gjitha kërkesat/ankesat, denoncimet e subjektit ankues, shkresa të cilat përbëjnë dhe shkakun e diskriminimit të pretenduar nga E.C., janë bërë pas periudhës kur pretendohet se kanë kryer veprimet diskriminuese, gjithashtu dhe pretendimi për diskriminim për shkak të qëndrimit kundrejt procesit zgjedhor për organet drejtuese të universitetit të vitit 2012 nuk provohet.

Referuar sa më sipër, Komisioneri vlerëson se për të provuar sjelljen diskriminuese është e nevojshme që të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet trajtimit të pafavorshëm dhe shkakut të mbrojtur. Në shqyrtim të dokumentacionit të dorëzuar nga palët nuk provohet shkakut për të cilin pretendohet diskriminimi dhe si rrjedhojë, nuk provohet as sjellja diskriminuese.

Lidhur me pretendimin e subjektit ankues se me datë 08 dhe 09.01.2014 i është drejtuar me shkresë Rektorit të Universitetit, për dijeni Ministres së Arsimit dhe Sportit dhe Kryeminis-

trit të RSH, në të cilën kërkonte ndalimin e veprimeve diskriminuese ndaj saj, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga palët, Komisioneri ka ardhur në përfundim se Rektori i Universitetit të Vlorës nuk i është përgjigjur zyrtarisht ankesave të bëra nga E.C., ndërkohë që punëdhënësi ka pasur për detyrë të shqyrtonte ankesat e paraqitura nga ankuesja brenda një muaji nga marrja e tyre dhe t'i kthente asaj përgjigje.

Komisioneri, në analizë të rregullores së Universitetit të Vlorës, si dhe deklarimeve të A.Q, E.B dhe K.G, ka vlerësuar se në rregullore nuk ka të parashikuar procedura të sakta për shpërndarjen e lëndëve dhe ngarkesës mësimore, por është lënë në detyrë të përgjegjësit të departamentit për të bashkërenduar shpërndarjen e ngarkesës mësimore. Mungesa e një udhëzimi të qartë për procedurën dhe kriteret që duhen përdorur për shpërndarjen e lëndëve dhe ngarkesës mësimore ka shkaktuar interpretime të ndryshme midis personelit akademik dhe drejtuesve të universitetit.

Në përfundim Komisioneri ka vendosur:

1. **Konstatimin e mosdiskriminimit** të E.C për shkak të qëndrimeve të saja parimore për cenimin e standardeve të shërbimit arsimor në universitet dhe për shkak të qëndrimit kundrejt procesit zgjedhor për organet drejtuese të universitetit të vitit 2012 nga ana e drejtuesve të universitetit.
2. **Konstatimin e diskriminimit të E.C., për shkak të qëndrimeve kritike të saj,** nga Rektori i Universitetit të Vlorës, i cili nuk i ka shqyrtuar ankesat e paraqitura nga ankuesja në datë 08-09.01.2014.

Komisioneri, për përmirësimin e situatës së konstatuar, i ka rekomanduar:

1. Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, të zbatojë detyrimet e përcaktuara për punëdhënësit në nenin 13 të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi", duke shqyrtuar në mënyrë efektive dhe brenda afateve ligjore çdo ankesë për diskriminim nga punëmarrësit.
2. Të parashikojë në aktet e tij të brendshme procedura të përcaktuara qartë për shqyrtimin e ankesave për diskriminim nga punëmarrësit.
3. Të marrë masat për hartimin e një udhëzimi për procedurën dhe kriteret që duhen përdorur për shpërndarjen e lëndëve dhe ngarkesës mësimore.
4. Të njoftojë E.C., për arsytet e mosrimbursimit apo rimbursimit të vonuar të shpenzimeve të miratuar nga dekani E.B., me shkresat datë 29.05.2013 dhe 21.10.2013.

Me shkresën nr. 500/1 datë 23.10.2014, Universiteti i Vlorës e ka informuar Komisionerin për zbatimin e rekomandimit, duke dorëzuar dhe dokumentet përkatës.

ÇËSHTJA 2

Pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa e zonjës A. P., kundër M. P., Drejtor pranë Shkollës së Bashkuar Vau i Dejës, ku pretendohet diskriminimi i djalit të saj, për shkak të aftësisë së kufizuar.⁶⁰

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, M. P., ndjek klasën e tretë pranë Shkollës së Bash-

60 M. P. vuan nga autizmi.

kuar Vau i Dejës, por prej 2 javësh nuk kishte frekuentuar më mësimin. Nëna e tij, e cila është mësuese pranë kësaj shkolle, ka theksuar faktin se shkak për këtë mos-frekuentim, është kërkesa e drejtorit të shkollës për ta larguar djalin e saj nga shkolla, pasi ai përbën problem për fëmijët e tjerë, për shkak se vuan nga autizmi. Ndër të tjera, nëna e M. P-së kërkoi ndërhyrjen e Komisionerit me qëllim që djalit të saj t'i sigurohet një mësues ndihmës, në bazë të nenit 65, pika 3, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor para-universitar në Republikën e Shqipërisë", në mënyrë që ai të fillojë të frekuentojë shkollën.

Në bazë të rezultateve të hetimit u konstatua se DAR, Shkodër, dhe Drejtori i Shkollës së Bashkuar Vau i Dejës nuk i kishin plotësuar detyrimet e tyre ligjore kundrejt nxënësve me aftësi të kufizuara, detyrime këto të parashikuara nga ligji nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor para-universitar në Republikën e Shqipërisë" dhe urdhrit nr. 343, datë 19.8.2013, të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencave "Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor para-universitar". DAR, Shkodër, ishte njoftuar zyrtarisht, lidhur me rastin e nxënësit M. P., por ky institucion nuk kishte ndërmarrë asnjë masë për zgjidhjen e këtij problemi. Nga analiza në tërësi e fakteve dhe provave të administruara, u gjykua se nxënësi M.P., ishte ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë nga ana e DAR, Shkodër, dhe Shkollës 9-vjeçare, Vau i Dejës, Shkodër, në krahasim me nxënësit e tjerë të kësaj shkolle. Ky trajtim kishte lidhje të drejtpërdrejt me aftësinë e tij të kufizuar.

Për sa më sipër, Komisioneri vendosi⁶¹ konstatimin e diskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar të nxënësit M.P., nga ana e DAR, Shkodër, dhe Shkollës 9-vjeçare, Vau i Dejës, Shkodër, si dhe rekomandoi plotësimin e detyrimeve ligjore përkatëse nga ana e dy institucioneve të sipërpërmendura.

Në zbatim të Ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi" dhe vendimit të mësipërm, Shkolla 9-vjeçare, Vau i Dejës, Shkodër, ka informuar KMD-në për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimit dhe plotësimin e detyrimeve tyre ligjore.

II.1.1.8. Çështje të nisura me iniciativë të KMD-së

Gjatë vitit 2014, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka filluar procedurën e shqyrtimit kryesisht të 8 çështjeve. Informacioni fillestar për fillimin e këtyre çështjeve është marrë në dy raste nëpërmjet medias, në dy raste të tjera Komisioneri është vënë në dijeni nga shoqatat me anë të shkresave, në dy raste të tjera nëpërmjet postës elektronike të publikuar në faqen e internetit të Komisionerit, si dhe nëpërmjet telefonatave të bëra nga persona që vuajnë dënimin në institucionet e ekzekutimit të veprave penale (IEVP).

Të gjitha këto çështje kanë pasur të bëjnë me fushën e të mirave dhe shërbimeve për shkaqe të ndryshme si: përdorimi i gjuhës fyese për shkak të racës, për shkak të vendbanimit (me banim jashtë shtetit apo jashtë banimit në qendër, qark), për shkak të gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar apo dhe bindjes fetare.

Nga këto çështje të shqyrtuara 5 (pesë) janë mbyllur me vendim: në 3 (tre) raste Komisioneri ka rekomanduar përmirësimin e situatave që kanë sjellë veprimet diskriminuese të konstatuara dhe në 2 (dy) raste ka konstatuar mosdiskriminim.

II.1.1.9. Rezultatet e vendimeve të ankesave të shqyrtuara

Duke u bazuar në nenin 33 të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi", fillimisht ankesat i janë nënshtruar një shqyrtimi paraprak, lidhur me kushtet e pranimit. Nëse ankesa nuk ka plotësuar kriteret e pranimit, ose ka pasur mungesë informacioni, e cila mund të pengonte procedurën e mëtejshme të shqyrtimit të saj, ankuesit i është kërkuar që të plotësonte kriteret e kërkuara nga ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi", për ta bërë atë të vlefshme. Kanë qenë të shumta rastet në të cilat, falë bashkëpunimit me njësitë vendore, subjekteve ankues u është ofruar ndihmë nga njësitë vendore për plotësimin e saktë të formularëve të ankesës dhe dokumentacionit të nevojshëm, në përmbushje të kërkesave të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Në vitin 2014, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka përfunduar shqyrtimin administrativ të 209 çështjeve, nga të cilat:

- Për 32 çështje, është konstatuar diskriminim (27 vendime për konstatim diskriminimi dhe 5 çështje të përfunduara me arritje qëllimi, pasi situata është rregulluar gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës);
- 115 vendime për konstatim mosdiskriminimi;
- 12 vendime për ndërprerje procedurash, për shkak se ankuesit janë tërhequr;
- 3 vendime për pushimin e çështjes për shkaqe të ndryshme;
- 43 vendime për mospranim të ankesës;
- Një (1) rekomandim për përmirësimin e situatës
- 3 vendime për vendosjen e sanksioneve me gjobë për subjektet që nuk kanë vënë në dispozicion të KMD-së informacionin e kërkuar prej tij, bazuar në Ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010, "Për mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka zhvilluar seanca dëgjimore publike në 18 raste, ku ka ftuar palët dhe çdo person tjetër të interesuar për të parashtruar pretendimet e tyre.

Disa nga ankesat e shqyrtuara nga KMD-ja janë zgjidhur me ndërmjetësim.

61 Me vendimin nr.1, datë 15.01.2015, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.




Tabela nr.8: Zgjidhja e ankesave të trajtuara

II.1.2. Trajtimi i çështjeve me objekt diskriminimin në gjykatë

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” e vendos KMD-në në një marrëdhënie të gjerë me gjykatën, duke parashikuar mjaft kompetenca për sa i takon pjesëmarrjes së këtij institucioni në proceset gjyqësore. Mbi të gjitha, ligji ka si qëllim që parimi i mosdiskriminimit të trajtohet në frymën e tij, jo vetëm në rrugë administrative nga KMD-ja, pra, nëpërmjet shqyrtimit administrativ të ankesave apo inicimit të çështjeve *ex-officio*, por edhe nëpërmjet zbatimit efektiv të tij nga gjykata.

Gjatë vitit 2014, vihet re një rritje e ndjeshme e pjesëmarrjes së Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në proceset gjyqësore nga viti 2012 deri në 2014, e cila pasqyrohet si më poshtë në formë tabele:

Pjesëmarrja e KMD-së në proceset gjyqësore	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014
	3	6 <i>(3 çështje të mbartura)</i>	18

Tabela Nr. 9 Pjesëmarrja e KMD-së në proceset gjyqësore

Tabela e mëposhtme tregon pjesëmarrjen e KMD-së në proceset gjyqësore si palë e paditur, palë e tretë, në dhënien e mendimeve me shkrim për gjykatën për çështje diskriminimi si dhe në proceset gjyqësore të iniciuara nga KMD-ja me kërkesë të tij, për lëshimin e Urdhrave të Ekzekutimit nga Gjykata për gjobat e vëna nga KMD-ja për shkak të moszbatimit të vendimeve të tij nga subjektet që kanë mbajtur sjellje diskriminuese.

Viti	KMD si palë e paditur	KMD si palë e tretë	Dhënie mendimi me shkrim për gjykatën	Kërkesë për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit nga gjykata
2012	1	1	1	-
2013	3	3	-	-
2014	6	3	6	3

Tabela Nr. 10: Roli i KMD-së në proceset gjyqësore gjatë vitit 2014

II.1.2.1 Dhënie mendimi me shkrim nga KMD-ja për gjykatat

Veprimtaria e KMD-së në këto vite e ka konsoliduar rolin e tij si një organ i specializuar në fushën e mosdiskriminimit. Është rritur dukshëm kërkesa e gjykatave për marrjen e mendimeve me shkrim nga KMD-ja edhe për çështjet e diskriminimit të dërguara drejtpërdrejt në gjykatë. Siç shihet nga tabela nr. 10, ka një rritje të kërkesës së gjykatave për parashtrimin e mendimeve me shkrim nga KMD-ja, kur ato kanë në shqyrtim çështje me objekt diskriminimit. Kjo lidhet edhe me trajnimet që KMD-ja dhe Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut kanë zhvilluar në gjykatat e pesë rrethëve gjyqësore në Shqipëri gjatë vitit 2014.

Në Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 36, pika 4, “Procedura para gjykatës”, parashikohet se “Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”. KMD-ja, si organ i specializuar, ka krijuar një raport të rëndësishëm me gjykatat, fakt ky që kontribuon në zbatimin efikas të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në sistemin gjyqësor dhe trajtimin e çështjeve të diskriminimit nga gjykatat bazuar në standardet e këtij ligji organik.

Në vijim paraqitet një përmbledhje e çështjeve për të cilat KMD-ja ka dhënë mendime me shkrim:

ÇËSHTJA GJYQËSORE 1

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë pjesë në procesin me palë paditëse: D. S., me të paditur: Këshillin e Lartë të Drejtësisë, dhe me Persona të Tretë: Ministrinë e Drejtësisë dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Paditësja ka kërkuar konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjeve politike, pasi KLD-ja nuk ka marrë në shqyrtim kërkesën e paditëses. Kjo çështje nuk ishte shqyrtuar më parë nga KMD-ja. Paditësja ka pretenduar se KLD-ja nuk ka marrë në shqyrtim kërkesën e saj për t’u emëruar në detyrën e mëparshme publike që ajo kish pasur, përpara detyrës së saj si anëtare e KQZ-së, siç edhe Kodi Zgjedhor parashikon. Shkaku, sipas palës paditëse, është se D.S. ishte propozuar nga opozita e asaj kohe dhe mendohet nga KLD-ja se është e politizuar. Paditësja ka pretenduar se ajo ishte trajtuar ndryshe nga një koleg i saj, anëtar i KQZ-së, të cilit i kishte mbaruar mandati në të njëjtën kohë me paditësen dhe se ky i fundit ishte emëruar në detyrën që kishte mbajtur më parë. Siç doli, kolegu me të cilin paditësja po krahasohej, ishte emëruar nga e njëjta parti politike, ashtu si edhe paditësja. Në opinionin e paraqitur, KMD-ja ka re-

komanduar të bëhet dallimi midis diskriminimit dhe paligjshmërisë. Me vendimin nr. 7462, datë 17.12.2014, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, vendosi: - **Pranimin e padisë së paditëses në lidhje me pretendimin e saj për diskriminim duke vendosur: - Konstatimin e diskriminimit për shkak të mosmarrjes në shqyrtim të kërkesës së palës paditëse nga ana e palës së paditur, Këshillit të Lartë të Drejtësisë. - Detyrimin e KLD-së që të marrë në shqyrtim kërkesën e paditëses dhe dëmshpërblimin e paditëses me 1.000.000 lekë për dëmin moral te pësuar për shkak të diskriminimit.**

ÇËSHTJA GJYQËSORE 2

Paditës: S.L., i paditur: Albacall sh.a - Çështje diskriminimi në fushën e marrëdhënieve të punës.

Paditësi S.L. ka qenë në marrëdhënie pune pranë subjektit privat Albacall sh.a dhe përpara gjykatës ka kërkuar: konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së punës, sipas dispozitave të Kodit të Punës, si dhe dëmshpërblimin për diskriminim, pasi paditësi pretendonte se largimi i tij ishte bërë për shkak të krijimit nga ana e tij të sindikatës së punonjësve të shoqërisë (paditësi S.L. pretendonte se kishte ndërmarrë hapa për krijimin e sindikatës, por sindikata zyrtarisht nuk ishte krijuar dhe regjistruar sipas ligjeve në fuqi).

KMD-ja është thirrur nga gjykata në bazë të nenit 36, pika 4, e Ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi", për të paraqitur mendim me shkrim lidhur me çështjen, në bazë të kërkesës që paditësi kishte bërë gjatë gjykimit. Kjo çështje nuk ishte shqyrtuar më parë nga KMD-ja.

Nëpërmjet opinionit të paraqitur, KMD-ka i rekomandoi gjykatës se ajo duhej të merrte parasysh faktin se edhe veprimtaria paraprake për krijimin e sindikatës duhet të gëzojë mbrojtje nga diskriminimi, (por ishte detyrimi i paditësit që ta provonte këtë veprimtari paraprake, pra të provonte ekzistencën e shkakut të diskriminimit), pra edhe në mungesë të krijimit *de jure* të sindikatës, si edhe rekomandimin për zhvendosjen e barrës së provës, pasi paditësi të kishte provuar veprimtarinë paraprake të ndërmarrë nga ana e tij për krijimin e sindikatës. Me vendimin nr. 10999 datë 14.11.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, vendosi rrëzimin e pretendimeve për diskriminim të paditësit. Në lidhje me opinionin e paraqitur nga KMD-ja, gjykata në vendimin e saj është shprehur se, në bazë të neneve 213-295 të K.Pr.Civile, ai opinion nuk mund të merret në cilësinë e provës nga ana e gjykatës dhe në këtë kontekst as nuk mund t'i shërbejnë analizës së gjykatës në favor apo kundër pretendimit të paditësit për diskriminim.

Përmes kësaj çështje, janë identifikuar dy probleme në lidhje me zbatimin e ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi":

- 1. Gjykata nuk e njofton Komisionerin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim, siç parashikohet në nenin 36, pika 3, "Procedura para gjykatës";**
- 2. Vendimi përfundimtar i gjykatës nuk iu komunikua Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, detyrim ky i përcaktuar nga neni 37/2 i ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi".**

ÇËSHTJA GJYQËSORE 3

KMD-ja ka dhënë mendim me shkrim përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Durrës, në çështjen me palë ndërgjyqëse, Paditës: Z.H; dhe të Paditur: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Tiranë, dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Durrës; me objekt gjykimi: "1. Shfuqizimi tërësisht i aktit administrativ, Vendimi nr. 369, dt. 30.12.2013, i Drejtorit të Përgjithshëm të DPSHTRR-së, Tiranë, 2. Detyrimin e palës së paditur të më kthejë në vendin e mëparshëm të punës 3. Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë me pagesën e një vitit pune, Për shkak të zgjidhjes të kontratës së marrëdhënies së punës pa shkaqe të arsyeshme 4. Detyrimin e palës së paditur të më shpërblejë me 1/2 e pagës mujore Për vjetërsi në punë, Për periudhën e panjohur dhe të papaguar prej tyre".

Kjo çështje ka qenë objekt shqyrtimi nga KMD-ja. Meqenëse, gjatë procedimit administrativ, subjekti ankues i është drejtuar njëkohësisht edhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Durrës, me kërkesë-padi me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë KMD-së, Komisioneri e ka pushuar çështjen. KMD-ja e ka ndjekur të gjithë procesin gjyqësor, duke parashtruar mendimin e vet me shkrim lidhur me çështjen në fjalë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Durrës, ka dalë me vendim,⁶² në të cilin është referuar dhe marrë në konsideratë mendimi i KMD-së, duke u shprehur mbi diskriminimin e palës paditëse, bazuar në ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Durrës, vendosi: - **Pranimin pjesërisht të padisë; - Detyrimin e të paditurve të dëmshpërblejnë dëmin e shkaktuar paditësit, si pasojë e zgjidhjes së kontratës së punës Për shkaqe të paarsyeshme, në masën e 6 (gjashtë) pagave mujore; - Rrëzimin pjesërisht të padisë Për pjesën tjetër të objektit".** Ky vendim është ankimuar dhe aktualisht është në Gjykatën Administrative të Apelit.

ÇËSHTJA GJYQËSORE 4

KMD-ja ka dhënë mendim me shkrim përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Durrës, në çështjen me palë ndërgjyqëse: Paditës: S.P; të Paditur: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Tiranë dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Durrës; me objekt gjykimi: "1. Shfuqizimi tërësisht i aktit administrativ, Vendimit nr. 368, dt. 30.12.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPSHTRR-së, Tiranë, 2. Detyrimi i palës së paditur të më kthejë në vendin e mëparshëm të punës 3. Detyrimi i palës së paditur të më dëmshpërblejë me pagesën e një viti pune, Për shkak të zgjidhjes së kontratës së marrëdhënies së punës, pa shkaqe të arsyeshme (motiv abuziv), Neni 146/1/c".

Kjo çështje nuk ka qenë objekt shqyrtimi nga KMD-ja. Subjekti ankues i është drejtuar drejtpërdrejt gjykatës kompetente, e cila ka thirrur KMD-në për parashtrimin e mendimit të tij me shkrim përpara gjykatës.

Lidhur me këtë çështje, Gjykata ka dalë me vendim⁶³, në të cilin i është referuar dhe ka marrë në konsideratë mendimin e parashtruar nga KMD-ja, duke u shprehur mbi diskriminimin e palës paditëse, bazuar në ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi", duke vendosur "Pranimin pjesërisht të padisë. - Detyrimin e të paditurve të shpërblejnë dëmin e shkaktuar paditësit si pasojë e zgjidhjes së kontratës së punës për shkaqe të pa arsyeshme, në masën e 4 (katër) pagave mujore. - Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër...". Ky vendim është ankimuar dhe aktualisht është në Gjykatën Administrative të Apelit.

62 Vendim Nr. 1620, datë 25.11.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Durrës.

63 Vendim Nr.1709, datë 09.12.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Durrës.

ÇËSHËTJA GJYQËSORE 5

KMD-ja ka paraqitur mendim me shkrim përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Durrës, në çështjen me palë ndërgjyqëse: Paditës: N.Sh; të Paditur: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Tiranë, dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Durrës; me objekt: "1. Shfuqizimi tërësisht i aktit administrativ, Vendimit nr. 364, dt. 30.12.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPSHTRR-së, Tiranë, 2. Detyrimi i palës së paditur të më kthejë në vendin e mëparshëm të punës 3. Detyrimi i palës së paditur të më dëmshpërblejë me pagën e një viti pune Për shkak të zgjidhjes të kontratës së marrëdhënies së punës, pa shkaqe të arsyeshme. 4. Detyrimi i palës së paditur të më shpërblejë me 1/2 e pagës mujore Për vjetërsi në punë Për periudhën e panjohur prej tyre".

Kjo çështje nuk ka qenë objekt shqyrtimi nga KMD-ja. Subjekti ankues i është drejtuar drejtpërdrejtë gjykatës kompetente, e cila ka thirrur KMD-në për parashtrimin e mendimit të tij me shkrim përpara gjykatës.

Lidhur me këtë çështje, Gjykata ka dalë me vendim,⁶⁴ në të cilin i është referuar dhe ka marrë në konsideratë mendimin e KMD-së, duke u shprehur mbi diskriminimin e palës paditëse, bazuar në ligjin "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", dhe duke vendosur, "Pranimin pjesërisht të padisë. Detyrimin e të paditurve, të shpërblejë dëmin e shkaktuar paditësit si pasojë e zgjidhjes së kontratës së punës për shkaqe të paarsyeshme, në masën e 6 (gjashtë) pagave mujore.- Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër..." Ky vendim është ankimuar dhe aktualisht është në Gjykatën Administrative të Apelit.

ÇËSHËTJA GJYQËSORE 6

KMD-ja ka dhënë mendim me shkrim përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Durrës, për çështjen me palë ndërgjyqëse: Paditës: J.N; të paditur: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Tiranë, dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Durrës; me objekt gjykimi: "1. Shfuqizimi tërësisht i aktit administrativ, Vendimit nr. 245, dt. 12.12.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPSHTRR-së, Tiranë, 2. Detyrimin e palës së paditur të më kthejë në vendin e mëparshëm të punës 3. Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë me pagesën e një viti pune Për shkak të zgjidhjes së kontratës së marrëdhënies së punës, pa shkaqe të arsyeshme (motiv abuziv), Neni 146/1/c".

Kjo çështje nuk ka qenë objekt shqyrtimi nga KMD-ja. Subjekti ankues i është drejtuar drejtpërdrejtë gjykatës kompetente, e cila ka thirrur KMD-në për parashtrimin e mendimit të tij me shkrim përpara gjykatës.

Lidhur me këtë çështje, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Durrës ka dalë me vendim⁶⁵ për "Rrëzimin e padisë", për shkak se është konsideruar nga kjo gjykatë si një gjë e gjykuar. Ky vendim është ankimuar dhe aktualisht është në Gjykatën Administrative të Apelit.

Nga çështjet gjyqësore të pasqyruara si më lart në pikën 3, 4, 5, 6, për të cilat KMD-ja ka parashtruar mendime me shkrim përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Durrës, **KMD-ja ka konstatuar se në vendimet e saj, gjykata nuk është shprehur në lidhje me diskriminimin, kjo për arsye se në objektet e kërkesë-padive nuk është kërkuar kon-**

64 Vendim Nr.1708, datë 09.12.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Durrës.

65 Vendimi Nr. 46, datë 21.01.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Durrës.

statimi i diskriminimit, bazuar në ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi", ndonëse ky ligj është vendosur si bazë ligjore ku mbështetet padia. Në këtë mënyrë, mendimi me shkrim i KMD-së (në të katër rastet) është vendosur vetëm në pjesën e arsyesimit të vendimit të gjykatës, i cili, pavarësisht se ka ndikuar në marrjen e vendimit gjyqësor për shkelje të dispozitave të Kodit të Punës, konkretisht nenit 146/1/c), nuk është vendosur në dispozitiv. Në këto kushte, vlerësojmë se:

- **kërkohet njohja dhe zbatimi i detyrimit ligjor nga ana e gjyqtarëve për njoftimin e KMD-së për çështjet me objekt diskriminimin;**
- **në hartimin e kërkesë-padive, avokatët duhet të vendosin në objekt kërkesën për konstatimin e diskriminimit, duke e referuar ligjin 1022/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" në bazën ligjore të kërkesë padisë".**

Vlerësojmë se kjo do të sillte zbatimin e duhur dhe efikas të këtij ligji edhe nga gjykatat.

II.1.2.2. KMD-ja si palë e paditur

Nga rastet kur KMD-ja ka konstatuar vendim diskriminimi, vërejmë se disa subjekte kanë ankimuar vendimet për diskriminim ose vendimet për vendosjen e sanksioneve me gjobë.

Nga vendimet e gjykatave administrative në lidhje me çështjet me objekt kundërshtimin e vendimit të KMD-së, konstatojmë se në përqindjen më të lartë të rasteve, gjykatat i kanë rrëzuar kërkesë paditë e palëve paditëse. Më poshtë pasqyrohen çështjet kur vendimet e KMD-së janë ankimuar në gjykatë:

ÇËSHËTJA GJYQËSORE 1

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka qenë i paditur në çështjen e administrative të gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me palë paditëse Korporata Elektroenergjitike Shqiptare, KESH sh.a dhe palë të paditur: Komisioneri Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me objekt: Shfuqizimi i Vendimit nr. 148, datë 26.09.2014 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; - Pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 148, datë 26.09.2014, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi deri në përfundimin e gjykimit.

Nëpërmjet vendimit nr. 148, datë 26.09.2014, në lidhje me këtë çështje, KMD-ja ka vendosur: 1. - Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a., të gjobitet në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë; 2. - Gjoha të derdhet në buxhetin e shtetit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja njoftim e këtij vendimi; 3. - Zbatimi i vendimit nr. 133, datë 22.08.2014, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi brenda shtatë ditëve nga marrja njoftim për sanksionet, sjell shfuqizimin e tij. - 4. Subjekti Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a., duhet të njoftojë Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përputhje me sa parashikohet në pikën 3 të këtij vendimi. - 5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.

Në fund të gjykimit, **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, ka vendosur rrëzimin e padisë së palës paditëse KESH sh.a.**

ÇËSHËTJA GJYQËSORE 2

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka qenë palë e paditur në çështjen administrative me palë paditëse: Subjekti Politik Aleanca Kuq e Zi, palë e paditur: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Palë e tretë: Shoqata "Aleanca kundër Diskriminimit LGBT", me objekt: "Sigurim padie lidhur me çështjen: 'Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ nr.1250, datë 01.08.2014, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi'". Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës për sigurim padie të subjektit politik, Aleanca Kuq e Zi.

ÇËSHËTJA GJYQËSORE 3

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka qenë palë e paditur në çështjen administrative me palë paditëse: Partia Aleanca Kuq e Zi; Person i Tretë: Edmond Themelko, Kryetar i Komunës Liqenas, me objekt: Shfuqizimi i aktit administrativ, vendimit nr. 75, datë 01.07.2013, "Për dënimin me gjobë", dalë në zbatim të vendimit nr. 28, datë 04.04.2013, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

KMD-ja me vendimin nr. 28, datë 04.04.2013, ka vendosur: "1. Konstatimin e diskriminimit të Komunës Liqenas, Korçë, ku banon komuniteti maqedonas, përmes qëndrimeve dhe deklaratave që nxisin diskriminim në gëzimin e të drejtave, që legjislacioni i brendshëm dhe aktet ndërkombëtare njohin dhe garantojnë për pakicat kombëtare. 2. Detyrimin e subjektit politik Aleanca Kuq e Zi, si subjekti që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të kërkojë falje publike dhe të evitohet në të ardhmen qëndrimet që nxisin dhunën apo forma të tjera të sjelljeve diskriminuese ndaj pakicave kombëtare".

Ky vendim nuk u zbatua nga subjekti politik Aleanca Kuq e Zi. Në zbatim të parashikimeve ligjore, KMD-ja me vendimin nr. 75, datë 01.07.2013, vendosi të gjobisë partinë politike Aleanca Kuq e Zi me 60 000 lekë.

Subjekti politik Aleanca Kuq e Zi ka kundërshtuar në gjykatë aktet e mësipërme të KMD-së. Në vijim të vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, lidhur me kompetencën e gjykatave në zbatim të ligjit nr. 49/2012, "Për funksionimin dhe organizimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", çështja kaloi për kompetencë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ku kishte filluar, tek Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Me vendimin e datës 13.05.2014, **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, vendosi rrëzimin e kërkesë-padisë së subjektit politik Aleanca Kuq e Zi, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.**

ÇËSHËTJA GJYQËSORE 4

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka qenë palë e paditur, në çështjen me palë paditëse, Spitali Rajonal Vlorë, me objekt: Kundërshtim i vendimit nr. 56, datë 17.04.2014, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

T.Rr. ka qenë në marrëdhënie pune pranë Spitalit Rajonal Vlorë dhe ishte larguar nga puna me pretendimin se nuk përmbushte kriterin arsimor dhe për mungesë të pa-arsyeshme nga puna. Paditësja ndërkohë kur ishte larguar nga puna ishte me raport mjekësor nga KMCAP dhe me vendim të KMCAP-së, ajo gëzonte statusin e invalidit. Me vendim gjyqësor, paditësja

kishte përfituar dëmshpërblimin në bazë të Kodit të Punës për mosrespektim të procedurës dhe afateve të zgjidhjes së kontratës së punës.

Më pas, T.Rr-ja ka paraqitur një ankesë për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore në marrëdhëniet e punës pranë KMD-së. KMD-ja ka konstatuar se T.Rr-ja është diskriminuar dhe është larguar nga puna për shkak të gjendjes së saj shëndetësore. Me vendimin nr.98, datë 09.10.2013, KMD-ja ka rekomanduar rikthimin e paditëses në vendin e saj të punës. Ky vendim nuk është zbatuar nga punëdhënësi dhe në këto kushte Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me vendimin nr.56, datë 17.04.2014, ka vendosur të gjobisë Spitalin Rajonal Vlorë në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë) mijë lekë.

Spitali Rajonal Vlorë e ka kundërshtuar këtë vendim në rrugë gjyqësore. Me vendimin nr. 5122, datë 25.09.2014, **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, vendosi të pranojë padinë dhe të anulojë vendimin me gjobë të KMD-së, me pretendimin se punëdhënësi nuk ka pasur mundësi të zbatojë vendimin e KMD-së. Kundër këtij vendimi, KMD-ja ka bërë ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.**

ÇËSHËTJA GJYQËSORE 5

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka qenë palë e paditur në çështjen administrative me palë paditëse: Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme Tiranë, me objekt anulimin e vendimit nr.54, dt.17.04.2014, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në të cilin KMD-ja vendosi se zonja H.H. është diskriminuar në formën e shoqërimit.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, vendosi rrëzimin e kërkesë padisë së ngritur nga Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme, Tiranë. Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme, Tiranë, e ka ankimuar vendimin në Gjykatën Administrative të Apelit.

ÇËSHËTJA GJYQËSORE 6

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë pjesë si palë e paditur në çështjen administrative me palë paditëse: K.Sh., të paditur: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Shërbimi Kombëtar i Punësimit etj., në çështjen me objekt: "Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ nr.10, datë 30.04.2012, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi", në të cilin është vendosur konstatimi i mosdiskriminimit të zonës K.SH. për shkak të statusit shoqëror. **Gjykata mori vendim për kthimin e akteve.**

II.1.2.3 KMD-ja si person i tretë

ÇËSHËTJA GJYQËSORE 1

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë pjesë në cilësinë e personit të tretë, në gjykimin e çështjes civile me palë paditëse - L.H.; palë e paditur - Shoqëria "Albpetrol" sh.a. Patos, Fier dhe me objekt gjykimin - "Detyrimin e palës së paditur Albpetrol sh.a. Patos, për t'i dëmshpërbyer paditësit L.H për konstatim diskriminimi për shkaqe politike, dëmin moral dhe dëmin jashtëkontraktor të shkaktuar padrejtësisht nga kjo shoqëri". Paditësi nuk ka paraqitur ankese paraprakisht pranë Komisionerit për çështjen në fjalë. **Çështja në gjykim është në proces.**

ÇËSHËTJA GJYQËSORE 2

KMD-ja ka qenë person i tretë në çështjen me palë paditëse: F.K., dhe palë e paditur: Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë, Fier.

Paditësja F.K. kishte paraqitur fillimisht një ankesë pranë Komisionerit me pretendimin se kishte qenë viktimë e diskriminimit nga punëdhënësi, Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë, Fier, për shkak se ajo kishte ushtruar një të drejtë të saj duke denoncuar veprime në kundërshtim me ligjin, të kryera nga punëdhënësi i saj. Si rrjedhojë e ankesave dhe denoncimeve që kishte bërë ndaj punëdhënësit, ankuesja F.K. ishte diskriminuar në mënyrë të vazhdueshme, deri në largimin e saj nga puna. Pas një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm administrativ, Komisioneri, me vendimin nr. 13, datë 30.07.2012, vendosi konstatimin e diskriminimit ndaj ankuses F.K. dhe rekomandoi rikthimin e saj në punë. Ky rekomandim i Komisionerit nuk u zbatua nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë, Fier dhe për rrjedhojë, në bazë të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Komisioneri me vendimin Nr. 21, datë 08.11.2012, e dënoi me gjobë Drejtorinë Rajonale të Shëndetësisë, Fier, për moszbatimin e vendimit.

Pas shqyrtimit administrativ nga Komisioneri, ankuesja e bëri objekt të shqyrtimit gjyqësor pretendimin e saj për largimin nga puna për shkaqe diskriminuese. Me kërkesën e ankuses, viktimë e diskriminimit, Komisioneri ofroi asistencë ligjore për hartimin e padisë dhe njëkohësisht e mbështeti atë me të gjithë dokumentacionin e grumbulluar gjatë procesit administrativ.

Komisioneri ndoqi të gjithë procesin gjyqësor, si palë e interesuar në gjykim, i thirrur nga paditësja. Në datë 04.06.2013, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier, vendosi: - konstatimin e faktit të diskriminimit dhe të viktimizimit të paditëses F.K., nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë, Fier. Në bazë të nenit 37 të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi", ku parashikohet dëmshpërblimi në rastet e konstatimit të diskriminimit dhe të shkeljes së ligjit, ajo vendosi: - ndreqjen e pasojave të ardhura si rezultat i sjelljes diskriminuese, duke urdhëruar rikthimin e paditëses në vendin e saj të mëparshëm të punës, si dhe dëmshpërblimin për dëmin pasuror dhe atë jo-pasuror të pësuar nga paditësja.**

Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier, u ankimua nga Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë, Fier, në Gjykatën e Apelit, Vlorë. Gjykata e Apelit, Vlorë, në datë 20 shkurt 2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier, si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

II.1.2.4 Proceset gjyqësore për ekzekutimin e gjobave

Për vendimet me gjoba, të cilat nuk janë animuar, apo për ato vendime të cilat janë ankimuar dhe vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë, KMD-ja ka filluar procesin e ekzekutimit të gjobave, duke kërkuar fillimisht lëshimin e urdhrave të ekzekutimit.

Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi" nuk ka parashikuar se vendimi me gjobë i KMD-së është titull ekzekutiv. Për të kërkuar përpara gjykatës lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit për vendimet me gjobë, KMD-ja ka arsyetuar përpara gjykatës së, edhe në mungesë të një parashikimi të drejtpërdrejtë nga Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vendimet me gjobë të KMD-së gjejnë zbatim parashikimet e ligjit "Për kundërvajtjet administrative".

KMD-ja i është drejtuar gjykatave kompetente në 3 raste me kërkesa Për lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit për gjobat e vëna prej tij.

ÇËSHËTJA GJYQËSORE 1

Me vendimin nr. 57, datë 08.05.2013, KMD-ja ka konstatuar se deklaratat e shprehura nga z. E.S., Kryetar i Partisë Lëvizja e Legalitetit dhe (ish) Zëvendësministër i Mbrojtjes gjatë një debati televiziv, përbënin gjuhë urrejtje ndaj komunitetit LGBT. **KMD-ja i ka rekomanduar z. E.S. që publikisht t'i tërheqë këto deklaratat dhe të kërkojë falje publike si edhe të mos i përsërisë në të ardhmen. Ky vendim i KMD-së nuk u zbatua.** Në zbatim të procedurave ligjore, me vendimin nr. 73, datë 28.06.2013, KMD-ja ka gjobitur z. E.S., Kryetar i Partisë Lëvizja e Legalitetit dhe (ish) Zëvendësministër i Mbrojtjes me 20.000 lekë. Ky vendim nuk është ankimuar dhe KMD-ja ka filluar procedurat e ekzekutimit, duke kërkuar përpara Gjykatës lëshimin e urdhrit të ekzekutimit.

Me vendimin nr. 819, datë 02.07.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, është vendosur lëshimi i urdhrit të ekzekutimit për vendimin nr. 73, datë 28.06.2013, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

ÇËSHËTJA GJYQËSORE 2

Me vendimin nr. 58, datë 08.05.2013, KMD-ja ka konstatuar se një shkrim i z. A.L., analist dhe përfaqësues i një subjekti politik, botuar në një gazetë të përditshme, drejtuar komunitetit LGBT, përbënte gjuhë urrejtje dhe ishte diskriminues ndaj këtij komuniteti. **KMD-ja i ka rekomanduar z. A. L. që të tërheqë këto deklaratat publikisht dhe të kërkojë ndjesë publike, si edhe të mos e përsërisë në të ardhmen. Ky vendim i KMD-së nuk u zbatua.** Në zbatim të procedurave ligjore me vendimin nr. 74, datë 28.06.2013, KMD-ja ka gjobitur z. A.L., me gjobë në vlerën 10 000 lekë. Ky vendim nuk është ankimuar dhe KMD-ja ka filluar procedurat e ekzekutimit, duke kërkuar përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, lëshimin e urdhrit të ekzekutimit.

Me vendimin e datës 18.07.2014, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, ka vendosur: Kthimin e kërkesës së paraqitur nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi adresa e KMD-së nuk ishte e saktë. Theksojmë se, e njëjta adresë (përfshirë shumë mënyra komunikimi si adresa, Kodi Postar, numër telefoni/faksi dhe e-mail) i është komunikuar kësaj gjykate edhe në kërkesën tjetër për të cilën është lëshuar urdhri i ekzekutimit, me vendimin nr. 819, datë 02.07.2014. Në të njëjtën adresë, gjykata ka njoftuar KMD-në edhe për procese të tjera gjyqësore. Vendimi për kthimin e kërkesës është ankimuar në Gjykatën e Apelit Administrativ, Tiranë, nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

ÇËSHËTJA GJYQËSORE 3

Me vendimin nr. 21, datë 08.11.2012, KMD-ja ka konstatuar shkelje të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", dhe ka vendosur: Konstatimin e diskriminimit të F. K. nga punëdhënësi i saj Drejtoria Rajonale Shëndetësore, Fier, pasi largimi i saj nga puna ishte bërë për shkaqe diskriminuese. KMD-ja rekomandoi kthimin e F.K. në vendin e punës. Ky vendim nuk u zbatua nga ana e punëdhënësit. Në zbatim të procedurave ligjore, KMD-ja vendosi të gjobisë DRSH, Fier, me 60 000 lekë gjobë. Ky vendim u ankimua nga ana e DRSH, Fier, por nuk pati një vendim përfundimtar, pasi gjykimi u pushua për mosparaqitje të paditësit. Vendimi i pushimit nuk u ankimua dhe mori formë të prerë. KMD-ja filloi procedurën për ekzekutimin e vendimit me gjobë, duke kërkuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit.

Me vendimin nr. 1132, datë 14.10.2014, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë vendosi lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit për vendimin nr. 21, datë 08.11.2012, të KMD-së.

II.2. Rekomandime legjislative dhe rekomandime të tjera për çështje diskriminimi

II.2.1. Rekomandime Legjislative

Në zbatim të kompetencës ligjore të parashikuar në nenin 32, pika 1, germa “ë”, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku thuhet se: “Komisioneri ka kompetencë t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos për të propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dërguar rekomandime legjislative, me qëllim përafrimin e legjislacionit ekzistues me konceptet, parashikimet dhe standardet e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Në këtë aspekt, Komisioneri ka synuar përafrimin legjislativ, kryesisht në lidhje me:

- shkaqet e diskriminimit për të cilat këto ligje ofrojnë mbrojtje;
- format e diskriminimit;
- shpërndarjen e barrës së provës.

Tabela e mëposhtme tregon numrin e rekomandimeve legjislative të KMD-së me qëllim përafrimin e legjislacionit të brendshëm me ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”:

Viti	Numri i rekomandimeve legjislative
2012	4
2013	2
2014	7

Tabela Nr. 11: Numri i rekomandimeve legjislative të KMD-së për 2012-2014

Nëpërmjet **Rekomandimeve për Kodin Penal**, dërguar në maj 2013, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka vlerësuar përfshirjen si rrethana rënduese, në nenin 50/j, edhe të shkaqeve të tjera të diskriminimit, siç janë parashikuar në ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”; ai ka rekomanduar: - të shtohet një nen, me qëllim parashikimin si figurë të veçantë veprë penale, të kanosjes për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të personit; - të kriminalizohet shpërndarja e materialeve homofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik dhe fyerja nëpërmjet sistemit kompjuterik, për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të personit; - të shtohet një nen për të kriminalizuar nxitjen e urrejtjes për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor; - të riformulohet në mënyrë që të përfshihen edhe shkaqe të tjera të parashikuara nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, duke përfshirë këtu orientimin seksual dhe identitetin gjinor të personit, për të garantuar një mbrojtje më të gjerë të personave ndaj shkaqeve diskriminuese, për të cilat një punonjës me funksion shtetëror apo në shërbim publik mund të bëjë dallime ndaj shtetasve, duke shkelur në këtë mënyrë parimin e barazisë.

Nga pesë rekomandimet e dërguara, dy janë marrë plotësisht parasysh, një pjesërisht, dhe dy të tjera nuk janë marrë parasysh. Për këtë arsye, me shkresën nr. 295 Prot, datë

10.03.2014, KMD-ja ia ka ridërguar rekomandimet me status të pazbatuar Ministrisë së Drejtësisë.

Përveç tyre, KMD-ja ka rekomanduar gjithashtu zëvendësimin e termit “marrëdhënie homoseksuale” me termin “marrëdhënie seksuale”, term që përmendet në Seksionin VI dhe në përmbajtje të neneve 100 deri 107 të Kodit Penal.⁶⁶

Në **Rekomandimet legjislative për ndryshime në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë**, KMD-ja ka synuar kryesisht që shkaqet e mbrojtura nga diskriminimi të jenë në harmoni me parashikimet e nenit 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”; të shtohet pjesëmarrja e grave në Kuvend dhe në organet e pushtetit vendor, si dhe të rriten sanksionet për moszbatimin e kuotës gjinore si për zgjedhjet për Kuvendin, ashtu dhe për organet e pushtetit vendor. KMD-ja ka rekomanduar që emërtimi i nenit 108 të Kodit Zgjedhor të ndryshohet nga “Zgjedhësit që nuk votojnë vetë” në “Zgjedhësit me aftësi të kufizuara”, me qëllim ndryshimin e perceptimit që shoqëria ka për personat me aftësi të kufizuara. KMD-ja ka rekomanduar që t’i jepet përparësi gjetjes së një zgjidhjeje ligjore për garantimin e të drejtën e votës për zgjedhësit që nuk dalin dot nga shtëpia për të qenë të pranishëm në qendrat e votimit.

Në **Rekomandimet legjislative për ndryshime në Kodin e Transmetimit**, KMD-ja ka rekomanduar që Transmetimet Audiovizive të të gjitha llojeve, të respektojnë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit për çdo shkak të mbrojtur nga legjislacioni shqiptar; që shkaqet e diskriminimit të jenë në përputhje me nenin 1 të ligjit nr.10, 221/2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku parashikohet një listë jo shteruese e shkaqeve. Lidhur me parashikimet për fëmijët në transmetimet audiovizive, KMD-ja ka rekomanduar që në programet kulturore e argëtuese për fëmijët të mos përdoren terma të cilat nxisin qëndrime paragjyquese. Lidhur me parashikimet për personat me aftësi të kufizuara në transmetimet audiovizive, të garantohet që shërbimet e tyre të jenë të aksesueshme nga ky grup, si dhe të nxitet promovimi i arritjeve të personave me aftësi të kufizuara. Lidhur me reklamën, duhen ndaluar publikimi i reklamave, nëse ato paraqesin, haptazi apo në mënyrë të nënkuptuar, qëllime diskriminuese, për shkaqe të mbrojtura nga legjislacioni shqiptar.

Në **Rekomandimet legjislative për ndryshime në Kodin e Familjes të Republikës së Shqipërisë**, KMD-ja ka marrë pjesë në grupin e punës së ngritur nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, me qëllim amendimin e këtij Kodi, në të cilin ka paraqitur rekomandimet e tij, të cilat synojnë përafrimin me ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, kryesisht në lidhje me bashkëjetesën.

Në **Rekomandimet për ligjin nr. 9355/2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”**, KMD-ja ka paraqitur rekomandime të cilat synojnë që të eliminohet krijimi i preferencave me bazë gjinore dhe moshe, apo me çdo bazë tjetër. Mënyra se si është formuluar pika 10 e nenit 4, vjen në kundërshtim me parimin e barazisë, pasi përcakton një radhë preferenciale bazuar në moshën e individit, duke u dhënë përparësi individëve më të mëdhenj në grup-moshën 18-65 vjeç, dhe individëve më të rinj në grup-moshën mbi 65 vjeç.

Në **Rekomandimet për Projekt-Kodin e Procedurës Administrative**, dërguar në dhjetor 2013, KMD-ja ka rekomanduar shtimin e një neni të veçantë, ku të formulohet parimi i bara-

⁶⁶ Për informacion më të detajuar, referojuni tabelës në pikën “II.4.12. Fuqia dhe ndjekja e rekomandimeve legjislative të KMD-së”.

zisë dhe mosdiskriminimit, si parime të rëndësishme që duhet të udhëheqin veprimtarinë e çdo organi publik apo subjekti privat që ushtron funksione publike; shkaqet e mbrojtura nga diskriminimi duhet të jenë në harmoni me parashikimet e nenit 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi"; riformulimin e neneve që parashikojnë barrën e provës midis palëve në një procedim administrativ, me qëllim parashikimin e shpërndarjes së barrës së provës për rastet kur kemi të bëjmë me një pretendim diskriminimi. KMD-ja ia ka ridërguar këto rekomandime në vitin 2014 Kuvendit të Shqipërisë, me kërkesën e tij.

Për t'u njohur më hollësisht me rekomandimet legjislativë të KMD-së në mbështetje të këtyre rekomandimeve, referojuni Shtojcës 2 të këtij Raporti.

II.2.2. Rekomandime të tjera për çështje diskriminimi

1 Me shkresën me nr. 554 Prot., datë 04.06.2014, KMD-ja ka dërguar "**Rekomandim për rishikimin e kontratës tip mbi 'Kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë'**", drejtuar z. Petrit Ahmeti, Kryetar i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë – ERE. Në mbështetje të nenit 1, të Ligjit nr. 10221/2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", që parashikon shkaqet e diskriminimit dhe në objektin e ligjit për garantimin e parimit të barazisë gjinore, nenit 20 që ndalon diskriminimin në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, dhe nenit 32, pika 1, germa (f), ku parashikohet se "*Komisioneri ka kompetencë që të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin*", KMD-ja ka rekomanduar: - *Rishikimin e kontratës tip mbi "Kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë", duke parashikuar përkufizimin e "klientit familjar", dispozita të qarta në përcaktimin e subjekteve të përfshihen në përkufizimin e "klientit", si dhe detyrimin për respektimin e tyre; të rregullohet liria e "klientit", si titullar i kontratës, për pezullimin/ndërprerjen e saj, me qëllim që të mos mohohet e drejta e furnizimit me energji elektrike e anëtarëve të familjes, për shkak të vullnetit abuziv të titullarit të kontratës; të mbahet parasysh rishikimi i akteve ligjore dhe nënligjore si dhe praktikave të deritanishme, me qëllim që ato të përputhen me parimin e barazisë gjinore dhe të mosdiskriminimit, të sanksionuara në legjislacionin kombëtar në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.*

Theksojmë se, në këtë rekomandim, KMD-ja është referuar në standardet ndërkombëtare, si në Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut, neni 25; Paktin për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, neni 10, 11 dhe 12; Komentin e Përgjithshëm 4 të Komitetit të OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore; Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Protokolli 12, neni 1; Konventën e OKB për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave – CEDAW, nenet 2,14,15 dhe 16 si edhe në Kartën Sociale Europiane (të rishikuar).

2 Me shkresën me nr. 757 Prot, datë 11.09.2014, me lëndë "**Dërgohen rekomandime për marrjen e masave për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim në fillim të vitit shkollor 2014-2015 në sistemin arsimor para-universitar**", drejtuar Znj. Lindita Nikolla, Ministre e Arsimit dhe Sportit, KMD-ja ka paraqitur rekomandime për parandalimin dhe luftën ndaj diskriminimit në arsim. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ndjekur në vazhdimësi situatën në sistemin arsimor para-universitar

dhe me një ndjeshmëri akoma më të madhe në fillimin e çdo viti shkollor.

Gjatë veprimtarisë së tij, KMD-ja ka identifikuar problematika të ndryshme me të cilat përballen grupe dhe kategori nxënësish, si ata romë dhe egjiptianë, LGBT, me aftësi të kufizuara, fëmijët që për shkak të gjakmarrjes nuk mund të arsimohen, apo ata nxënës që, për shkak të kushteve të vështira ekonomike apo vendbanimit, përballen me vështirësi, deri në pamundësi për t'u arsimuar. KMD-ja ka ngritur shqetësimin se, megjithëse ekzistojnë ligje dhe akte nënligjore, politika dhe strategji, ku parashikohen detyrime për të gjithë institucionet e përfshira në procesin e arsimimit, në disa raste, janë konstatuar situata diskriminuese, të cilat kanë ardhur si rezultat i mosnjohjes së kuadrit ligjor në fuqi dhe për rrjedhojë e moszbatimit, ose e keqzbatimit të tij.

KMD-ja ka vënë theksin tek nevoja për një zbatim efektiv të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor para-universitar në Republikën e Shqipërisë", akteve nënligjore, masave dhe planeve të veprimit, me qëllim garantimin e kujdesit të posaçëm të shtetit ndaj kategorive të veçanta të nxënësve dhe mbrojtjen e tyre nga diskriminimi në arsim.

Sa më sipër, institucioni i Komisionerit, në përmbushje të qëllimit të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efikase nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, dhe bazuar në kompetencën që i jepet nga shkronja "f", e pikës 1, të nenit 32 të këtij ligji, për të bërë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin, ka rekomanduar:

- Nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 18, të ligjit "Për Mbrojtjen nga diskriminimi". KMD-ja ka kërkuar informacion lidhur me hapat e ndërmarrja nga grupi ndërinstitucional i punës, i cili kryesohet nga Ministria e Arsimit, i ngritur në bazë të urdhrit të Kryeministrit nr. 52, datë 23.04.2012 "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e akteve nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, 'Për mbrojtjen nga diskriminimi'", lidhur me hartimin e këtyre akteve nënligjore.
- Amendimin e rregullores tip të institucionit arsimor para-universitar, me qëllim përcaktimin e një procedure për shqyrtimin e ankesave për diskriminim në sistemin arsimor. Duke qenë se në përmbajtjen e Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 30 datë 02.08.2013, "Për rregulloren tip të institucioneve arsimore", nuk ka parashikime lidhur me shqyrtimin e ankesave për diskriminim, që mund të paraqiten si nga nxënësit ashtu edhe nga ana e mësuesve, është rekomanduar që udhëzimi nr. 30, datë 02.08.2013, "Për rregulloren tip të institucioneve arsimore", të amendohet me qëllim që të përfshihen në rregulloren tip të institucioneve arsimore, parashikime për mënyrën e shqyrtimit të ankesave për diskriminim.
- Ndërgjegjësimin në lidhje me ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi". KMD-ja ka rekomanduar që të ndërmerret një fushatë kombëtare për të rritur ndërgjegjësimin në të gjitha institucionet e arsimit para-universitar për detyrimet që burojnë nga ligji për mbrojtjen nga diskriminimi si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, si përmbushje e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga neni 18 i ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi". KMD-ja ka rekomanduar që të merren masat e duhura për të vënë në dispozicion të DAR/ZA-ve, së bashku me bazën ligjore që është përfshirë në udhëzimin

nr. 23, datë 08.08.2014, edhe të një kopje të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Gjithashtu është rekomanduar nga KMD-ja që, në vazhdim, ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” të bëhet pjesë e bazës ligjore që listohet në udhëzimin e ministrit për çdo fillim viti shkollor. Gjithashtu, KMD-ja ka rekomanduar që në mënyrë të veçantë DAR/ZA-të të kujdesen që në të gjitha institucionet arsimore të afishojnë në një vend të dukshëm një kopje të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si një detyrim që rrjedh nga neni 19, germa “a” e ligjit.

- Pjesë e rëndësishme e këtij rekomandimi janë çështje të regjistrimit, shpërndarjes dhe frekuentimit të shkollave, lidhur me fëmijët romë dhe egjiptianë. Në këtë kuadër për vitin shkollor 2014-2015, është kërkuar zbatimi me efikasitet dhe monitorimi nga ana e Drejtorive Arsimore Rajonale i të gjithë kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi, strategjive dhe politikave, për të bërë të mundur regjistrimin e fëmijëve romë/egjiptian në vitin e ri shkollor. Në këtë rekomandim theksi i është vënë detyrimit ligjor që regjistrimi i tyre të bëhet pranë njësive vendore ku ata banojnë, pavarësisht nëse ata janë të regjistruar apo jo në gjendjen civile të asaj njësie, apo edhe në rastet kur ata nuk janë të regjistruar në gjendje civile. Edhe përmes këtij rekomandimi është kërkuar që në asnjë rast të mos refuzohet regjistrimi i një fëmije që ka mbushur moshën e detyrueshme të ndjekjes së shkollës.
- Në zbatim të detyrimeve që dalin edhe nga Plani Kombëtar i Veprimit të Dekadës së Përfshirjes Rome, 2010-2015, KMD-ja ka rekomanduar që DAR/ZA-të të zbatojnë dhe monitorojnë të gjitha masat e përcaktuara për të evidentuar numrin e fëmijëve romë, në të gjitha nivelet e sistemit arsimor para-universitar, sipas largësisë së qendrës së banimit me shkollën dhe të bëjnë propozimet pranë institucioneve përgjegjëse për sigurimin e transportit falas për këta fëmijë.
- KMD-ja ka rekomanduar që DAR/ZA-të të ndjekin në vazhdimësi frekuentimin e shkollës nga ana e fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian, si dhe ndryshimin e raportit mes nxënësve që u përkasin këtyre komuniteteve dhe atyre që nuk u përkasin, në shkollat që kanë numër më të madh të fëmijëve të komunitetit rom/egjiptian, për të parandaluar në këtë mënyrë krijimin e zonave apo shkollave, që frekuentohen vetëm nga fëmijë të komunitetit rom/egjiptian. Një kujdes i posaçëm duhet të tregohet gjatë krijimit të klasave të para apo në rastet e ristrukturimit të klasave, për të shmangur veçimin apo ndarjen e fëmijëve romë në klasa të caktuara, duke krijuar në këtë mënyrë klasa vetëm me fëmijë romë.
- Në lidhje me subvencionimin e teksteve shkollore, KMD-ja ka rekomanduar ndjekjen dhe monitorimin me prioritet të të gjithë procesit për subvencionimin e teksteve shkollore, për të gjithë kategoritë e fëmijëve që përfitojnë subvencionimin e teksteve shkollore, për të garantuar pajisjen e të gjithë nxënësve me tekstet shkollore dhe për të parandaluar në këtë mënyrë krijimin e situatave diskriminuese për këto kategori nxënësish, të cilët do të gjendeshin në pamundësi për t’u pajisur me tekstet shkollore.
- KMD-ja ka rekomanduar krijimin dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinare për vlerësimin e nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuara. Në lidhje me garantimin e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, KMD-ja ka rekomanduar se duhet të mbahet në vëmendje edhe detyrimi për të ndërmarrë masat e duhura (modifikime apo ndryshime) për të realizuar përshtatjet e arsyeshme, qoftë infrastrukturore, qoftë masa të tjera në procedura apo orare, sa herë që do të jetë e domosdoshme. KMD-ja ka sjellë në vëmendje se mohimi i përshtatjes së arsyeshme përbën diskriminim sipas nenit 3, pika 7, të ligjit ‘Për mbrojtjen nga diskriminimi’.

- KMD-ja ka rekomanduar marrjen e masave nga drejtuesit e institucioneve arsimore për të parandaluar dhe luftuar diskriminimin në shkolla. KMD-ja i ka rekomanduar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit që të udhëzojë në mënyrë të posaçme DAR/ZA-të të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme masat e marra nga drejtuesit e institucioneve arsimore për të parandaluar dhe luftuar diskriminimin në shkolla, dhe mënyrën e trajtimit të sjelljeve dhe qëndrimeve homofobike, stigmatizuese ndaj nxënësve që i përkasin komunitetit LGBT, nxënësve të përkatësisë rome dhe egjiptiane, nxënësve me aftësi të kufizuara, dhe të tjerëve, si dhe mënyrën e trajtimit të ankesave për diskriminim nga ana e drejtuesve të institucioneve arsimore, një detyrim ky i parashikuar nga neni 19, germa “ç”, e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

3 Me shkresën me nr. 112 Prot, datë 31.01.2014, me lëndë: “Dërgohet rekomandim Për lehtësimin e procedurave për përfitimin e statusit të invalidit dhe zgjerimin e listës së barnave të rimbursueshme”, drejtuar z. Ilir Beqaj, Ministër, Ministria e Shëndetësisë dhe z. Astrit Beci, Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, KMD-ja ka rekomanduar lehtësimin e procedurave për përfitimin e statusit të invalidit dhe zgjerimin e listës së barnave të rimbursueshme. Në ditët e hapura dhe takimet e organizuara nga KMD-ja me OJF-të në qytete të ndryshme të Shqipërisë, KMD-ja është njohur me problematikat e ndryshme me të cilat përballet komuniteti në rajone të ndryshme. Dy nga problemet e identifikuar në qytetin e Lezhës ishin: pengesat dhe vështirësitë gjatë zbatimit të procedurës për përfitimin e statusit të invalidit; personat me aftësi të kufizuara e kanë të pamundur përbalimin e shpenzimeve për barnat, të cilat nuk bëjnë pjesë në listën e barnave që rimbursohen. KMD-ja ka vlerësuar se rimbursimi i barnave është një nevojë e domosdoshme Për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, duke qenë se ata nuk i përballojnë dot nevojat me imediate të jetesës së përditshme. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 32, pika 1, germa f, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në të cilin përcaktohet kompetenca e KMD-së për të bërë rekomandime për çfarëdo lloji çështjeje që lidhet me diskriminimin”, si dhe me qëllim përmirësimit të jetesës dhe garantimit të parimit të barazisë dhe mbrojtjen e efikasitetit të personave me aftësi të kufizuara nga diskriminimi, KMD-ja ka rekomanduar: - të mbahet parasysh zbatimi me korrektësi i procedurave për përfitimin e statusit të invalidit si edhe rishikimi i listës së barnave të rimbursueshme Për vitin 2014, me synim zgjerimin e kësaj liste me barna të rinj, të cilët duhet të jenë realisht të efektshëm dhe në proporcion me nevojat e personave me aftësi të kufizuara, sipas kategorive të përcaktuara në ligj.

4 Në shkurt 2014, KMD-ja i ka dërguar rekomandim Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për zgjidhjen e situatës emergjente të mungesës së medikamenteve mjekësore pranë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimit Penal (IEVP) në Peqin.

II.3. Ndërgjegjësimi

Rritja e ndërgjegjësit të opinionit publik është një nga veprimtaritë themelore të KMD-së, e parashikuar nëpërmjet një serë kompetencash për këtë qëllim, si - nxitja e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar opinionin për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara për këtë ligj në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuara; - adresimi drejtpërdrejt i opinionit publik për çfarëdo lloji çështjeje që lidhet me diskriminimin;

- informimi rreth të drejtës së mbrojtjes nga diskriminimi dhe rreth mjeteve ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje; - zhvillimi i dialogut të rregullt për çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare dhe zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjëse dhe edukuese që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.

Në zbatim të Planit Strategjik 2012-2015, KMD-ja ka përcaktuar si prioritet strategjik **rritjen e ndërgjegjësimin të opinionit publik për mbrojtjen nga diskriminimi dhe për rolin e KMD-së në këtë fushë**. Që nga krijimi i tij, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në zbatim të kompetencave të parashikuara nga ligji *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, me synim rritjen e sensibilizimit dhe lehtësimin e aksesit të qytetarëve për t’iu drejtuar zyrës, ka kryer një sërë veprimtarish, të cilat do t’i parashtrijmë më poshtë. Megjithatë, KMD-ja konstaton se ka ende nevojë për rritjen e ndërgjegjësimin të opinionit publik dhe të grupeve të dobëta në lidhje me mbrojtjen nga diskriminimi dhe mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje.

II.3.1. Hartimi, publikimi dhe shpërndarja e materialeve ndërgjegjëse dhe manualeve trajnuese

Gjatë vitit 2014, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka hartuar, publikuar dhe shpërndarë një sërë materialesh informuese dhe ndërgjegjëse, nga ku listojmë:

Broshura Informativ *“Mbrojtja e pakicave në Shqipëri sipas ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi”*.⁶⁷ Kjo broshurë është përgatitur në shqip, romisht dhe anglisht, nga të cilat në shqip janë botuar 1000 kopje. Botimi i kësaj broshure është bërë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me mbështetjen e Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR). Botimi është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian, në kuadër të projektit *“Praktikat më të mira në integrimin e romëve”*, zbatuar nga ODIHR.

Botimi me përkthime *“Përmbledhje të vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian, Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Organeve të Barazisë”*.⁶⁸ Ky botim është realizuar me mbështetjen e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri dhe Qeverisë Suedeze, në zbatim të Projektit *“Zbatimi i parimit të barazisë gjinore dhe programit të dhunës me bazë gjinore”*. Kjo përmbledhje është botuar në 1000 kopje. Ky botim iu shpërnda fillimisht të gjitha Gjykatave të Shkallës së Parë të Shqipërisë, Gjykatave të Apelit, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Universiteteve publike e private dhe OJF-ve që mbrojnë të drejtat e njeriut.

Manuali *“Mbrojtja nga diskriminimi - Manual trajnimi për OJF-të”*,⁶⁹ realizuar në kuadër të projektit *“Së bashku për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave të diskriminuar”*, u përgatit nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, me mbështetjen financiare të Zyrës së Kooperacionit Zviceran në Shqipëri. Ky manual është botuar në 1500 kopje dhe gjendet në gjuhën shqipe.

⁶⁷ Gjenden në linkun e mëposhtëm: <http://kmd.al/?fq=brenda&qj=gj1&kid=204>

<http://kmd.al/skedaret/1392134886-brosh%20OSCE%20ang.pdf>

⁶⁸ Botimi gjendet në gjuhën shqipe në linkun më poshtë: <http://kmd.al/skedaret/1409565567-kmd%20final.pdf>

⁶⁹ Botimi mund të gjendet në gjuhën shqipe në linkun më poshtë: <http://kmd.al/skedaret/1393424101-Manuali%20i%20Trajnimit.pdf>

Manuali *“Për mbrojtjen nga diskriminimi i Pakicave etnike të marginalizuara”*, u realizua në kuadër të projektit SSIREC.

Broshura *“Raporto Diskriminimi”*, e realizuar në kuadër të projektit SSIREC, në 1000 kopje.

Një *“Përmbledhje e vendimeve të KMD-së dhe opinioneve të Bordit të Ekspertëve”*, realizuar në anglisht dhe shqip në 800 kopje.

Botimi *“Guida burimore për mbrojtjen nga diskriminimi gjinor në sektorin ekonomik”*. Ky botim është prezantuar në seminarin *“Mundësi të barabarta në sektorin ekonomik”*, organizuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me mbështetjen e UN Women dhe në bashkëpunim me Bashkimin Kombëtar të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë (NUCCI) dhe Shoqatën Kristiane të Grave Shqiptare (YWCA). Botimi i parë (2012) është përditësuar dhe ribotuar në vitin 2014.

Fletëpalosja *“Fletë informuese për zyrtarët publikë mbi çështjet LGBT”*⁷⁰, botuar në bashkëpunim me institucione shtetërore dhe Pink Embassy, që është shpërndarë në aktivitete të ndryshme.

KMD-ja ka hartuar një *“Komentar mbi ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”* në dhjetor 2014.

Një broshurë informuese *“Mbi punësimin në sektorin publik dhe privat”* hartuar nga KMD-ja.

Një broshurë informuese *“Mbi ofrimin e të mirave dhe shërbimeve”* hartuar nga KMD-ka.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2014, KMD-ja ka shpërndarë 100 fletëpalosje në qendrat shëndetësore të qytetit të Tiranës,.

Janë shpërndarë rreth 3000 fletëpalosje informuese mbi ligjin *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”* në Qarkun e Tiranës në bashkëpunim me Postën Shqiptare. Shpërndarja e materialeve informuese do të vazhdojë në zonat e tjera, duke përfshirë edhe zonat rurale.

II.3.2. Organizimi i trajnimeve dhe konferencave nga KMD-ja

Trajnime të realizuara nga KMD-ja për grupe të ndryshme

Janë organizuar pesë trajnime për gjyqtarët e Gjykatave të Shkallës së Parë për ligjin *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*. Konkretisht, janë organizuar trajnime me të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Berat, Elbasan, Vlorë dhe Shkodër gjatë periudhës prill-tetor 2014. Këto trajnime janë organizuar nga KMD-ja dhe Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, mbështetur nga Ambasada Holandeze në Tiranë.

⁷⁰ Ky botim mund të gjendet në linkun: <http://kmd.al/skedaret/1392136411-FLETE%20PALOSJE%20PERPARA%20.pdf>

Janë realizuar katër trajnime të punonjësve të institucioneve vendore, në kuadrin e projektit, *"Mbështetje për përfshirjen sociale të komuniteteve rome dhe egjiptiane"*. Trajnimet janë organizuar gjatë periudhës janar - shkurt 2014, në Korçë, Berat, dhe Vlorë. Janë trajnuar në total 180 punonjës të institucioneve vendore. Komisionerja për Mbrojtjen nga Diskriminimi në prezantimin e saj në trajnim u ndal te çështjet: kuptimi i diskriminimit, mekanizmat ligjorë për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, si edhe legjislacioni ndërkombëtar dhe kombëtar mbi barrën e provës.

Janë organizuar tre trajnime gjatë vitit 2014 me përfaqësues të OJF-ve që mbrojnë të drejtat e njeriut, në kuadër të projektit *"Së bashku për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave të diskriminuar"*, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit në partneritet me KMD-në, me mbështetjen financiare të Zyrës së Kooperacionit Zviceran në Shqipëri. Pjesëmarrësit në këto aktivitete u njohën me botimin e përbashkët të KMD-së dhe KSHH-së: *"Mbrojtja nga diskriminimi – Manual trajnimi për OJF-të"*. Trajnimet janë organizuar gjatë periudhës Janar - Prill 2014 në Korçë, Shkodër dhe Kukës.

Pas konsultimit me PAMECA IV, KMD-ja ka vlerësuar si efikase dhe të frytshme: - trajnimin e stafit të policisë mbi ligjin *"Për mbrojtjen nga diskriminimi"*, të drejtat dhe detyrimet që përcakton ky ligj, mekanizmat për një mbrojtje sa më të efektshme nga diskriminimi, informacionin mbi zyrën e KMD-së, kompetencat dhe procedurat par trajtimin e çështjeve me objekt diskriminimin; - trajnimin e personelit në burgje, ambientet e paraburgimit dhe të ndalimit mbi ligjin *"Për mbrojtjen nga diskriminimi"*; - hartimin e një plani vizitash të personat e dënuar me heqje lirie, identifikimi i boshllëqeve në zbatimin e parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit dhe hartimi i rekomandimeve përkatëse. KMD-ja ka hartuar një Modul mbi barazinë dhe mosdiskriminimin për ta përfshirë në programin mësimor të Qendrës së Formimit Policor në Shqipëri; ka përgatitur programin e aktiviteteve trajnuese për stafin e komisariteve të policisë mbi ligjin nr.10221/2010 *"Për mbrojtjen nga diskriminimi"*; në bashkëpunim me përfaqësuesit e PAMECA; ka përgatitur një plan kalendarik të trajnimeve të para që do të organizohen. KMD-ja është në pritje të një përgjigjeje zyrtare nga përfaqësuesit e PAMECA IV për miratimin e programit dhe kalendarit të trajnimeve.

Organizimi i konferencave nga KMD-ja

30 janar 2014. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në bashkëpunim me Ambasadën PINK/LGBT Pro Shqipëri organizuan **workshop-in me temë "Politika përfshirëse dhe mosdiskriminuese për personat LGBT"**. Ky workshop i zhvilluar në kuadër të projektit LGBT të Këshillit të Europës kishte për qëllim të sillte një panoramë të rezultateve të politikave përfshirëse dhe mosdiskriminuese ndaj personave LGBT në vend, si dhe praktikat më të mira. Në këtë aktivitet, Komisionerja për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbajti prezantimin me temë: *"Roli i KMD-së në mbrojtjen e personave LGBT nga diskriminimi"*. Në aktivitet morën pjesë edhe Avokati i Popullit, Zëvendësministria e Brendshme, përfaqësues nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, si dhe përfaqësues nga OJF-të dhe shoqëria civile.

12 maj 2014. KMD-ja zhvilloi **seminarin "Mundësi të barabarta në sektorin ekonomik"** në bashkëpunim me Bashkimin Kombëtar të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë (NUCCI) dhe Shoqatën Kristiane të Grave Shqiptare (YWCA). Ky aktivitet ofroi një mundësi për të punuar dhe diskutuar mbi mekanizmat efikas të parandalimit dhe sistemeve të raportimit në lidhje me diskriminimin gjinor në sektorin ekonomik, si dhe mjetet e bashkëpunimit midis shoqatave/

operatorëve të biznesit dhe KMD-së rreth masave për mbrojtjen nga diskriminimi në këtë sektor. Seminari, ndër të tjera, iu referua përvojës portugeze dhe institucioneve të barazisë, si Komisioni për Emigrim dhe Dialog Ndërkulturor, Komisioni për Shtetësinë dhe Barazinë Gjinore dhe Komisioni për Barazi në punë dhe punësim. Organizimi i këtij seminari u mbështet nga UN Women. Në pjesën e dytë të aktivitetit u realizua trajnimi i përfaqësuesve të Dhomave të Tregtisë *"Për mbrojtjen nga diskriminimi gjinor në sektorin ekonomik"*, si dhe u publikua Guida Buri-more me të njëjtin titull (botim i viti 2012). Kjo guidë është përgatitur me mbështetjen e Njësisë së Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women), Zyra për Shqipërinë, dhe gjatë vitit 2014 është ribotuar, duke u përditësuar me materiale të reja.

17 maj 2014, me rastin e Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë, KMD-ja ka qenë bashkë organizatore e **"Panairit të diversitetit 2014"** dhe marshimit të krenarisë. KMD-ja kishte stendën e tij në këtë panair, në të cilën u prezantuan materiale të ndryshme ndërgjegjësuese.

30 qershor 2014, KMD-ja zhvilloi konferencën **"Së bashku për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të qytetarëve"**, në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, në kuadër të projektit *"Së bashku për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave të diskriminuar"*, me mbështetjen financiare të Zyrës së Kooperacionit Zviceran në Shqipëri dhe të *Civil Rights Defenders*. Kjo Konferencë erdhi në vijim të një nisme të ndërmarrë dy vjet më parë për mbrojtjen e të drejtave të grupeve të dobët në rajonet Korçë, Lezhë, Shkodër dhe Kukës. Përmes kësaj nisme, është synuar rritja e ndërgjegjësimit mbi legjislacionin anti-diskriminim në Shqipëri. Komisionerja për Mbrojtjen nga Diskriminimi në fjalën e saj u ndal në rolin që ky projekt ka pasur në trajnimin e stafeve të pushtetit vendor, krijimin e rrjetit të OJF-ve lokale dhe trajnimin e tyre, etj. Zëvendësdyrëtorja e Bashkëpunimit Zviceran, zonja Marie-Thérèse Karlen u shpreh se *"Vetëm pasi të gjithë qytetarët të gëzojnë qasje të barabartë në shërbime, mundësi zhvillimi dhe përfitime, mund të shpresojmë për përparim të mëtejshëm"*. Çështje të tjera të ngritura nga prezantimet e kësaj konference ishin: shërbimet sociale dhe roli i qeverisjes vendore, roli i OJQ-ve në raportimin e rasteve të diskriminimit, efikasiteti i institucioneve shtetërore në aplikimin e të drejtave të qytetarëve dhe mbrojtjen nga diskriminimi, nevojat urgjente të personave me aftësi të kufizuara, etj.

Në datën 20 nëntor 2014, KMD-ja organizoi **seminarin "Aspekte ligjore të zbatimit të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi"**, me qëllim identifikimin e problemeve në zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi. Përfaqësues të institucioneve shtetërore, organizatave ndërkombëtare, organizatave jofitimprurëse që mbrojnë të drejtat e minoriteteve, organizatave jofitimprurëse që mbrojnë të drejtat e grave dhe fëmijëve, si edhe të organizatave jofitimprurëse që mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara morën pjesë në 5 tryeza diskutimi. Ky seminar tërhoqi vëmendjen e institucioneve, shoqërisë civile, medias dhe aktorëve të ndryshëm në lidhje me nevojën për përmirësimin e ligjit *"Për mbrojtjen nga diskriminimi"*, me qëllim rritjen e efikasitetit të zbatimit të tij dhe qasjes së viktimave të sjelljeve diskriminuese në institucionet që ofrojnë asistencë ligjore për to. Disa nga çështjet e trajtuara në këtë aktivitet ishin: përfaqësimi nga OJF-të i viktimave të diskriminimit, zbatimi i detyrimit të subjekteve për të ofruar informacionin e kërkuar, roli i statistikave në shqyrtimin e rasteve, afatet për paraqitjen e ankesës nga subjektet, si dhe barra e provës në shqyrtimin e ankesave për diskriminim.

Gjatë muajit dhjetor 2014, KMD-ja mbajti një takim informues me stafin mësimor dhe nxënësit e shkollës 9 vjeçare *"Edit'h Durham"*.

II.3.3. Organizimi i Ditëve të Hapura

Ditët e hapura janë realizuar nga KMD-ja si një nga komponentët e tre projekteve që po zbatohen në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të kombëtare (OSCE/ODHIR, UNDP, KShH). Gjatë periudhës së raportimit, KMD-ja ka zhvilluar gjithsej 10 (dhjetë) Ditë të Hapura, në të cilat kanë marrë pjesë rreth 385 pjesëmarrës nga grupe të ndryshme të dobëta. Gjatë muajit shkurt 2014, janë realizuar 3 takime ndërgjegjësuese me komunitetin rom/egjiptian në Berat, Pogradec, Vlorë⁷¹. Gjatë periudhës nëntor 2013 – shkurt 2014, u zhvilluan 4 Ditë të Hapura në Korçë, Lezhë, Shkodër dhe Kukës.⁷² Gjatë muajit dhjetor 2014, janë zhvilluar 3 takime ndërgjegjësuese në Tiranë.

Gjatë Ditëve të Hapura janë shpërndarë fletëpalosje dhe broshura informuese mbi ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në gjuhët e pakicave dhe në formate të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara në shikim (me shkrim Braille).

II.3.4. Rritja e vizibilitetit në media

Komisioneri dhe stafi i KMD-së kanë marrë pjesë në disa emisione televizive ku trajtohen problematikat sociale, që kanë të bëjnë me barazinë dhe mosdiskriminimin.⁷³ Komisionerja gjithashtu ka zhvilluar intervista speciale, si e ftuar, në edicionet qendrore informative. Komisionerja ka botuar disa shkrime në shtypin e shkruar.⁷⁴ Gjithashtu, janë dhënë deklaratat për shtyp në lidhje me rritjen e dhunës ndaj grave, integrimin në arsimim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, diskriminimin në punësim, diskriminimin përmes gjuhës së urrejtjes, të drejtat e minoriteteve etj. Pasurimi i faqes zyrtare dhe Facebook-ut të Institucionit me aktivitetet e KMD-së, rekomandimet legjislative, rekomandimet dhe opinionet mbi çështje të diskriminimit, vendimet e KMD-së apo nisjet kryesisht të çështjeve me ndjeshmëri për publikun, kanë intensifikuar marrëdhëniet e institucionit me publikun. Në këtë këndvështrim, vihet re një rritje e paraqitjes së ankesave përmes adresës elektronike të institucionit apo denoncimeve në rrjetin social Facebook.

II.3.5. Leksione të hapura

Komisionerja ka zhvilluar 7 (shtatë) Leksione të hapura me temë: “Mbi rolin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si garant ndaj sjelljeve diskriminuese”, në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, në kuadrin e Modullit “Administrata publike dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut”.

Gjatë vitit 2014, Zyra e KMD-së ka marrë pjesë në 34 aktivitete (seminare, workshope) me qëllim rritjen e kapaciteteve, si dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet shtetërore

⁷¹ Aktivitete të mbështetura nga projekti “Për mbështetjen e përfshirjes sociale të komuniteteve romë dhe egjiptiane (SSIREC)”

⁷² Në kuadër të projektit “Për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave të diskriminuar”, të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH), në partneritet me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur financiarisht nga Zyra e Kooperacionit Zviceran në Tiranë.

⁷³ Përmendim: “Agon Channel”; Wake-up në Top Channel; 7 pa 5 në Vizion Plus; “Urbanika” (A1 Report); “Me zemër të hapur” (News 24); “Pasdite në Top Channel”; “Dita ime” (Vizion Plus); “Target” (Albanian Screen); “Duel” (Tvsh); Radio Albania News etj.

⁷⁴ Botimi me datë 9 maj i një artikulli në gazetën “Shqip” i Komisioneres Irma Baraku, me temë “Integrimi në arsim i fëmijëve me aftësi të kufizuara – Filozofi dhe detyrim ligjor” apo artikulli i botuar “Mbi shpërndarjen e nxënësve romë në shkollat 9-vjeçare në Tiranë” në të njëjtën gazetë.

apo organizatat kombëtare apo ndërkombëtare, që mbrojnë të drejtat e njeriut dhe japin opinione mbi diskriminimin. Janë forcuar kapacitetet e punonjësve të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, të drejtat e komunitetit rom dhe egjiptian për çështje të sigurisë, të drejtësisë sociale, për fenomenin e gjakmarrjes, mbrojtjen e të dhënave personale, etj.

Për informacion mbi aktivitetet e organizuara nga aktorë të tjerë, ku stafi i KMD-së ka marrë pjesë, referojuni Shtojcës 2 të këtij raporti.

II.4. Studime dhe monitorime mbi diskriminimin

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa (dh), (e), (f) të ligjit 10221/2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, KMD-ja ka ndërmarrë studimet e mëposhtme.

II.4.1. Studime të KMD-së mbi diskriminimin

Gjatë vitit 2014, KMD-ja ka hartuar:

- Studimin “**Mbi situatën e diskriminimit të komunitetit rom**”. Ky studim përfshin, përveç pasqyrimin të situatës aktuale edhe një analizë të hollësishme të kuadrin ligjor, politikave dhe aspekteve kryesore ku duhet të ndërhyhet, për një zbatim më të mirë të parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit në gëzimin e të drejtave të njeriut nga ky komunitet.
- Studimin “**Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit LGBT në Shqipëri**”. Në këto studime, KMD-ja është ndalur në kontekstin social, adresimin e çështjeve të diskriminimit të komunitetit LGBT, me synim rritjen e numrit të ankesave, hartimin e politikave dhe strategjive dhe trajtimin e tyre nga institucioni i barazisë dhe mosdiskriminimit, si edhe promovimin e të drejtave të komunitetit dhe të aspektit të komunikimit. Ky studim është botuar edhe në anglisht.

II.4.2. Monitorime të KMD-së për diskriminimin

Gjatë vitit 2014, KMD-ja ka ndërmarrë dy monitorime:

- Monitorimi i zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në sektorin privat të punësimin. Ky monitorim është fokusuar në mënyrë të veçantë tek qasja e grupeve të dobëta në punësim;
- Monitorimi i zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” nga gjykatat.

Është hartuar metodologjia dhe gjatë vitit 2015 do të përfundojnë monitorimet.

II.4.3 Raportime të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi para organizatave ndërkombëtare dhe rajonale

Mbështetur në Urdhrin e Kryeministrit nr. 112, datë 05.03.2014, “Për ngritjen e grupit ndërministror të punës mbi hartimin dhe pjesëmarrjen në shqyrtimin e raporteve në

kuadër të Konventave Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, KMD-ja ka kontribuar në:

Hartimin e Raportit të Katërt Periodik Kombëtar mbi Zbatimin e Konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” - CEDAW

Për përgatitjen e këtij raporti, KMD-ja ka kontribuar:

- Në kuadrin ligjor për garantimin e barazisë dhe mosdiskriminimit në Shqipëri;
- Në përmirësimin e kuadrit ligjor në lidhje me adresimin e diskriminimit gjinor duke theksuar ndryshimet e Kodit Penal të RSH-së, Kodit Zgjedhor, etj;
- Me rekomandime për përmirësimin e Kodit Zgjedhor;
- Në situatën faktike në lidhje me pjesëmarrjen e grave në politikë dhe vendimmarrje;
- Në situatën faktike në lidhje me dhunën në familje;
- Me praktikën e saj në adresimin e dhunës ndaj grave. Gjatë vitit 2012, KMD-ja ka shqyrtuar një rast me iniciativën e vet, lidhur me dhunën psikologjike ndaj disa grave nga drejtuesi i institucionit ku këto gra trajtoheshin. Lidhur me këtë rast, Komisioneri ka nxjerrë rekomandim për marrjen e masave me qëllim eliminimin e kësaj shtate. Ky rekomandim është zbatuar nga ana e institucionit.
- Në situatën e diskriminimit për shkak të gjinisë në Shqipëri;
- Me veprimtarinë e tij për mbrojtjen nga diskriminimi gjinor; KMD-ja ka ndihmuar viktimat e diskriminimit gjinor përmes shqyrtimit të çështjeve dhe asistencës së tyre në gjykata, dhënies së rekomandimeve legjislative dhe rekomandimeve të tjera, ndërgjegjësimit, publikimeve etj.

Grupi i punës për hartimin e këtij raporti është ndihmuar nga ekspertja e CEDAW Pramila Patten, nënkryetare e Komitetit të Konventës mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave - CEDAW.

Raporti Periodik mbi Zbatimin e Konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” (CEDAW) është miratuar me VKM nr. 806, datë 26.11.2014

Kontribut në përgatitjen e raportit mbi të drejtat e njeriut 2014

Ky kontribut ka konsistuar kryesisht në:

- Dhënien e informacionit mbi numrin, llojin e çështjeve të diskriminimit dhe masat e marra nga KMD-ja, si edhe rezultatet e këtyre masave;
- Shkaqet për të cilat është pretenduar diskriminimi si raca, orientimi seksual, kushtet shëndetësore, aftësia e kufizuar, bindjet politike dhe mosha;
- Një vlerësim të përgjithshëm të diskriminimit ndaj personave LGBT si edhe në paraqitjen e informacionit rreth çështjeve konkrete; prezantimin e propozimeve për ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë dhe zbatimin e tyre vetëm pjesërisht;
- Konstatimin nga KMD-ja se në shumë raste, debatet mbi të drejtat e personave të komunitetit LGBT shoqërohen me përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Gjuha e urrejtjes në ankesat e paraqitura para KMD-së përdoret kryesisht kundër personave LGBT. Ankesat janë drejtuar kryesisht kundër figurave publike si politikanë, gazetarë, autorë tekstesh. KMD-ja ka ngritur disa shqetësime në lidhje me komunitetin LGBT si: homoseksualiteti i cili trajtohet si një sëmundje dhe për të cilin shpërndahet informacion i gabuar përmes teksteve universitare; tendenca e trajtimit të homoseksualitetit si një çështje e lidhur me lajme skandaloze; etj. Një rast i tillë është transmetimi i informacionit mbi veprat penale, duke e lidhur atë me karakteristikat personale (si orientimi

seksual) të individit që pretendohet se ka kryer veprën penale;

- Aktivitete me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në kuadër të përgatitjes së **Raportit në zbatim të Konventave të Organizatës Ndërkombëtare të Punës - ILO**, bazuar në rekomandimet e Komitetit të Ekspertëve, ka përgatitur informacionin për fushën e veprimtarisë së tij për periudhën maj 2013-maj 2014.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për sa i përket fushës së veprimtarisë së tij, ka përgatitur informacionin në kuadër të tre çështjeve të diskutuara prej Komitetit *ad hoc* për shtjellimin e standardeve ndërkombëtare komplementare të **Konventës mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racia (CERD)**.

Raportime në kuadër të procesit të integritit evropian

Në datën 18 mars 2014, Komisioneri ka raportuar në kuadër të **Takimit të Pestë të Komitetit të Stabilizim-Asociimit**, Bashkimi Evropian-Shqipëri, i cili monitoron zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Raportimi është fokusuar në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Dokumentit të Partneritetit Evropian (2007), për kohën që është zbatuar, rekomandimeve të Raportit të Progresit 2013, si dhe rekomandimeve të nën-komiteve të Stabilizim-Asociimit të zhvilluara gjatë vitit 2013 dhe 2014.

Në datat 14-15 maj 2014, u zhvillua takimi i gjashtë i **Nën-komitetit Bashkimi Evropian-Shqipëri për “Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë”**, në Ministrinë e Integritit, Tiranë. Pas prezantimit të veprimtarisë dhe zhvillimeve kryesore të KMD-së për periudhën e raportimit, kryetari i delegacionit evropian, komentoi se është për t'u vlerësuar puna e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili ka mbledhur të dhëna dhe statistika, ka rritur ndërgjegjësimin dhe pozitiv është fakti se ka filluar zbatimi i ligjit edhe në gjykatë.

Në datat 25 - 26 nëntor 2014, u zhvillua takimi i gjashtë i **Nën-komitetit Bashkimi Evropian-Shqipëri për “Inovacionin, shoqërinë e informacionit dhe politikën sociale”**, në Bruksel. Me shkresën Nr. 898/1 Prot, datë 30.10.2014, Komisioneri ka dërguar informacion mbi zhvillimet konkrete të institucionit për periudhën e raportimit nga 1 nëntor 2013 - 31 tetor 2014, bazuar në kërkesën e Ministrisë së Integritit, nëpërmjet shkresës me Nr. 1785, datë 21.10.2014.

Komisioneri Për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka qenë pjesë e grupit të punës me ekspertët e SMEI III, dhe ka kontribuar në kuadër të hartimit të **Planit Kombëtar të Integritit Evropian - PKIE** në lidhje me Kapitullin 19.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kontribuar në kuadër të **Udhërrëfyesit për 5 Prioritetet**, në të cilin KMD-ja ka parashikuar masa në kuadër të Prioritetit 5 “Të Drejtat e Njeriut” dhe në vijim ka raportuar në lidhje me këto masa dhe aktivitete në kuadër të zbatimit efikas të ligjit për “Mbrojtjen nga diskriminimi” dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për këtë ligj.

Misionet e ekspertëve pranë KMD-së

1) - Në kuadër të përmbushjes së kontributit për Progres Raportin 2014, si dhe monitorimit të prioritetëve kyçe të integritetit, nga Komisioni Evropian është dërguar në Tiranë një mision ekspertësh në datat 2 - 6 qershor 2014. Axhenda është përcaktuar nga Komisioni Evropian në lidhje me çështjet që do diskutoheshin gjatë takimit, por ka pasur tematika dhe diskutime edhe përtej saj.

a) Lidhur me *misionin e ekspertëve për të drejtat e njeriut me fokus të drejtat e grave*, çështjet e përcaktuara në axhendë kishin të bënin me mekanizmat kombëtarë të referimit dhe nëpunësit e barazisë gjinore; strategjitë për një linjë telefonike kombëtare për të mbijetuarat e dhunës kundër grave, dhe një sistem për kompensimin e viktimave; kapacitetet/burimet për strehën kombëtare për viktimat e dhunës në familje; masat e marra për parandalimin dhe luftën kundër diskriminimit dhe dhunës në familje; strategjitë për krijimin e një sistemi për kompensimin e viktimave, siç parashikon Konventa e Këshillit të Evropës; programe riintegrimi e viktimave, duke përfshirë mundësi trajnimi, edukimi, strehimi dhe mundësi ekonomike;

b) Lidhur me *misionin e ekspertëve për të drejtat e njeriut me fokus të drejtat e romëve dhe anti-Diskriminimit*, çështjet e përcaktuara në axhendë ishin: Numri i ankesave të paraqitura nga viktimat pranë autoriteteve të ndryshme, llojet e ankesave, shkaqet dhe zgjidhjet e miratuara, duke përfshirë të dhëna krahasuese në vite p.sh. 2011-2013, dhe numri i çështjeve të përfunduara; efikasiteti i Prokurorisë së Shtetit dhe Policisë së Shtetit në hetimin e çështjeve (p.sh. ngacmimet e personave LGBT); kapacitetet/burimet e zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; baza e të dhënave të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për mbledhjen sistematike të të dhënave në menaxhimin e rasteve; numri i punonjësve të zyrës së KMD-së që punojnë me investigimin e dhunës; fushatat e ndërmarra për ndërgjegjësimin e personave LGBT në lidhje me ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi dhe mosdiskriminimin, barazinë gjinore dhe të drejtat e tyre; baza e të dhënave në lidhje me zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, veçanërisht në lidhje me menaxhimin e rasteve të diskriminimit; amendimet e miratuara, nëse ka, në lidhje me ndalimin e diskriminimit për shkak të orientimit seksual dhe/ose identitetit gjinor në Kodin e Punës; ekzistenca e planeve për harmonizimin e dispozitave ekzistuese ligjore për mosdiskriminimin me Kodin e Punës, Kodin e Familjes, Kodin e Etikës së Medias Shqiptare dhe ligjin për Median; vlerësimi i amendamenteve të propozuara nga KMD-ja (nëse nuk janë zbatuar ende) për Kodin Penal, Kodin e Punës, Kodin e Familjes, Kodin e Procedurës Civile, Kodin Elektorale dhe Kodin e Procedurave Administrative; masat për forcimin e kapaciteteve të nëpunësve të autoriteteve lokale dhe administratës publike në lidhje me çështjet anti-diskriminim; mënyra se si autoritetet lokale dhe qendrore adresojnë çështjet e diskriminimit në sektorin privat.

2) - Në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, me iniciativën e Ministrisë së Integritetit Evropian, Komisioni Evropian organizoi në datat 8 -10 shtator 2014, vizitën e misionit të ekspertëve për institucionet e pavarura, i cili u realizua edhe pranë KMD-së. Misionet e ekspertëve u përqendruan në vlerësimin e pavarësisë dhe funksionimit të institucioneve të pavarura në Shqipëri, ku përfshihen: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Avokati i Popullit; Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit; Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale; Agjencia e Prokurimit Publik; Komisioni i Prokurimit Publik; Enti Rregullator i Energjisë; Komisioni i Ndihmës Shtetërore; Autoriteti i Konkurrencës.

3) - Me datë 9 shtator 2014, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi priti në një takim Komisioneren e Lartë të OSBE-për Pakicat Kombëtare, zonja Astrid Thors. Komisionerja e Lartë shfaqti interes për situatën e diskriminimit për minoritetet në Shqipëri, tipologjinë e ankesave, rolin e Komisionerit në grupin ndërinstytucional të punës për vlerësimin e kuadrit ligjor dhe të politikave për minoritetet, njohjen me rastet praktike të diskriminimit për minoritetet, vlerësimin e nevojës për hartimin e një ligji të posaçëm për minoritetet, bashkëpunimin me institucionet e tjera të cilat garantojnë të drejtat e minoriteteve, adresimin e diskriminimit të shumëfishtë. Znj. Baraku nga ana e saj, e njohu zonjën Thors lidhur me punën e Komisionerit për të luftuar rastet e diskriminimit të minoriteteve, rastet e trajtuara nga Komisioneri, rritjen e numrit të ankesave vit pas viti, mënyrat e ndërgjegjësimit të minoriteteve lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi, zbatimin e rekomandimeve të Komisionerit nga autoritetet përgjegjëse. Komisionerja falënderoi Prezencën e OSBE-së në Shqipëri për bashkëpunimin dhe mbështetjen që i kanë dhënë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

II.4.4. Seancat publike në Kuvend

Gjatë viti 2014, KMD-ja ka marrë pjesë në disa seanca dëgjimore në Kuvend, nga të cilat përmendim:

- 28 maj 2014, KMD-ja mori pjesë në seancën dëgjimore të organizuar nga Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë (mes fëmijëve dhe deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë).
- 15 korrik 2014, seancë dëgjimore në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, me grupet e interesit për Projektligjin për "Dëmshpërblimet e të përndjekurve politikë".
- 21 korrik 2014, seancë dëgjimore në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, me grupet e interesit për Projektligjin "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara".
- 2 Dhjetor 2014, seancë dëgjimore në Nën-komisionin për të Drejtat e Njeriut "Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit LGBTI në Shqipëri".

II.5. Bashkëpunime

II.5.1. Anëtarësimi në EQUINET - Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë

Pas marrjes së statusit të vendit kandidat të Shqipërisë për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, është përmbushur një nga kushtet për t'u përfshirë në EQUINET - Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë.

Paraprakisht, bazuar në procedurën e anëtarësimit në EQUINET, Shqipëria bëri kërkesë për anëtarësim dhe më pas Bordi Ekzekutiv, në mbledhjen e datës 15 Tetor 2014, vlerësoi kërkesën e KMD-së në përputhje me statutin e EQUINET dhe kriteret e anëtarësimit, dhe e miratoi atë. Mbi këtë bazë, Bordi u propozoi anëtarëve të EQUINET që të votojnë anëtarësimin e KMD-së në mbledhjen vjetore. Kështu, KMD-ja u bë anëtar i 42-të dhe më i ri i EQUINET.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është bërë anëtar i EQUINET me datë 4 Dhjetor 2014, gjatë votimit në mbledhjen e Përgjithshme Vjetore (AGM) nga anëtarët e Rrjetit. Aktualisht, EQUINET është rrjeti i 42 organeve të barazisë në 32 vende europiane.

KMD-ja e vlerëson anëtarësimin e saj në EQUINET si një mundësi të mirë, veçanërisht për shkëmbimin e eksperiencave dhe të informacionit mbi legjislacionin dhe politikën e barazisë dhe mosdiskriminimit në nivel evropian. Stafi i KMD-së është përfshirë në shtatë grupet e punës të këtij rrjeti, konkretisht në:

- Grupin e Punës për legjislacionin e barazisë
- Grupin e Punës për komunikimin strategjik
- Grupin e Punës për barazinë gjinore
- Grupin e Punës për hartimin e politikave
- Grupin e Punës për çështjet gjyqësore strategjike
- Grupin e Punës për vlerësimin e projekteve laboratorike
- Grupin e Punës për standardet dhe organet e barazisë

II.5.2. Bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtare përmes projekteve të përbashkëta

Pesë punonjës të KMD-së janë përfshirë në Programin HELP të Këshillit të Europës. Ky program synon trajnimin online të juristëve të rinj për çështjet e diskriminimit, trajnimin e tyre nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut etj.

Projektet e përbashkëta, nëpërmjet të cilave KMD-ja ka bashkëpunuar me organizatat ndërkombëtare janë:

- Projekti **“Mbështetje për përfshirjen sociale të komuniteteve romë dhe egjiptiane”** SSIREC- financuar nga BE-ja dhe zbatuar nga UNDP;
- Projekti **“Forcimi i kapaciteteve të KMD-së për adresimin e çështjeve gjinore, veçanërisht në sektorin ekonomik”**, të UN Women, Shqipëri;
- Projekti **“Best Practices for Roma Integration”** i ODIHR, me mbështetjen financiare të BE-së, ka mbështetur edhe KMD-në.

II.5.3. Bashkëpunimi me shoqërinë civile

- Në lidhje me bashkëpunimin me shoqërinë civile, konstatojmë se ky bashkëpunim është forcuar gjatë vitit 2014. Rekomandimet që kanë rezultuar nga dialogu me shoqërinë civile kanë gjetur pasqyrim në Planin e Veprimit të KMD-së për vitin 2014. KMD ka ndërmarrë hapat e nevojshme për realizimin e tyre.

Projektet e përbashkëta, nëpërmjet të cilave KMD-ja ka bashkëpunuar me shoqërinë civile janë:

- Projekti **“Së bashku për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të qytetarëve”**, i KMD-së, në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, me mbështetjen financiare të Zyrës së Kooperacionit Zviceran në Shqipëri dhe Civil Rights Defenders
- Projekti **“Përmirësimi i jetës së personave LGBT në nivel lokal”**, i Ambasadës PINK

II.5.4. Bashkëpunimi me institucionet shtetërore

Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe me përfshirjen e aktorëve të tjerë nga bota akademike dhe shoqëria civile, KMD-ja është angazhuar në hartimin e një plani masash për ndërhyrje në programet mësimore të shkollave në kuadër të parashikimeve të ligjit **“Për mbrojtjen nga diskriminimi”**. Në kuadër të masave të parashikuara në Prioritetin 5, Ministria e Arsimit dhe Sportit do të jetë institucioni përgjegjës për **“Zbatimin e rekomandimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dërguar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës”⁷⁵ me shkresën nr. Prot. 367, datë 01.07.2013, në lidhje me masat për eliminimin nga programet studimore të institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë, të literaturës që diskriminon dhe paragjykon të drejtat e komunitetit LGBT”, deri në shtator 2014.**

KMD-ja ka marrë pjesë në disa grupe pune, nga të cilat përmendim:

- Mbështetur në Urdhrin e Kryeministrit nr.117, datë 10.03.2014, mbi ngritjen e grupit të punës ndërinstitucional **“Për vlerësimin e kuadrit ligjor dhe politikave për minoritetet”**, KMD-ja ka ofruar kontributin e tij. Gjatë periudhës prill-tetor 2014, janë zhvilluar 9 takime, me qëllim vlerësimin dhe diskutimin e çështjeve të ndryshme që lidhen me minoritetet. Në takimin e datës 5 dhjetor 2014, u diskutua çështja e qasjes së minoriteteve në media. Gjatë muajit tetor 2014, në kuadrin e procesit të konsultimit është organizuar takimi i Ministrit të Punëve të Jashtme me përfaqësues të shoqatave të minoriteteve. Konkluzionet e procesit të konsultimit janë përgatitur në dhjetor 2014;
- Grupin ndërmintor të punës **“Për ndjekjen dhe zbatimin e strategjisë kombëtare”** **“Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”**;
- Grupin ndërmintor të punës **“Për zbatimin e rregullave të përshtatshme në institucionet shtetërore”**;
- Grupin teknik të punës **“Për zyrtarizimin e gjuhës së shenjave”**.
- Grupin e Punës Për vlerësimin e progresit të Dokumentit të Bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Europës dhe Shqipërisë 2012-2014.

75 Aktualisht Ministria e Arsimit dhe Sporteve.

KAPITULLI 3

ASPEKTE TË SHËRBIMEVE

III.1. Menaxhimi i burimeve njerëzore

Në institucionin e KMD-së punojnë 20 persona, nga të cilët 15 kanë statusin e nëpunësit civil, të fituar në përputhje me kërkesat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil. Këto procedura i janë nënshtruar kontrollit nga Komisioni i Shërbimit Civil në vitin 2013, i cili ka konstatuar zbatimin korrekt të tyre nga institucioni i KMD-së. Gjatë vitit 2014, pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk është zhvilluar asnjë konkurrim për pozicione të lira pune, por bazuar në ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" kanë marrë konfirmimin të gjithë punonjësit që kishin përfituar statusin e nëpunësit civil sipas kërkesave të ligjit të mëparshëm.

Punonjësit e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi kanë nivelin bazë të arsimit në përputhje me kërkesat e vendit të punës (sistemi 4 vjeçar ose sistemi i studimeve 3 + 2) dhe kryesisht kanë përfunduar studimet në drejtësi dhe shkencë sociale (me përjashtim të IT, sekretares së arshivës/protokollit dhe financieres, të cilët kanë përfunduar studimet respektivisht për elektronikë, histori dhe financë). Një pjesë e punonjësve të KMD-së kanë marrë "Master Shkencor" në drejtime të lidhura me detyrat që kryejnë pranë zyrës së KMD-së si: Master në Administratën Publike, Master në të Drejtën Europiane, Master në Barazinë Gjinore, Master Profesional në të Drejtën Europiane të Biznesit, Master i Shkencave në të Drejtën Publike, Master në të Drejtën Kushtetuese, Master Profesional në të Drejtën Penale, etj.

Nëpunësit e KMD-së kanë marrë pjesë në trajnime të ndryshme si, trajnime të organizuara nga Departamenti i Administratës Publike, Instituti i Trajnimeve të Administratës Publike (sot ASPA), Komisioni i Shërbimit Civil (sot Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil) dhe Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Trajnimet janë fokusuar në çështjet që kanë të bëjnë me njohjen e Administratës Publike, përgatitjen e letrave dhe komunikimeve zyrtare, hartimin e kontratave, sistemin e menaxhimit të informacionit të burimeve njerëzore, mbrojtjen e të dhënave personale, zbatimin e ligjit "Për nëpunësin civil", masat disiplinore dhe procedurat e apelimit, organizimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore dhe strukturave organizative, etj.

Janë organizuar trajnime me qëllim rritjen e nivelit profesional në trajtimin e çështjeve të diskriminimit, si mbrojtja nga diskriminimi për shkak të gjinisë, etnicitetit, orientimit seksual dhe aftësisë së kufizuar, monitorimi i zbatimit të Konventës së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, përmirësimi i mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në luftën kundër diskriminimit, organizimi i Ditëve të Hapura me komunitetet rome dhe egjiptiane, të drejtat e njeriut dhe mosdiskriminimi i komuniteteve rome dhe egjiptiane, integrimi gjinor për nëpunësit e barazisë gjinore në nivel vendor, përfshirja e çështjeve LGBT në politikën sociale, të drejtat e njeriut në praktikë, etj.

Në datat 19-21 shkurt 2014, Komisionerja për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe 6 punonjës të KMD-së ishin pjesë e vizitës studimore në institucionet portugeze të barazisë. Vizita studimore u realizua në kuadër të projektit të UN Women, "Forcimi i kapaciteteve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për adresimin e çështjeve gjinore, veçanërisht në sektorin ekonomik". Qëllimi i vizitës studimore ishte rritja e kapaciteteve të punonjësve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përfaqësuesve të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë dhe të organizatave të shoqërisë civile, të cilat punojnë për promovimin e të drejtave të grave, praktikave më të mira për parandalimin dhe trajtimin e diskriminimit gjinor, me fokus të veçantë në sektorin ekonomik, nëpërmjet shkëmbimit të praktikës, eksperiencës dhe informacionit me përfaqësues të autoriteteve portugeze të cilët punojnë për barazinë gjinore, mbrojtjen nga diskriminimi, etj.

- **Projekt vendim i paraqitur nga KMD-ja pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë**

KMD-ja ka dërguar me shkresë nr. 737 Prot, datë 01.09.2014, *Projekt-vendimin "Për disa ndryshime në vendimin nr.34, datë 20.5.2010 'Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi'"*.

Propozimi për ndryshimin e vendimit nr. 34, datë 20.05.2010, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi" erdhi si rezultat i nevojës për përshtatjen e strukturës së zyrës së Komisionerit me parashikimet ligjore dhe nënligjore siç janë, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 474, datë 16.06.2011, "Për përcaktimin e standardeve e te procedurës që duhet të ndiqen gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike". Njëkohësisht ndryshimet synuan të adresojnë edhe prioritetin e përcaktuar në Planin Strategjik 2012-2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për riorganizimin institucional me qëllim rritjen e efikasitetit të KMD-së dhe veçanërisht, fuqizimin e Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun, si dhe sugjerimet e Progres Raportit 2013 për domosdoshmërinë e rritjes së ndërgjegjësimit.

Ndryshimet e propozuara me anë të këtij projekt-vendim janë:

- Kalimi i specialistit të burimeve njerëzore nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse tek Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe ndryshimi i emërimit të këtij sektori nga Sektori i Marrëdhënieve me Publikun në Sektori i Ndërgjegjësimit dhe Marrëdhënieve me Publikun;
- Ndryshimi i emërimit nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në Drejtoria e Financave dhe Administrimit.

Aktualisht drafti është në Kuvend.

III.2. Menaxhimi i burimeve financiare

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në lidhje me performancën financiare buxhetore, ka vepruar me korrektësi në zbatim të ligjit Nr. 9936, datë 26.06. 2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit "Për buxhetin e vitit 2014", në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit dhe zbatimin e udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave 'Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014'".

Buxheti i akorduar për këtë program është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në deklaratën e politikës së programit: Organizimi dhe ndërtimi i kapaciteteve të nevojshme për mirëfunksionimin e zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; përafrimi dhe harmonizimi i legjislacionit në fushën e zbatimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit me legjislacionin e vendeve të tjera të bashkimit europian; sigurimi i zbatimit të legjislacionit ekzistues dhe hartimi i strategjive për realizimin e këtij synimi; vendosja e marrëdhënieve dhe hartimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me të gjithë aktorët që ndikojnë në zbatimin e kërkesave ligjore në fushën e zbatimit të parimit të barazisë; nxitja dhe ndërgjegjësimi i komuniteteve që kanë interes të drejtpërdrejt, si dhe i gjithë shoqërisë mbi mundësitë e zbatimit të parimit të mësipërm, për të garantuar maksimalisht të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Gjithashtu ky buxhet ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve dhe arritjes së objektivave të përcaktuara për këtë program buxhetor.

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka realizuar 77,75 % të buxhetit vjetor të akorduar. Fondi për shpenzime investimi (zëri 231) është realizuar në masën 87.00 % të fondit të planifikuar. Fondi për shpenzime në zërin "Mallra dhe shërbime" (zëri 602) është realizuar në masën 68.62 % të fondit të planifikuar.

Vërejmë se vlera e pashpenzuar nga fondi i akorduar i përket parashikimit të zërit "udhëtime brenda dhe jashtë shteti", ku një pjesë e tyre janë mbuluar nga donatorët. Nga ana tjetër, vlerësojmë se pengesë për realizimin e disa shpenzimeve janë: planifikimi i papërshtatshëm i tavaneve të detyrueshme të shpenzimeve mujore, duke vendosur vlerat më të mëdha në dy muajt e fundit të vitit. Prokurimet me vlera të vogla online rrisin transparencën e procesit, por për institucionin kanë sjellë vonesa, pasi subjektet pjesëmarrëse nuk kanë respektuar kërkesat e prokurimit apo nuk kanë shfaqur interes (për shkak të vlerave të vogla). Fondi i Donacioneve për vitin 2014 është realizuar në masën 90,33 % të fondit të planifikuar vjetor. Vlera e donacionit është parashikuar për aktivitete me organizatën UNDP.

KMD-ja ka përcaktuar disa prioritete për vitin 2015 si vijon:

- » Të forcohet bashkëpunimi i KMD-së me organizatat që punojnë me grupe të marginalizuara si romët dhe egjiptianët, PAK, LGBTI, etj., me qëllim identifikimin e situatave që ngrenë çështjen e diskriminimit dhe rritjen e numrit të rasteve të nisura me iniciativë të vet;
- » Të vazhdojë puna për rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuese, përfshirjen e pushtetit vendor, organizatave që punojnë me grupet në nevojë, përdorimit të mediave elektronike dhe të shkruara si një mjet i rëndësishëm, etj.
- » Duke vlerësuar se Ditët e Hapura kanë rritur numrin e ankesave për diskriminim të paraqitura pranë KMD-së, të organizohen Ditë të Hapura në vazhdimësi.
- » Duke vlerësuar shkaqet e ankesave për diskriminim gjatë vitit 2014, KMD-ja do të forcojë punën për parandalimin e diskriminimit për shkak të racës, etnisë, bindjes politike, gjendjes ekonomike, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, gjendjes arsimore, shoqërore, dhe shkaqeve të tjera.
- » Duke vlerësuar se përmirësimet në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi rrisin efektivitetin e zbatimit të tij, KMD-ja do të vazhdojë punën për përmirësimin e tij, në përputhje të plotë me të drejtën e BE-së.
- » KMD-ja do të vazhdojë punën lobuese për marrjen në konsideratë të rekomandimeve legjislative të paraqitura në vitin 2014 dhe miratimin e tyre.
- » Rritja e numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me një numër sa më të madh aktorësh edhe gjatë vitit 2015 do jetë në vëmendjen e institucionit tonë.
- » KMD-ja do të vazhdojë angazhimin për të trajnuar të gjithë aktorët për evidentimin dhe trajtimin efikas të çështjeve të diskriminimit.

Kuadri ligjor për garantimin e barazisë dhe mosdiskriminimit në Shqipëri

Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike është ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1991⁷⁶. Në nenin 2, kjo Konventë përcakton detyrimin e shteteve palë për të siguruar që të gjithë shtetasit të jenë subjekt i mbrojtjes së të drejtave të parashikuara në këtë konventë pa dallim race, ngjyre, seksi, gjuhe, përkatësie rajonale apo politike, përkatësie kombëtare, origjine sociale, pasurie ose status lindjeje. Neni 26 i këtij instrumenti parashikon se, “Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë ligjore pa kurrfarë dallimi. Lidhur me këtë, ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efikase ndaj çdo diskriminimi”.

Në korrik 2013, KMD-ja ka qenë pjesë përbërëse e delegacionit që ka raportuar lidhur me zbatimin e Paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike, në kuadër të Raportit të dytë periodik të Shqipërisë, gjatë Sesionit 106 të Komitetit për të Drejtat e Njeriut. Në vëzhgimet përmblylëse, Komiteti ka vlerësuar si aspekte pozitive miratimin, ndër të tjera, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në vitin 2010 dhe amendimet në Kodin Penal në maj 2013, të cilat zgjerojnë mbrojtjen nga diskriminimi edhe për shkak të orientimit seksual.

Në komentin e përgjithshëm 18, për mosdiskriminimin, Komiteti i të Drejtave të Njeriut thekson se, mosdiskriminimi së bashku me barazinë para ligjit dhe mbrojtjen e barabartë ligjore pa diskriminim, përbëjnë një parim të përgjithshëm bazë në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Komiteti thekson se, parimi i barazisë kërkon shpesh që shtetet palë të marrin masa pozitive për të eliminuar kushtet që shkaktojnë ose ushqejnë diskriminimin e ndaluar nga kjo konventë. Komiteti vëren se jo çdo trajtim i ndryshëm përbën diskriminim, nëse kriteret për këtë trajtim të ndryshëm janë të arsyeshme dhe objektive dhe nëse synimi është që të arrihet një qëllim që është legjitim sipas konventës.

Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore është ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1991⁷⁷. Shtetet palë të këtij instrumenti garantojnë që të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore të shpallura në këtë Pakt, të ushtrohen pa kurrfarë diskriminimi. Disa nga të drejtat e parashikuara në këtë Konventë janë e drejta për punë, e drejta sindikale, e drejta e sigurimit shoqëror, e drejta për arsim, etj.

Në nëntor 2013, KMD-ja ka qenë pjesë përbërëse e delegacionit që ka raportuar lidhur me zbatimin e Paktit ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Në vëzhgimet përfundimtare të këtij Komiteti, mbi raportin e dytë dhe të tretë periodik të kombinuar të Shqipërisë, vlerësohet si pozitive miratimi i ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ligjit “Për shëndetin mendor”, ratifikimi i Konventës së OKB-së, “Për të drejtat e personave me aftësi të ku-

76 Ligji nr. 7510 date 08.08.1991 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike”.

77 Ligji nr. 7511 date 08.08.1991 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Paktin Ndërkombëtar për të drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore”.

fizuara”, ndryshimet në Kodin Penal lidhur me zgjerimin e mbrojtjes nga diskriminimi për shkak të orientimit seksual, si dhe puna e realizuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.⁷⁸ **Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara**, e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2012⁷⁹, ka përcaktuar një sërë të drejtash Për personat me aftësi të kufizuara, të cilat përkthehen në detyrime Për shtetet palë. Këto parashikime duhen të udhëheqin ndryshimet legjislative, në kuadër të përshtatjes së legjislacionit të brendshëm shqiptar me këtë Konventë dhe garantimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në kuadrin e detyrimeve që u burojnë shteteve palë të Konventës. Ligji nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” përkohet nga parimi i barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit.

Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, miratuar në vitin 1979, është ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1993⁸⁰, ndërsa Protokollin Opsional i kësaj konvente, në 2003⁸¹. Në legjislacionin shqiptar, një përkufizim të diskriminimit plotësisht në përputhje me CEDAW, e gjejmë në ligjin 9970/2008, “Për barazinë gjinore në Shoqëri” (neni 4) dhe në ligjin 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” (neni 3). Kjo konventë synon të sigurojë përmirësimin *de facto* të pozitës së grave. KMD-ja kontribuoi në përgatitjen e Raportit të Katërt Periodik Kombëtar mbi zbatimin e Konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, miratuar me Vendimin nr.806, datë 26.11.2014. Nenet substanciale të kësaj konvente përcaktojnë detyrimet e shtetit shqiptar në lidhje me barazinë gjinore në përfaqësimin politik dhe në jetën publike, përfaqësimin në nivel kombëtar, shtetësinë, trafikimin dhe prostitucionin, barazinë në edukim, punësim, kujdesin shëndetësor dhe shëndetin riprodhues, mirëqenien ekonomike dhe sociale, barazinë para ligjit, barazinë në martesë dhe familje, etj. Në vendimet ose rekomandimet e marra për çështje që kanë ngritur pretendime për diskriminim, KMD-ja i është referuar kësaj konvente.

Në vërejtjet përmblylëse të Komitetit mbi eliminimin e diskriminimit ndaj grave, Komiteti në sesionin e dyzetë e gjashtë, 12-30 korrik 2010, vlerësoi si aspekt pozitiv ngritjen në vitin 2010 të institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, një organ i pavarur për nxitjen e barazisë, monitorimin e zbatimit të legjislacionit anti-diskriminim, organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe hetimin e çështjeve që ngrenë pretendime për diskriminim⁸².

Konventa evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, e ratifikuar nga Shqipëria në 1996⁸³, në nenin 14 të saj parashikon “ndalimin e diskriminimit”, ndërsa Protokollin Nr. 12, në nenin 1, i referohet ndalimit të përgjithshëm të diskriminimit, duke zgjeruar fushën e zbatimit të nenit 14 edhe në rastet kur një person është diskriminuar në gëzimin e një të drejte ose përfitimi sipas legjislacionit kombëtar. Parimi i mosdiskriminimit që përshkon këtë konventë është i lidhur ngushtësisht me të drejtat e përcaktuara në nenet e konventës.

78 http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=E/C.12/ALB/CO/2-3&Lang=En

79 Ligji Nr. 108 datë 15.11.2012 “Për ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”

80 Ligji 1769/ 9.11.1993.

81 Ligji nr. 9052, datë 17.04.2003.

82 Vërejtjet Përmblylëse të Komitetit mbi eliminimin e diskriminimit ndaj grave në sesionin e dyzetë e gjashtë të Komitetit CEDAW, në datat 12-30 korrik 2010, paragrafi 14.

83 Ligji nr. 8137, datë 31.07.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, i ndryshuar.

Konventa e Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”⁸⁴ është ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2012. Me ligjin nr.104/2012, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës ‘Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje’”, shteti shqiptar pranoi detyrimin për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Konventa kuadër e Këshillit të Europës për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare, e cila pas ratifikimit është bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe ka forcën e ligjit, është një garanci për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve në Shqipëri;

Karta sociale evropiane, një traktat i Këshillit të Europës, e miratuar në vitin 1961 dhe e rishikuar në vitin 1963, është bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm me ratifikimin e saj prej Shqipërisë në vitin 2002. Në këtë traktat trajtohen të drejta lidhur me strehimin, shëndetin, edukimin, arsimimin, punësimin, mbrojtjen sociale, etj.

Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial-ICERD, në të cilën Shqipëria ka aderuar në vitin 1994, kërkon nga shtetet palë marrjen e masave me qëllim eliminimin e diskriminimit për shkak të racës.

Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, konkretizon nenin 18 të Kushtetutës. Ai është ligji organik mbi bazën e të cilit sigurohet mbrojtja nga diskriminimi. Progres Raporti për Shqipërinë 2014 vlerëson se ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” është më së shumti në përputhje me *acquis* të BE-së⁸⁵. Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive, për të ushtruar të drejtat dhe liritë e tij, si dhe mbrojtje efikase nga diskriminimi. Ligji rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë joshteruese shkaqesh. Në bazë të këtij ligji, është krijuar institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), si person juridik publik, i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij dhe si autoriteti përgjegjës, i cili siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin. KMD-ja ka kompetenca për të pranuar ankesa jo vetëm ndaj sektorit publik, por edhe ndaj subjekteve privatë dhe individëve. Fushat kryesore në të cilat sigurohet kjo mbrojtje ligjore janë të parashikuara shprehimisht dhe përfshijnë mbrojtjen nga diskriminimi në punësim, në fushën e arsimit, si dhe në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve. Por, mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” garantohet për të gjitha të drejtat e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Ligjet e brendshme gjithashtu sanksionojnë parimin e barazisë dhe mbrojtjen nga diskriminimi, edhe pse ekziston nevoja për ndryshime apo miratimin e legjislacionit të ri, për të garantuar mbrojtjen nga diskriminimi⁸⁶.

Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i procedurave administrative” është një tjetër akt mbi bazën e të cilit vepron KMD-ja gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij. Në këtë ligj, parimi i barazisë sanksionohet si një nga parimet bazë i cili duhet të udhëheqë veprimtarinë

84 Ligji Nr. 104 datë 11.08.2012 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës ‘Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje’”. Kjo Konventë ka hyrë në fuqi në 1 gusht 2014.

85 Komisioni Evropian, Progres Raporti për Shqipërinë 2014, gjendet në uebsajtin e Ministrisë së Integritetit www.integrimi.gov.al

86 Një nevojë e tillë është konstatuar edhe në Progres Raportin 2013 për Shqipërinë.

e administratës publike. Në kuadër të hartimit të Kodit të ri të Procedurave Administrative, KMD-ja ka ritheksuar se shpërndarja e barrës së provës për çështjet e diskriminimit është thelbësore referuar edhe në standardet e parashikuara nga direktivat e BE-së në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit.

Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili në nenin 9, parashikon ndalimin e çdo lloji diskriminimi në fushën e punësimit, por për një numër më të kufizuar shkaqesh se ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. KMD-ja ka dërguar në vitin 2012 rekomandime Për Kodin e Punës, të cilat nuk janë miratuar akoma. KMD-ja i ka ridërguar këto propozime.

Gjithashtu, kuadri ligjor në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit, për shkaqe të veçanta parashikohet edhe në ligjet e tjera si ligji nr. 9970, datë 24.07.2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri” i cili parashikon ndalimin e diskriminimit për shkak të gjinisë në nenin 6 të tij; ligji nr. 10347, datë 04.11.2010, “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, i cili eliminon të gjitha format e diskriminimit ose të ndëshkimit të fëmijës; ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, etj.

Niveli i mbrojtjes nga diskriminimi është rritur gjatë vitit 2014 me zbatimin e ndryshimeve të vitit 2013 në Kodin Penal⁸⁷. Këtu mund të përmendim parashikimin si rrethanë rënduese të dënimit të motiveve të identitetit gjinor, orientimit seksual, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike dhe aftësisë së kufizuar⁸⁸; parashikimin si vepër penale të ngacmimit seksual (neni 108/a); kriminalizimin e nxitjes së urrejtjes apo grindjeve për shkak të orientimit seksual (neni 265); kriminalizimin e shkeljes së barazisë së shtetasve nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik edhe për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor (neni 253). KMD-ja ka propozuar disa prej këtyre ndryshimeve. Disa nga rekomandimet e KMD-së nuk janë marrë në konsideratë dhe për këtë arsye u janë ridërguar autoriteteve përgjegjëse.

Për të luftuar diskriminimin në fushën e arsimit, ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ka ngarkuar Këshillin e Ministrave dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës⁸⁹ për marrjen e masave me karakter pozitiv (neni 18 i ligjit), dhe në zbatim të këtyre detyrimeve ka parashikuar në nenin 39 të tij, nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e nenit 18. Komisioneri konstaton se, edhe pse me Urdhrin Nr. 52, datë 23. 04. 2012 të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e akteve nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02, 2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” është ngritur një grup ndërinstitucional pune i kryesuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës⁹⁰, akoma nuk janë miratuar aktet nënligjore në zbatim të nenit 18 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Në zbatim të legjislacionit janë hartuar dhe dokumente strategjike dhe politika mosdiskriminimi, ku përmendim: Strategjia sektoriale e mbrojtjes sociale 2007-2013; Plani i veprimit për fëmijët 2012 - 2015; Strategjia kombëtare për barazinë gjinore, dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje 2011-2015; Plani kombëtar i veprimit për dekadën e përfshirjes rome 2012-2015.

87 Me ligjin nr.144/2013, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar”.

88 Shkaqe këto që mbrohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

89 Emërtimi siç parashikohet në ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, sot emërtimi zyrtar “Ministri i Arsimit dhe Sportit”.

90 Emërtimi zyrtar në kohën e daljes së urdhrin për ngritjen e grupit të punës, sot Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Rekomandime legjislative të KMD-së

1. Rekomandime legjislative për ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë

Rekomandim dërguar Ministrin të Drejtësisë me shkresën nr. 295 Prot, datë 10.03.2014, me lëndë: "Dërgohen rekomandime për ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, 'Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar". Këto ndryshime kanë synuar zbatimin e parimit të barazisë dhe mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Duke qenë se propozimet e dërguara nga KMD-ja me shkresën me nr. 175 prot, datë 07.03.2013, nuk kanë gjetur pasqyrim në ndryshimet që i janë bërë Kodit Penal gjatë vitit 2013, KMD-ja i ka ridërguar këto rekomandime.

Konkretisht, Komisioneri ka rekomanduar:

- Reformulimin e nenit 50/j të Kodit Penal, duke përfshirë si një rrethanë rënduese për kryerjen e një veprë penale të gjitha bazat e parashikuara në ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi".
- Reformulimin e nenit 84/a të Kodit Penal, me qëllim për të parashikuar si vepër të veçantë penale, kanosjen për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të personit.
- Reformulimin e nenit 119/a "Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik" dhe reformulimin e nenit 119 / b "fyerjeve të motivuara nga racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik", në mënyrë që të kriminalizohen këtë qëndrime për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.
- Shtesa e një neni të ri pas nenit 265 "Nxitja e urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve", me qëllim për të kriminalizuar nxitjen e urrejtjes për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.
- Reformulimin e nenit 253 "Shkelja e barazisë së shtetasve", në mënyrë që të përfshijë të gjitha bazat e diskriminimit, të parashikuara nga ligji anti-diskriminim, duke garantuar një mbrojtje më të gjerë të personave.

Duke qenë se vetëm dy nga këto rekomandime në lidhje me nenin 50/j dhe 253 të Kodit Penal janë zbatuar dhe rekomandimi në lidhje me nenin 265 është zbatuar pjesërisht, me shkresën me nr. 295 Prot, datë 10.03.2014, KMD-ja i ka ridërguar rekomandimet me status të pazbatuar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu, janë paraqitur rekomandime për ndryshime të reja në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Kështu, institucioni i KMD-së ka rekomanduar gjithashtu heqjen e termit "marrëdhënie homoseksuale" që përmendet si në titull ashtu edhe në përmbajtje të neneve 100 deri 107 të Kodit Penal, Seksioni VI, ku parashikohen krimet seksuale. Me qëllim eliminimit e përdorimit të një gjuhe të papërshtatshme, me konotacion negativ dhe paragjykes,

është rekomanduar: a) Të hiqen nga titulli i neneve 100, 101, 103, 104, 105, 106, 107 të Kodit Penal fjalët "ose homoseksuale"; b) Të hiqen nga paragrafi i parë dhe i dytë i neneve 100, 101, 103 të Kodit Penal si dhe nga nenet 104, 105, 106 dhe 107 të Kodit Penal fjalët "ose homoseksuale"; c) Të riformulohet neni 102 i Kodit Penal me këtë përmbajtje: "Marrëdhënie seksuale me dhunë me persona të rritur", Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë me persona të rritur dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Kur marrëdhënia seksuale me dhunë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarit/ës i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit/ës, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet."

Me këtë riformulim të nenit 102 të Kodit Penal, është rekomanduar shfuqizimi i nenit 102/a të Kodit Penal.

2. Rekomandime legjislative për ndryshime në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë

Me shkresën me nr. 294 Prot, datë 10.03.2014, me lëndë, "Dërgohen rekomandime për ndryshime në ligjin Nr. 8116, datë 29.03.1996, 'Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar", KMD-ja ka paraqitur rekomandime drejtuar Ministrin të Drejtësisë, Z.Nasip Naço. Referuar direktivave të Bashkimit Europian në fushën e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit, e konkretisht standardit të barrës së përmbysur të provës, KMD-ja ka kërkuar të ndërmerren nisma për të ndryshuar barrën e provës gjatë procesit civil në rastet kur gjykata shqyrton një çështje diskriminimi.

KMD-ja ka argumentuar nevojën e përmbushjes së këtij rekomandimi legjislativ, duke e argumentuar me faktin se në ligjin Nr. 10221, datë 04.02.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", në Kreun VI "Procedurat përpara gjykatës", është parashikuar zhvendosja/shpërndarja e barrës së provës në rastet kur gjykata shqyrton një çështje diskriminimi, ndryshe nga parimi i përgjithshëm për barrën e provës, sipas të cilit detyrimi për të vërtetuar faktet e nevojshme për të provuar pretendimin është i palës që e pohon atë. Parimi i barrës së provës parashikohet nga Kodi i Procedurës Civile në nenin 12, ku thuhet: "Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilët bazon pretendimin e saj" nuk është në përputhje me *acquis communitare* në lidhje me standardin e barrës së përmbysur të provës.

Institucioni i KMD-së e ka argumentuar nevojën e këtij ndryshimi ligjor me faktin se, bazuar në praktikën e vet institucionit në shqyrtimin e çështjeve që ngrenë pretendimin për diskriminim, rezulton shumë e vështirë për individin të mbledhë provat dhe ndodh që ky individ të përballet edhe me situata ku provat e drejtpërdrejta nuk ekzistojnë. Argumentimi i nevojës për këtë ndryshim legjislativ është mbështetur edhe në jurisprudencën e GJED-së dhe në Direktivën e Këshillit Europian 97/80 të barrës së provës dhe direktivat e mëvonshme të KE-së si Direktiva e Parlamentit Europian dhe e Këshillit 2006/54/KE e 5 korrikut 2006 për "Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës".

Në këto kushte, me qëllim përfarimin e legjislacionit me *acquis communautaire* të BE-së dhe harmonizimin e legjislacionit të brendshëm KMD-ja ka propozuar:

- **Shtimin e një paragrafi, pas paragrafit të parë të nenit 12, të ligjit Nr. 8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, me përmbajtje si vijon: "Pasi paditësi paraqet prova, mbi të cilat bazon pretendimin e tij dhe në bazë të të cilave gjykata mund të prezumojë sjelljen diskriminuese, i padituri detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim".**

Në lidhje me propozimet e KMD-së për amendimin e Kodit të Procedurës Civile, Ministria e Drejtësisë ka konfirmuar se këto rekomandime do të merren në konsideratë sapo të merret një iniciativë e re për amendime në Kodin e Procedurës Civile.

3. Rekomandime legjislative për ndryshime në Kodin Zgjedhor

Gjatë vitit 2014, KMD-ja me shkresën me nr. 594 Prot, datë 18.06.2014, "Dërgohen rekomandime për ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, 'Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë', ndryshuar me ligjin nr. 74/2012" ka paraqitur pranë Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, rekomandime për ndryshime në këtë ligj.

-Është rekomanduar riformulimi i nenit 3, pika 3 të Kodit Zgjedhor, ku shkaqet e mbrojtura nga diskriminimi duhet të jenë në harmoni me parashikimet e nenit 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", si më poshtë:

"Çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, pa dallim gjinie, race, ngjyre, etnie, gjuhe, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindje politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënie, përkatësi prindërore, përgjegjësi prindërore, moshe, gjendje familjare ose martesore, gjendje civile, vendbanimi, gjendje shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësi të kufizuara, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër, ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod".

-Është rekomanduar që në pikën 2, të nenit 6 të Kodit Zgjedhor të shtohet si institucion që ka të drejtën për të caktuar vëzhgues edhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

-Referuar ligjit nr.9970, datë 24.07.2008, 'Për barazinë gjinore në shoqëri', përfaqësimit të barabartë gjinor të përcaktuar në të si edhe situatës faktike sipas së cilës gratë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar, KMD-ja ka rekomanduar që neni 67/6 i Kodit Zgjedhor të amendohet, si më poshtë:

"Për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumëmemërore dhe një në çdo tre emra të listës shumëmemërore duhet t'i përkasë secilës gjini. Subjekti paraqitës i listës deklaron vendet, sipas kuotës gjinore, me qëllim zbatimin e përjashtimit, sipas pikës 2 të nenit 164 të këtij Kodi".

-Duke u referuar në nenin 175 të Kodit Zgjedhor i cili parashikon sanksionet në rastin e mosrespektimit të kuotës gjinore, dhe praktikës së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara në datë 23 qershor 2013, KMD-ja ka rekomanduar:

Të rritet masa e gjobës sipas nenit 175, paragrafi 1, si për zgjedhjet për Kuvendin ashtu dhe për organet e pushtetit vendor

Të mbahet parasysh zvogëlimi i diferencës ndërmjet sanksioneve të parashikuara në rastin e zgjedhjeve për Kuvendin me sanksionin në rastin e zgjedhjeve për organet e pushtetit vendor.

Të shtohet si sanksion kumulativ së bashku me gjobën edhe refuzimi i listave të partive, në rast se ato nuk respektojnë kuotën gjinore prej 30%.

-Gjithashtu, me qëllim që e drejta për të marrë informacion për fushatën zgjedhore të garantohet mbi baza të barabarta për të gjithë individët, dhe për të garantuar pjesëmarrjen reale dhe pa diskriminim në jetën politike të personave me aftësi të kufizuara, është rekomanduar që në nenin 80, pika 2, pas fjalisë së parë të kësaj pike, të shtohet një fjali me këtë përmbajtje: *"Radiotelevizioni publik e bën pasqyrimin e fushatës zgjedhore në formate dhe teknologji të aksesueshme/të përshtatshme për lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar".*

-Referuar qasjes së re që ofron Konventa e OKB-së "Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara", si dhe rolit të rëndësishëm të gjuhës së përdorur në ndryshimin e perceptimit që shoqëria ka për personat me aftësi të kufizuara, KMD-ja ka rekomanduar që, emërtimi i nenit 108 të Kodit Zgjedhor të ndryshohet nga *"Zgjedhësit që nuk votojnë vetë"* në *"Zgjedhësit me aftësi të kufizuara"*.

Bazuar në detyrimin që i buron shtetit shqiptar në bazë të Konventës së OKB-së "Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara", për të respektuar, mbrojtur dhe të garantuar që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjithë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, KMD-ja ka rekomanduar që t'i jepet përparësi gjetjes së një zgjidhje ligjore, nëpërmjet rregullimeve konkrete në Kodin Zgjedhor, për garantimin e të drejtës së votës zgjedhëse që nuk dalin dot nga shtëpia për të qenë pranishëm në qendrat e votimit.

4. Rekomandime për Kodin e transmetimit

KMD-ja ka dërguar, përmes shkresës zyrtare me nr. 54 Prot, dt. 20.01.2014, Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) rekomandime për Kodin e transmetimit, të cilat konsistojnë në:

- Ne seksionin 1 "**Parimet themelore**" te parashikohet: Transmetimet Audiovizive të të gjitha llojeve të respektojnë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit për çdo shkak të mbrojtur nga legjislacioni shqiptar.
- Ne seksionin 2 "**E drejta për privatësi**" te parashikohet: *"Në Transmetimet Audiovizive, respektimi i parimit të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale të zbatohet pa diskriminim për shkaqe si raca, mosha, aftësia e kufizuar ose çdo shkak tjetër të mbrojtur nga legjislacioni shqiptar."*
- Në seksionin 4, "**Transmetimi i programeve informative**" pika 4.11 shkaqet e diskriminimit të jenë në përputhje me nenin 1 të Ligjit nr.10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", ku parashikohet një listë jo shteruese shkaqesh.
- Në seksionin 4, të shtohet pikat si më poshtë: *"OSHMA-të në hapësirën informative, nuk duhet të keqpërdorin grupet e cënueshme, por duhet të promovojë një qasje pozitive ndaj grupeve të cënueshme (minoriteteve, grave të dhunuara, personave me aftësi të kufizuara etj.)"*
- Në seksionin 5 "**Fëmijët në transmetimet audiovizive**" të shtohet: *"Në programet kulturore e argëtuese për fëmijët, nuk duhet të përdoren terma të cilat nxisin qëndrime paragjyquese."*

- Në seksionin 6 **“Personat me aftësi të kufizuar në transmetimet audiovizive”**, të shtohet: *“OSHMA-të duhet të garantojnë që shërbimet e tyre të jenë të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara. OSHMA-të duhet të nxisin promovimin e arritjeve të personave me aftësi të kufizuara.”*
- Në seksionin 8 **“Reklammat në transmetimet audiovizive”**, pika 8.3 të riformulohet në përputhje me ligjin nr. 10221, *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*: *“Ndalohet publikimi i reklamave, nëse ato paraqesin, haptazi apo në mënyrë të nënkuptuar, qëllime diskriminimi për shkaqe të mbrojtura nga legjislacioni shqiptar”*.

5. Rekomandime për Kodin e Familjes

KMD-ja ka marrë pjesë në grupin e punës së ngritur nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në të cilin ka paraqitur rekomandimet për amendimin e Kodit të Familjes. Rekomandimet për ndryshime në Kodin e Familjes, synojnë përafrimin e tij me Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Me këto sugjerime, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë finalizoi procesin e përgatitjes së disa amendimeve në Kodin e Familjes në lidhje me bashkëjetesën. (neni 163 i Kodit të Familjes, “Kuptimi i bashkëjetesës” dhe neni 164 i Kodit të Familjes).

6. Rekomandime në lidhje me ligjin nr. 9355/2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.

Me shkresën e tij me nr. 971 date 10.11.2014, KMD-ja ka paraqitur rekomandime për ndryshime në ligjin nr. 9355/2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”. Këto rekomandime i janë drejtuar Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Z. Erion Veliaj dhe konsistojnë në riformulimin e pikës 10, të nenit 4, të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 *“Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”*, në mënyrë të tillë që të eliminohet krijimi i preferencave me bazë gjinore dhe moshe, apo me çdo bazë tjetër.

KMD-ja vëren se, përkufizimi *“Kryetar të familjes”* në ligjin *“Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”*, në nenin 4, pika 10, bie ndesh me parimin e barazisë gjinore. KMD-ja ka vlerësuar se kjo pikë jo vetëm që nuk i shërben forcimit të rolit të gruas, që është një nga angazhimet e *Strategjisë kombëtare për barazinë gjinore dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, 2011-2015*, por sjell një dobësim të rolit të gruas në familje dhe në vendimmarrjen e familjes.

Përveç vendosjes së preferencës në bazë të gjinisë, renditja që bën pika 10 e nenit 4, vendos preferencë bazuar në moshë, dhe konkretisht me formulimin *“anëtari më i madh i familjes, në grup-moshën aktive (18-65 vjeç), anëtari më i ri i familjes, në grup-moshën mbi 65 vjeç”*. Pra, mënyra se si është formuluar kjo pikë vjen në kundërshtim me parimin e barazisë, pasi përcakton një radhë preferenciale bazuar në moshën e individit, duke u dhënë përparësi individëve më të mëdhenj në grup-moshën 18-65 vjeç, dhe individëve më të rinj në grup-moshën mbi 65 vjeç.

7. Rekomandime në lidhje me Kodin e Procedurës Administrative

KMD-ja ka dërguar propozimet për amendime në Kodin e Procedurës Administrative, me anë të shkresës nr. 692/1, datë 30.12.2013, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë. KMD-ja ka rekomanduar:

- Riformulimin e nenit 5 të projektligjit ose shtimin e një neni të veçantë, ku të formulohet parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit, si parime të rëndësishme që duhet të udhëheqin veprimtarinë e çdo organi publik apo subjekti privat që ushtron funksione publike.
- Shkaqet e mbrojtura nga diskriminimi duhet të jenë në harmoni me parashikimet e nenit 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*.
- Shtimin e një neni që të rregullojë barrën e provës në çështjet e diskriminimit. Ligji *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”* në përputhje me parashikimet e direktivave të BE-së e ka parashikuar zhvendosjen e barrës së provës në procedurat përpara gjykatës, kur kjo e fundit shqyrton një padi diskriminimi dhe konkretisht në nenin 36, pika 6, e ligjit *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*.

Me shkresën nr. 894/1 Prot, datë 24.10.2014, me lëndë *“Dërgohen rekomandime lidhur me projektligjin “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, KMD-ja i ka dërguar rekomandimet në lidhje me këtë projektligj z. Fatmir Xhafaj, kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pranë Kuvendit të Shqipërisë. Në të është theksuar se, nga rekomandimet e dërguara në vitin 2013 është pasqyruar rekomandimi mbi përfshirjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

Duke qenë se pjesë e rekomandimeve të dërguara Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr. 692/1 Prot., datë 30.12.2013, ka qenë edhe rekomandimi për të riformuluar nenet që parashikojnë barrën e provës midis palëve në një procedim administrativ, me qëllim parashikimin e shpërndarjes së barrës së provës për rastet kur kemi të bëjmë me një pretendim diskriminimi, dhe ky rekomandim nuk është marrë parasysh, KMD-ja ka ritheksuar se shpërndarja e barrës së provës për çështjet e diskriminimit është thelbësore referuar edhe në standardet e parashikuara nga direktivat e BE-së në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit. Edhe Komiteti CEDAW, në Vërejtjet Përmbyllëse të Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, në sesionin e tij të dyzetë e gjashtë në 2010, ka nxitur Shtetet Palë të shqyrtojnë heqjen e barrës së provës në rastin e diskriminimit të pretenduar për shkak të seksit dhe gjinisë, veçanërisht në rastin e ngacmimit seksual, në legjislacionin anti-diskriminim dhe Kodin e Punës.

Me qëllim përafrimin e legjislacionit me *acquis communautaire* të BE-së, KMD-ja ka propozuar që në nenin 93 të projektligjit, “Barra e Provës”, pas pikës 1, të shtohet një pikë, që të rregullojë barrën e provës në çështjet e diskriminimit, me përmbajtje si vijon:

“Në rastet kur pala e interesuar paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.

Në rekomandim, KMD-ja i është referuar Direktivës 97/80 për barrën e provës në çështjet e diskriminimit për shkak të gjinisë dhe konkretisht parashikimit, “Shtetet Anëtare do të

ndërmarrin masa të tilla sipas nevojës, në përputhje me sistemet e tyre kombëtare juridike, për t'u siguruar se, kur personat që mendojnë se u është bërë një e padrejtë për shkak të moszbatimit të parimit të trajtimit të barabartë, sjellin përpara një gjykate apo ndonjë autoriteti tjetër kompetent fakte, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejt ose të tërthortë, atëherë do të jetë detyra e të paditurit të vërtetojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë”.

Gjithashtu, KMD-ja ka sjellë në vëmendjen e Kuvendit të Shqipërisë, pikën 1, të nenit 93, të projekt-ligjit “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet i njëjti rregullim që bëhet në Kodin e Procedurës Civile në nenin 12, ku përcaktohet se pala që pretendon një të drejtë, ka detyrimin që të provojë faktet mbi të cilët e bazon pretendimin e saj. Ky përbën rregullin e përgjithshëm për barrën e provës, sipas të cilit detyrimi për të vërtetuar faktet e nevojshme për të provuar pretendimin është i palës që e pohon atë. Ndërkohë, KMD-ja ka sjellë në vëmendje ligjin nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nenin 35/3 në të cilin parashikohet mundësia që me vendim të ndërmjetëm të gjykatës mund të vendoset kalimi i barrës së provës tek organi publik, kur kemi të bëjmë me procedimet administrative të filluara me kërkesë të palës së interesuar. Në parimet e gjykimin administrativ në nenin 3/3 të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, përcaktohet se: “Organi i administratës publike, si rregull, ka detyrimin të provojë besueshmërinë në ligj dhe në fakt të veprimeve të kryera prej tij”.

Në përfundim, në vlerësimin e KMD-së procesi i të provuarit në një procedim administrativ është më i vështirë për palët e interesuara, duke e krahasuar me një proces gjyqësor administrativ.

8. Rekomandime në lidhje me Kodin e Punës

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, ka rekomanduar, përmes shkresës nr. 360 Prot, datë 14.09.2012, ndryshimet e mëposhtme:

- Të riformulohet koncepti i “diskriminimit” në Kodin e Punës, duke shtuar shkaqet e diskriminimit, përfshirë orientimin seksual dhe identitetin gjinor, sipas ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
- Të përfshihen edhe format e tjera të diskriminimit, si “udhëzimi për të diskriminuar”, “shqetësimi”, “viktimizimi”, “diskriminimi për shkak të shoqërimin” dhe “mohimi i përshatjes së arsyeshme”.
- Të parashikohet në Kodin e Punës detyrimi i punëdhënësit për të marrë masat e duhura për sistemimin e vendit të punës për personat me aftësi të kufizuara; vendi i punës, në të gjithë elementët, duhet të përshtatet me natyrën e punës dhe nevojat e punëmarrësit, duke iu garantuar personave me aftësi të kufizuara të drejtën për punësim në mënyrë të barabartë me të tjerët.

Statusi i këtij rekomandimi i zbatuar, sepse propozimet janë përfshirë në Amendimet e Projekt- Kodit të Punës.

SHTOJCA 3

Pjesëmarrje e stafit të KMD-së në aktivitete të organizuara nga aktorë të tjerë

Gjatë vitit 2014, Zyra e KMD-së ka marrë pjesë në 34 aktivitete (seminare, workshope) me qëllim rritjen e kapaciteteve, si dhe forcimin e bashkëpunimit me institucione shtetërorë apo organizata, kombëtare apo ndërkombëtare, që mbrojnë të drejtat e njeriut dhe japin opinione për diskriminimin.

Janë forcuar kapacitetet e punonjësve të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, të drejtave të komuniteteve romë dhe egjiptiane, në lidhje me çështje të sigurisë, të drejtësisë sociale, fenomenin e gjakmarrjes, mbrojtjen e të dhënave personale, etj.

Në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

Në datën 17 janar 2014, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe një përfaqësues nga Zyra e KMD-se morën pjesë në Konferencën me temë: “Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në media”, organizuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive. Komisionerja në fjalën e saj theksoi rolin e KMD-së në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe ndihmën e medias në veprimtarinë e institucionit në marrjen e informacioneve të besueshme për të nisur hetime.

- Në datën 22 janar 2014, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Këshilltari morën pjesë në një Tryezë të Hapur Konsultuese me temë: “Çdo fëmijë rom në kopsht”, pranë ambienteve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të organizuar nga UNICEF dhe MAS. Kjo tryezë kishte për qëllim krijimin e partneritetit me organet qeveritare dhe joqeveritare për “Çdo fëmijë rom në kopsht” duke nxjerrë disa rekomandime për të ardhmen.

Në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

- Në datë 21 janar 2014, Komisioneri dhe Këshilltari morën pjesë në një takim pune “Mbi nisjen e procesit të zyrtarizimit të gjuhës së shenjave”, pranë ambienteve të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, nën kujdesin e Zëvendësministres Znj. Bardhylka Kospiri. U prezantua eksperiencia në Kosovë dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në këndvështrimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.
- Në datën 17 shkurt 2014, një përfaqësues i zyrës së KMD-së mori pjesë në Konferencën Kombëtare “Aksesi në Drejtësi – Një fokus i ri te nenet 12 dhe 13 të Konventës së OKB-së ‘Për të Drejtat e personave me Aftësi të Kufizuara’”. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të projektit “Aksesi në Drejtësi”, zbatuar nga Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të Personave me Aftësi të Kufizuara, me mbështetjen e Avokatit të Popullit, si edhe me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përfaqësuesi i zyrës së KMD referoi temën: “Diskriminimi për shkak të pozitës së pabarabartë në proceset penale, civile dhe administrative të personave me aftësi të kufizuara”.

Në lidhje me të drejtat e komunitetit Rom

- Në datën 22 janar 2014, një përfaqësues nga zyra e KMD-së mori pjesë në takimim me temë: “Për një shërbim shëndetësor efikas për minoritetin rom”, organizuar nga Qendra Kombëtare për shërbimet komunitare dhe Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, me qëllim përmirësimin dhe sigurimin e shërbimeve shëndetësore për minoritetin rom.
- Në datat 30 - 31.01.2014, një përfaqësues nga zyra e KMD-së mori pjesë në workshop-in me temë: “Diskriminimi ndaj romëve dhe ciganëve dhe sfidat e luftës ndaj diskriminimit të dyfishtë”, organizuar nga Presidenca e Malit të Zi per Dekadën e përfshirjes së romëve 2005-2015. Qëllimi i workshop-it ishte prezantimi i diskriminimit të shumëfishtë.
- Në datën 8 shkurt 2014, një përfaqësues nga zyra e KMD-së mori pjesë në takimim konsultativ të Projekt-planit lokal të Bashkisë së Tiranës për komunitetin rom dhe egjiptian, i cili synonte të integronte komunitetin rom dhe egjiptian në jetën social-ekonomike. Ky plan thekson katër prioritetet e Dekadës së përfshirjes së romëve: arsimin, punësimin, shëndetësinë dhe strehimin.
- Me datë 13 shkurt 2014, u zhvillua tryeza e rrumbullakët me temë: “Ndërtojmë së bashku mjedise përcuese të diversitetit dhe të mosdiskriminimit”, me komunitetin rom dhe egjiptian, në kuadër të projektit SSIREC- zbatuar nga UNDP dhe mbështetur financiarisht nga BE. Roli i KMD-së në këtë aktivitet ishte rritja e ndërgjegjësimit dhe njohja me problematikat e këtij komuniteti.
- Në datën 20-21 shkurt 2014, një përfaqësues nga zyra e KMD-së mori pjesë në “Tryezën e dialogut të lartë për politikën e përfshirjes së komuniteteve rome dhe egjiptiane dhe sfidat e reja të zhvillimit social në Shqipëri”, organizuar bashkërisht nga Delegacioni i Bashkimit Europian në Shqipëri dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, mbështetur nga TAIEK. KMD-ja ishte pjesë e panelit të trajnimit profesional dhe punësimit, zhvilluar gjatë ditës së parë të këtij aktiviteti. Përfaqësuesja e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në këtë Konferencë referoi prezantimin: “Diskriminimi për shkak të racës në fushën e punësimit”, duke theksuar jo vetëm problematikat por edhe masat e ndërmarra nga KMD-ja për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve rome/egjiptiane.
- Në datën 28 shkurt 2014, Komisionerja dhe një përfaqësues nga zyra e KMD-së morën pjesë në aktivitetin përmbyllës të projektit “Praktikat më të mira të integrimit të romëve”. KMD-ja mbështeti me ekspertizë dhe punë intensive zbatimin e projektit “Praktikat më të mira për integrimin e romëve”. Në kuadër të këtij projekti u organizuan ditë të hapura dhe u nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me njësitë vendore.
- Në datën 24 prill 2014, një përfaqësues nga zyra e KMD-së mori pjesë në seminarin mbi prezantimin e Kartës Evropiane për gjuhët rajonale dhe minoritare, të zhvilluar në kuadër të projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës “Promovimi i të drejtave të njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve në Evropën Juglindore”. Ky seminar prezantoi situatën aktuale në lidhje me mbrojtjen e gjuhëve rajonale dhe minoritare dhe vuri theksin në faktin se Shqipëria është në procesin e shqyrtimit të mundësisë për të ratifikuar Kartën Evropiane për gjuhët rajonale dhe minoritare.
- Në datën 21 tetor 2014, u mbajt një workshop me temë “Të drejtat e minoritetit rom”, i organizuar nga Rrjeti i Organizatave Kombëtare Rome “Së bashku për forcimin e

zërit rom në Shqipëri”. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të projektit “Përmirësim i qëndrueshëm i jetesës së komuniteteve rome në Shqipëri, financuar nga We Effect dhe kishte si qëllim njohjen me kuadrin ligjor, politikën që shërbejnë për mbrojtjen e minoritetit rom në Shqipëri, dhe marrjen e iniciativave konkrete të lobimit dhe avokatisë. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi prezantoi situatën aktuale të punës së institucionit dhe problematikat me të cilat përballet ky komunitet, lidhur me minoritetin rom.

- Në kuadër të projektit “Mbështetje për përfshirjen sociale të komuniteteve rome dhe egjiptiane”, janë forcuar kapacitetet e stafit të zyrës së KMD-së, për marrjen dhe shqyrtimin e ankesave për diskriminim nga komuniteti rom/egjiptian, nëpërmjet organizimit të dy trajnimeve në muajin mars 2014. Në datën 4 mars 2014, u organizuan “Ditët e hapura në/me komunitetet rome dhe egjiptiane”. Gjithashtu, në datat 25-26 mars 2014, u organizua një trajnim 2-ditor me temë “Të drejtat e njeriut dhe mosdiskriminimi i pakicave rome dhe egjiptiane”. Në këtë trajnim morën pjesë të gjithë anëtarët e stafit të KMD-së.
- Në datën 21 Tetor, 2014 u organizua pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme një tryezë e rrumbullakët mbi hartimin e Planit të Veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve, 2015-2020. Në këtë tryezë u identifikuan problematikat kryesore me të cilat përballet komuniteti rom dhe ai egjiptian, si edhe u diskutua mbi adresimin e këtyre problemeve përmes Planit të Veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve. Plani i Veprimit synoi të përcaktojë qartë detyrat dhe përgjegjësitë e secilit institucion, me qëllim integrimin e plotë të komunitetit rom dhe egjiptian. Përfaqësues nga zyra e KMD-së morën pjesë në këtë tryezë të rrumbullakët bashkë me përfaqësues të institucioneve të tjera shtetërore. Kjo tryezë u organizua në vijim të disa tryezave të zhvilluara nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për këtë qëllim.
- Në datën 15 dhjetor 2014, një përfaqësuese e zyrës së KMD-së mori pjesë si referuese në trajnimin me temë: “E drejta për strehim dhe mbrojtja nga dëbimet, me fokus çështjet e strehimit të komuniteteve rome dhe egjiptiane”. Përfaqësuesja e KMD-së prezantoi temën: “Paraqitja e punës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në çështjet e komunitetit rom dhe egjiptian: “Eksperiencat dhe rruga drejt së ardhmes”. Ky aktivitet u realizua me mbështetjen e Këshillit të Evropës, nëpërmjet zyrave të tij në Tiranë dhe Prishtinë dhe me përkrahjen e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për çështjet rome, qendrën Res Publica, si edhe Dhomën Kombëtare të Avokatisë në Shqipëri dhe Kosovë*. Ky trajnim për juristët nga Shqipëria dhe Kosova u organizua në datat 15-16 dhjetor 2014. Qëllimi i trajnimit ishte promovimi i ndërgjegjësimit të juristëve mbi sfidat e komunitetit rom dhe egjiptian, si edhe rritja e aftësisë së pjesëmarrësve për zbatimin e standardeve ndërkombëtare në praktikën e tyre ligjore dhe proceset strategjike.

Në lidhje me çështjet e sigurisë

Pjesëmarrja në tryeza diskutimi, trajnime të policisë dhe konferenca të organizuara nga Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës mbi të drejtat e personave të privuar nga liria apo personave me probleme të shëndetit mendor.

- Në datën 24 janar 2014, dy përfaqësues nga zyra e KMD-së morën pjesë në “Forum-in e katërt të hulumtimeve mbi sigurinë: “Beograd-Prishtine-Tiranë. Bashkëpunimi

policor për sigurinë midis Shqipërisë, Serbisë dhe Kosovës". Ky aktivitet ishte pjesë e një projekti më të gjerë të ndërmarrë nga tre organizata partnere të pavarura: Qendra e Beogradit për Politikën e Sigurisë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Qëllimi i forumit ishte të nxiste mirëkuptimin për çështjet e sigurisë, duke thelluar dhe transparencën e qeverisjes në fushën e sigurisë.

Në lidhje me çështje të drejtësisë sociale

- Në datën 8 shkurt 2014, Këshilltari mori pjesë në Konferencën *"Drejtësia Sociale dhe Qytetaria Aktive në Shqipëri"*, të organizuar nga Caritas Shqiptar dhe Organizata CODE Albania.

Në lidhje me fenomenin e gjakmarrjes

- Në datën 13 shkurt 2014, një përfaqësuese nga zyra e KMD-së mori pjesë në analizën vjetore të Institutit *"Shtëpia e drejtësisë dhe pajtimit kombëtar"*, e organizuar nga Instituti *"Shtëpia e drejtësisë dhe pajtimit kombëtar"*, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi fenomenin e gjakmarrjes dhe pasojat që ky fenomen sjell, kryesisht në zonat e prekura nga fenomeni i gjakmarrjes.

Në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale

Në datat 20-21 shkurt 2014, dy përfaqësues nga zyra e KMD-së morën pjesë në trajnimin e personave të kontaktit të ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave personale në sektorin publik, organizuar nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.

Në lidhje me diskriminimin në marrëdhëniet e punës

- Në datën 28 shkurt 2014, Komisionerja për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe këshilltari morën pjesë në aktivitetin e organizuar nga shoqata *"Unë, Gruaja"*, Pogradec", me temë *"Si të shmang diskriminimin në institucionin që unë drejtoj"*.
- Në datën 28 maj 2014, një përfaqësues nga zyra e KMD-së mori pjesë në takim të organizuar nga Ministria e Integritimit Europian, në kuadër të hartimit të Kapitullit 19 të Planit Kombëtar për Integritimin Europian - PKIE. Në takim morën pjesë anëtarët e grupit ndërinstitucional të punës për Kapitullin 19 *"Politikën sociale dhe punësimin"*, ngritur me Urdhër Nr. 125 datë 26.05.2014 të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi dhe përfundimi i hartimit të Kapitullit 19. Në lidhje me pjesën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Pjesa 7 *"Anti-diskriminimi dhe Shanset e Barabarta"*, pika 7.3 *"Anti-diskriminimi"*, nga ana e ekspertit u sugjerua që në tabelën *"kuadri i politikave ekzistuese"* të shtohej *"Plani strategjik 2012- 2015 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, pavarësisht se në këtë rast nuk është përdorur legjislacioni evropian.
- Në datën 09.05.2014, Komisionerja mori pjesë në një tryezë konsultative organizuar nga Policia e Shtetit dhe UN Women si edhe partnerë kombëtarë, ndërkombëtarë e shoqëria civile e cila u fokusua në nevojën e një mjedisi të sigurt pune nga diskriminimi për shkak të gjinisë.

Në lidhje me komunitetin LGBT

- Në datën 20 maj 2014, një përfaqësues i zyrës së KMD-së mori pjesë në seancën e ditës së dytë të workshop-it 2 ditor me temë: *"Çështje të LGBT, në këndvështrimin psiko-social, ligjor, mediatik në shoqërinë shqiptare"*, i cili u organizua në qytetin e Shkodrës. Ky workshop 2-ditor u zhvillua nga organizata *"Gruaja tek Gruaja"*, në kuadër të projektit: *"Ndërgjegjësim dhe mbështetje psiko-ligjore për komunitetin LGBT në rajonin e Shkodrës"* financuar nga Kvinna till Kvinna dhe mbështetur nga Aleanca kundër Diskriminimit LGBT. Ky workshop përfshiu disa seanca: LGBT në këndvështrimin psiko-social; mite dhe fakte për komunitetin LGBT në Shqipëri; mbrojtja nga diskriminimi në Shqipëri në këndvështrimin ligjor, aspekte dhe raste të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; fillesat e lëvizjes LGBT në Shqipëri; pasqyrim i aktivitetit të Aleancës kundër Diskriminimit LGBT; prezantim mbi Ditën Ndërkombëtare të Homofobisë me përfaqësues të organizatës Aleanca kundër Diskriminimit LGBT; Diskutime mbi këndvështrimet e medias në lidhje me trajtimin e çështjeve LGBT; pjesë nga dokumentari *"SKANDAL"*, i cili u shfaq për herë të parë në Shkodër, për pjesëmarrësit.
- Në datën 13 nëntor 2014, u organizua ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit ose memorandumeve të mirëkuptimit në kuadrin e Iniciativës *"Përmirësimi i jetës së personave LGBT në nivel lokal"*. KMD-ja në kuadrin e partneritetit të Ambasadës PINK, kontribuoi në lidhje me ndërgjegjësimin dhe monitorimin në sistemin arsimor.

Në datën 16.12.2014, u organizua takimi *"Përballje mes kolegësh për ndryshime ligjore për personat LGBT"*. Ky takim u organizua në bashkëpunim me Avokatin e Popullit, me mbështetjen e KE-së dhe me pjesëmarrjen e një specialisti nga KMD-ja.

Përfshirja sociale

- Në datën 17 Mars 2014, një përfaqësues nga zyra e KMD-së mori pjesë në prezantimin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për të mbështetur programin për përfshirjen sociale në Shqipëri 2013 – 2020. Ky prezantim ishte konceptuar në formën e një workshopi lidhur me zhvillimin e kapaciteteve për politikën sociale. Ky program u mbështet financiarisht nga Kombet e Bashkuara dhe Kooperacioni Zvicëran në Shqipëri, me udhëheqëse të programit Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Qëllimi i këtij workshopi ishte forcimi i koordinimit në nivel qendror dhe lokal, me qëllim adresimin në politikën sociale të nevojave të grupeve të ndryshme si personat LGBT, përfaqësuesit e komunitetit rom, personat me aftësi të kufizuara.
- Në datat 2-3.12.2014, një përfaqësues i KMD-së mori pjesë në Konventën për Shërbimet Sociale, organizuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Shërbimi Social Shtetëror dhe UNICEF, me mbështetjen e Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri.

Në lidhje me pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje

- Në datën 09.12.2014, u zhvillua takimi strategjik e konsultativ mes Shoqërisë Civile dhe Aleancës së Grave Deputete, në lidhje me rritjen e përfaqësimit të grave në zgjedhjet vendore 2015 dhe ceremonia e ndarjes së çmimit *"Gruaja e Vitit 2014"*. Në

këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të zyrës së KMD-së. Në këtë takim strategjik dhe konsultativ morën pjesë përfaqësues të Aleancës së Grave Deputete, Koalicionit për nxitjen e Pjesëmarrjes së Grave dhe të rinjve në Politikën Gratë për ndryshim, OLAF PALME International Center. Komisionerja i njohu pjesëmarrësit me Rekomandimet që KMD-ja i ka dërguar Kuvendit të Shqipërisë dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për ndryshime në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Në lidhje me të drejtat e njeriut

- Në datën 10.12.2014, Komisionerja për Mbrojtjen nga Diskriminimi Zj.Baraku mori pjesë në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, organizuar nga OSCE.
- Në datën 12 dhjetor 2014, një përfaqësuese e zyrës së KMD-së mori pjesë në Konferencën “15 vjet nga krijimi i Avokaturës së Shtetit”, organizuar nga Avokatura e Shtetit. Në konferencën e 15 vjetorit të krijimit të Avokaturës së Shtetit, u theksua nevoja për reformimin e këtij institucioni, në mënyrë që të përmbushë standardet më të mira europiane dhe të sigurojë një përfaqësim sa më të lartë të interesave të shtetit. Mikpritëse dhe moderatore e këtij aktiviteti ishte Avokatja e Shtetit Alma Hicko.
- Në datën 5 shkurt 2014, Komisionerja mori pjesë në takimin e radhës së grupit ndërmënyror të punës “Për zbatimin e rregullave të përshtatshmërisë në institucionet shtetërore”.

Në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore

- Në datën 17.12.2014, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe një specialist i zyrës së tij mori pjesë në Konferencën për prezantimin e Strategjisë së Luftës Kundër Trafikimit të Personave dhe Planit të Veprimit 2014 – 2017. Kjo Konferencë kishte për qëllim të prezantonte Strategjinë e Luftës Kundër Trafikimit të Personave dhe Planin e Veprimit 2014 – 2017. Ministria e Punëve të Brendshme prezantoi në këtë konferencë risitë dhe sfidat e saj. Kjo Strategji i kushtoi rëndësi bashkëpunimit midis shumë institucioneve.

Në lidhje me Policinë e Shtetit

Në datën 18.12.2014, një punonjës nga zyra e KMD-së mori pjesë në Konferencën kombëtare me temë “Forcimi i integritetit të Policisë së Shtetit”, organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). Kjo konferencë u zhvillua në kuadër të projektit me të njëjtin titull që IDM-ja ka zbatuar gjatë periudhës korrik 2013 – dhjetor 2014 me mbështetjen e Ambasadës holandeze në Tiranë dhe në bashkëpunim me Policinë e Shtetit (PSH), Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) dhe partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë. Projekti, për herë të parë në Shqipëri, solli një studim të plotë të fokusuar vetëm tek Policia e Shtetit, fenomeni i korrupsionit dhe integriteti policor.

Në lidhje me diskriminimin në media

Në datën 7 shkurt 2014, Komisionerja mori pjesë në Konferencën kombëtare “Diskriminimi në media”, organizuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA). Në këtë konferencë, Komisionerja mbajti një prezantim në lidhje me rolin e medias në trajtimin e rasteve të diskriminimit.

